



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13/2024 regjistër (JR)  
Datë 29.03.2024

Nr. 53 i vendimit  
Datë 15.07.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më 15.07.2025, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 734, datë 22.01.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, paragrafi 5; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, analizoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, dhe në parashtrime, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë<sup>1</sup>, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka zhvilluar hetime për 3 (tri) kriteret e vlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, i ka dërguar Komisionit raport<sup>2</sup> kontrolli, në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha:*

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni justifikues për burimin financiar të pasurive të përfituara me dëshmi trashëgimie nga babai;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;

---

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha është emëruar “Prokuror” me dekretin e Presidentit të Republikës nr. {\*\*\*}, datë 01.06.2015, dhe e ka nisur ushtrimin e këtij funksioni në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Në momentin e dhënies së vendimit të Komisionit, objekt shqyrtimi, ushtronte detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në të cilën është transferuar me vendimin e KLP-së nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2023, Në këtë urdhër përcaktohet se subjekti do të ushtrojë funksionet pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë deri më datë 30.09.2023..

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.10.2019.

- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport<sup>3</sup>, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, grupi i punës ka vlerësuar se: *Informacionet që disponohen për z. Ilir G. Hoxha, për implikimin e tij në veprimtari korruptive e në më shumë se një rast, evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e një takimi që qëllimshëm është në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Referuar informacionit të marrë nga institucionet verifikuese subjekti i rivlerësimit z. Ilir G. Hoxha, rezulton individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu sipas përcaktimit të nenit 8 të ligjit nr. 84/2016 që përfshin veprat penale sipas nenit 75/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, subjekti është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv.*

Bazuar në sa më sipër grupi i punës i DSIK-së ka hartuar raportin mbi kontrollin e figurës duke konstatuar *papërshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ilir G. Hoxha.

2.3 KLP-ja, ka hartuar raportin<sup>4</sup> për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 734, datë 22.01.2024, ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ilir Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.*
4. Vendimi i Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha, është bazuar në vlerësimin e të tria kriterëve, mbështetur në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 duke konkluduar sa vijon:

### **4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:**

*Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludoi se pasaktësitë e konstatuara në deklaratën vetting, si dhe mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive që i përket periudhës para emërimit të subjektit në detyrën e prokurorit, janë rrethana që nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për të aplikuar dispozitat e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por do të mbahen në konsideratë nga Komisioni, në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit.*

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.10.2020, të KDZH-së.

<sup>4</sup> Me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.09.2018.

#### **4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:**

*Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk u provua konstatimi në raportin e AKSIK-ut për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.*

*Në përfundim, në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar parashikimet e dispozitave të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës apo të pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

#### **4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:**

*Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë parashikimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

#### **4.4 Për vlerësimin tërësor:**

*Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, mbështetur në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se pavarësisht se nuk u vlerësua që problematikat e konstatuara për secilin komponent përbëjnë më vete shkak për shkarkim nga detyra, por duke u analizuar në tërësinë e tyre, në vlerësim përfundimtar, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia, nisur nga faktet se: i. subjekti rezulton me mungesë burimesh financiare në shumën rreth 3.2 milionë lekë, të cilat meqenëse janë para detyrës, nuk konsiderohen si shkak i vetëm për shkarkim; ii. subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën vetting; iii. lidhur me kriterin e aftësive profesionale, të paktën në nëntë dosje janë konstatuar probleme procedurale; iv. si dhe të paktën në një rast është konstatuar shoqërimi i subjektit me persona me precedentë penalë, fakt për të cilin ka pasur dijeni, duke cenuar sjelljen jashtëgjyqësore të magistratit.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 734, datë 22.01.2024, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i përmbajtjes së ankimit, trupi gjykues konstaton se ai përmban kërkitime me të cilat subjekti kundërshton vlerësimin e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale si dhe për cenim e besimit të publikut, si dhe ngre pretendimin se me vendimin e dhënë Komisioni ka kryer shkelje të nenit 7 të KEDNj-së për shkak se ka cenuar parimin e sigurisë juridike.

#### **A. Shkaqet e ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor**

6. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni me vendimin e dhënë për të, ka kryer shkelje të nenit 7 të KEDNj-së për shkak se ka cenuar parimin e sigurisë juridike.*

#### **B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

7. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e Komisionit për pasurinë e paluajtshme nr. {\*\*\*}, me sip. 108,72 m<sup>2</sup>, të llojit garazh me vendndodhje në Tiranë, si të padrejtë dhe të pa bazuar ligjërisht duke pretenduar se: i. prej tij nuk është investuar/shpenzuar asgjë për përfitimin e kësaj pasurie, pasi është krijuar nga i ati, dhe se subjekti e ka përfituar si trashëgimtar pas vdekjes së babait të tij; ii. përfshirja në mënyrë të padrejtë e këtij shpenzimi në analizën financiare të subjektit ka ndikuar rezultatin e analizës financiare për blerjen e automjetit në vitin 2007 si dhe krijimin e kursimeve në *cash*.

### ***C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale***

8. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar ligjërisht dhe në shkelje të standardeve të vendosura nga organet e rivlerësimit marrjen në analizë prej Komisionit:
- i. Të çështjeve/procedimeve penale të ndjekura nga subjekti që janë ende “nën hetim apo në shqyrtim gjyqësor”;
  - ii. Të çështjeve/procedimeve penale të cilat janë regjistruar si të tilla pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016;
  - iii. Të çështjeve/procedimeve penale, të cilat në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit nuk janë më në shqyrtim prej tij.
9. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar ligjërisht dhe në shkelje të standardeve të vendosura nga organet e rivlerësimit, vlerësimin e bërë nga Komisioni:
- i. lidhur me të dhënat nga burimet arkivore që u përkasin denoncimeve të dy shtetaseve<sup>5</sup>;
  - ii. lidhur me analizën e emërtuar “Gjetje të tjera të kriterit profesional”<sup>6</sup>.
10. Subjekti i rivlerësimit konsideron si të pabazuar ligjërisht, si dhe në shkelje të standardeve të vendosura nga organet e rivlerësimit, vlerësimin e bërë nga Komisioni për sa u përket denoncimeve të publikut, duke kundërshtuar analizën dhe konkluzionet e arritura lidhur me to<sup>7</sup>.
11. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit i cili ka evidentuar problematika që ndikojnë negativisht në figurën e subjektit si magjistrat, duke vlerësuar se ato cenojnë standardet e sjelljes dhe etikës në punë, e që vijnë për shkak të shoqërimit të subjektit të rivlerësimit me shtetas të proceduar për vepra të ndryshme penale e të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme, duke pretenduar se është një vlerësim jo i drejtë dhe i pabazuar ligjërisht, pasi sipas tij Komisioni nuk ka konsideruar se:
- i. veprat penale për të cilat janë dënuar apo janë nën hetim personat me të cilët është shoqëruar subjekti, nuk janë të tilla që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi;
  - ii. nuk është provuar dijenia e subjektit mbi problematikat/procedimet penale të personave me të cilët ai shoqërohej;

---

<sup>5</sup> *Procedimit penal nr. {\*\*\*}/2021, që lidhet me denoncimet (4 denoncime) të shtetases A. L.; Procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019, që lidhet me denoncimin e shtetases F. H.*

<sup>6</sup> *Procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë” kryer në bashkëpunim.*

<sup>7</sup> *Denoncimet e shtetaseve V. Q., S. D., A. B., M. A., A. M., A. H., D. B., J. D., K. R. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.*

iii. Komisioni nuk ka bërë një analizë të plotë lidhur me kategoritë “shtetas i proceduar për vepër penale”, “shtetas në shkelje të ligjit” dhe “shtetas i dënuar”, dhe se cila prej këtyre kategorive e ka afektuar procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin.

12. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, është i pabazuar ligjërisht dhe jo në harmoni me jurisprudencën e Kolegjit.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### **A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit**

###### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë *ratione materiae* ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ilir Hoxha, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *b) Legjitimimi i ankuesit*

14. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### *c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

15. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, kryhet në dhomë këshillimi.

Me ankimin subjekti i rivlerësimit ka kërkuar, *grykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja.*

15.1. Në mbështetje të këtij kërkit bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh të cilat pretendon të administrohen nga Kolegji në funksion dhe mbështetje të ankimit të tij, me cilësinë e provave të reja.

15.2. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit krahas akteve të paraqitura me ankimin, ka depozituar në Kolegji, një grup aktesh të reja me parashtrimet e dorëzuara para seancës gjyqësore, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 42/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe grykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, (në vijim “ligji 49/2012”), duke kërkuar që të merren me cilësinë e provave të reja. Parashtrimet e paraqitura

prej subjektit të rivlerësimit, nga një konsideratë e përgjithshme, konstatohet se paraqesin krahas shtjellimeve/shpjegimeve më të detajuara e të fokusuara rreth shkaqeve të ankimit, edhe pretendime të tjera të shtesë, të ngritura prej subjektit të rivlerësimit për herë të parë në këtë akt, e të pa pretenduara as gjatë hetimit në Komision dhe as në ankim. Trupi gjykues e sjell në vëmendje këtë rrethanë e cila shoqëron aktin “parashtrime”, ashtu si edhe faktin e paraqitjes me to të akteve të konsideruara si prova të reja, në tejkallim të përcaktimeve të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012. Nëpërmjet këtyre pretendimeve dhe provave të reja subjekti i rivlerësimit kërkon të kundërshtojë si të pasaktë dhe jo të drejtë metodologjinë e përdorur për kryerjen e analizës financiare në Komision si dhe vlerësimin e bërë nga ky organ, për çështjet profesionale dhe denoncimet e analizuara në vendim.

**15.3.** Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të përcjella nga subjekti i rivlerësimit me ankimin si dhe parashtrimet, konstaton se: i. një pjesë e rëndësishme e tyre janë akte që gjenden në fashikullin e Komisionit dhe janë administruar dhe analizuar prej tij; ii. ndërsa pjesa tjetër, janë kërkesa me të cilat subjekti ka kërkuar informacion nga gjykatat dhe prokuroritë për çështjet e analizuara në vendimin objekt shqyrtimi, si dhe janë përgjigjet e marra lidhur me to, të cilat datojnë pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi<sup>8</sup>. Lidhur me këto akte, në kuptim të përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, konstatohet se:

*Së pari*, subjekti i rivlerësimit, në ankim nuk ka dhënë shpjegime/arsye lidhur me pamundësinë e tij për t’i paraqitur në Komision aktet e bashkëlidhura ankimit, dhe pse konstatohet se aktet që datojnë pas dhënies së vendimit lidhen me çështje për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ.

*Së dyti*, aktet e reja të paraqitura me parashtrimet të cilat kërkohen të merren me cilësinë e provës, nuk mund t’i nënshtrohen analizës sipas përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, duke qenë se ajo u përket akteve që paraqiten me ankimin. Përcaktimet e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, parashikojnë mundësinë e subjekteve për të paraqitur shpjegime shtesë në mbështetje të shkaqeve të ankimit deri 5 ditë para seancës, por nuk parashikojnë mundësinë që ata të paraqesin prova të reja bashkëlidhur tyre. Edhe mundësia për të paraqitur prova të reja me ankimin, i nënshtrohet përcaktimeve të kritereve strikte që parashikon neni 47 i ligjit nr. 49/2012. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se të gjitha aktet të shoqërojnë parashtrimet

---

<sup>8</sup> Kërkesë e datës 05.02.2024, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Kërkesë e datës 21.02.2024, e subjektit të rivlerësimit është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë; Dërgesa postare me numër "{\*\*\*}", datë 21.02.2024; Kërkesë e datës 13.02.2024, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2024, e Prokurorisë pranë gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Kërkesë e datës 13.02.2024, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 11.03.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Kërkesë e datës 05.02.2024, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Kërkesë e datës 21.02.2024, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

nuk meritojnë një vlerësim të këtyre kriterëve dhe formalisht do të ishin të papranueshme në zbatim të dispozitave procedurale që rregullojnë gjykimin në Apel/Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

*Së treti*, pavarësisht mosplotësimit të kriterëve procedurale për pranimin dhe marrjen me cilësinë e provës të akteve të reja që subjekti ka paraqitur me ankimin dhe parashtrimet, trupi gjykues në funksion të një analize shteruese dhe të një gjykimi sa më drejtë, i analizoi ato kryesisht, në drejtim të vlerës së tyre provuese dhe ndikimit potencial që këto akte mund të kishin mbi zgjidhjen e çështjes. Rezulton se një pjesë e këtyre akteve kryesisht konfirmojnë informacionin e shkresave që tashmë disponohen në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit.

*Së katërti*, rezulton se një pjesë e akteve të sjella me parashtrimet synojnë të mbështesin pretendimet e subjektit të paraqitura në to, të cilat shfaqen për herë të parë në këtë akt dhe nuk kanë qenë pjesë e pretendimeve të subjektit në Komision, por edhe as në ankim. Trupi gjykues vlerësoi se këto pretendime të shfaqura rishtas në parashtrime duhen konsideruar se kanë rënë në dekadencë edhe sipas një interpretimi të zgjeruar të nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile<sup>9</sup>, duke qenë se ato nuk janë paraqitur aspak gjatë hetimit në Komision dhe, si të tilla, nuk gëzojnë më mbrojtje ligjore në gjykimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për pasojë edhe aktet që synojnë mbështetjen e tyre janë të panevojshme të merren me cilësinë e provës së re, qoftë edhe në këtë kontekst.

**15.4.** Pavarësisht mosplotësimit të kriterëve formale për marrjen e provës së re, trupi gjykues vlerësoi përmbajtjen e tyre edhe në këndvështrim të së drejtës së tij për të marrë prova kryesisht, por i gjeti ato të panevojshme për t'u marrë si të tilla, duke qenë se nuk përmbanin të dhëna që të mund të përcaktonin zgjidhjen e çështjes në kuptim të nenit 49, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 84/2016. Për sa më lart, trupi gjykues vendosi refuzimin e marrjes së këtyre akteve me cilësinë e provës së re dhe, pasi analizoi edhe pretendimet që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe rëndësinë e shkeljeve procedurale të pretenduara, të cilat do të shtjellohen në vijim, gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke qenë se nuk u verifikua asnjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, gjykimi i çështjes u zhvillua në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

**15.5.** Pavarësisht sa më lart arsyetuar, trupi gjykues, për një shqyrtim sa më garantist të ankimit të subjektit, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, korrektoi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, ato gabime materiale dhe të konstataueshme, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime për herë të parë në parashtrimet e përcjella në Kolegj. Këto pretendime u trajtuan nga trupi gjykues, në çdo rast kur objektivisht nga verifikimi i të dhënave të fashikullit të Komisionit, ato rezultonin të drejta dhe të bazuara, dhe evidentonin një paraqitje

---

<sup>9</sup> Kur kërkesat dhe pretendimet e pamarra parasysh në vendimin e shkallës së parë nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre.

jo të saktë të të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

### ***B. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor***

16. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni me vendimin e dhënë për të, ka kryer shkelje të nenit 7 të KEDNj-së për shkak se ka cenuar parimin e sigurisë juridike.*

16.1. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në ankim si elementë që sipas tij kanë shkaktuar *cenim të parimit të sigurisë juridike*, identifikon: i. kërkesën e Komisionit për justifikimin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive nga babai i subjektit, të cilat ky i fundit i ka përfituar me anë të trashëgimisë ligjore, përpara emërimit në detyrë; si dhe ii. faktin se në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, është ngarkuar me përgjegjësi për çështje/procedime penale të cilat janë ende në proces hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor, duke u klasifikuar për rrjedhje si “*çështje që janë në shqyrtim*” për të cilat neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon ndalimin e shqyrtimit të tyre në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar; iii. përfshirjen në vendim të termave si “*pasaktësi në deklaratën vetting*”, “*deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave*”, “*deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë*”, që nuk përfshihen/gjenden në ligjin nr. 84/2016, dhe për pasojë përdorimi i tyre ka sjellë interpretimin e ligjit në mënyrë arbitrare; iv. pas miratimit të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), kompetenca për vlerësimin e etikës dhe sjelljes së magistratëve jashtë funksionit, nuk i takon organeve të rivlerësimit por organeve kompetente, në këtë rast Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) apo KLP-së.

16.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është ngarkuar me të padrejtë me përgjegjësinë për të justifikuar burimet e ligjshme të pasurive që i ka përfituar nga trashëgimia ligjore pas vdekjes së babait të tij, e cila për më tepër ka ndodhur në vitin 2001, përpara se subjekti të emërohej në funksionin e Prokurorit (në vitin 2015), trupi gjykues konstaton se megjithëse nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti se bashku me nënën dhe motrën, si trashëgimorë ligjorë të babait, kanë përfituar disa pasuri të paluajtshme (të cilat babai i kishte krijuar nga angazhimi në zhvillimin e pasurive të paluajtshme të personave të tretë), Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit vetëm për pasurinë garazh me sip. 108,72 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, të cilën subjekti e ka deklaruar si pasuri në pronësi të tij në deklaratën vetting, por nuk ka deklaruar burimet e krijimit/financimit të saj. Gjithashtu, nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri, me anë të kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2013, në të cilën është deklaruar se ai me cilësinë e palës blerëse ka paguar çmimin rreth 52.000 euro dhe jo nëpërmjet trashëgimisë ligjore të babait të tij.

16.3. Në këto kushte, *a prima facia*, pasuria “garazh” e ndodhur në Tiranë, e fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes vetëm nga subjekti dhe jo nga trashëgimtarët e tjerë ligjorë të babait të tij, nëna dhe motra, gëzonte statusin e një pasurie për të cilën subjekti, në këndvështrim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, duhej të provojë burimet e ligjshme të krijimit të saj.

Gjithashtu për shkak të faktit se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ishte në ushtrim të tagrave të tij legjitime për të kontrolluar mënyrën se si ajo është krijuar dhe nëse subjekti e justifikonte atë me burime të ligjshme. Në këtë kontekst, Komisioni ka kërkuar shpjegime dhe ka ftuar subjektin të tregojë burimet e krijimit të saj. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ajo është ftuar nëpërmjet trashëgimisë, nuk rezultojnë të bazuara në aktet e cituara më lart, për pasojë hetimi i thelluar rreth verifikimit të burimeve të krijimit të pasurisë, është kryer në përputhje të plotë me parashikimet e neneve 30 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë e tij hetimore lidhur me këtë pasuri në harmoni me tagrat e caktuara atij prej Kushtetutës dhe ligjit, asnjë veprimtari përtej këtyre parashikimeve nuk rezulton të jetë ushtruar prej tij. Për pasojë, pretendimi se është cenuar parimi i sigurisë juridike nëpërmjet kryerjes së kësaj veprimtarie, vlerësohet i pabazuar ligjërisht.

16.4. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se përfshirja në vendim e termave si *“pasaktësi në deklaratën vetting”*, *“deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave”*, *“deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”*, që nuk gjenden në ligjin nr. 84/2016, ka sjellë interpretimin e ligjit në mënyrë arbitrare, trupi gjykues vlerëson se: *së pari*, koncepti i *deklarimit të pamjaftueshëm të të ardhurave dhe pasurive*, i saktësisë së deklarimit, janë koncepte të përcaktuara që në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”* (shih nenin 25 dhe nenin 27<sup>10</sup>), koncepte të cilat janë konfirmuar dhe përforcuar në ndryshimet që ky ligj ka pësuar ndër vite. *Së dyti*, në vijim, me miratimin e Aneksit të Kushtetutës, në nenin D të tij është përcaktuar detyrimi që subjektet e rivlerësimit *i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur*. Po ashtu edhe ligji nr. 84/2016, në nenin 61 përcakton qartë se shkarkimi i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në rastet [...] Kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji. *Së treti*, si Komisioni ashtu edhe Kolegji në shumë raste në jurisprudencën e tyre, madje që në vendimmarrjet e para, kanë

---

<sup>10</sup> Në ligjin nr. 9049/2003, në nenin 25, dispozitë e cila më pas është ndryshuar, është përcaktuar se:

*“1. Kontrolli i deklarimeve përfshin kontrollin, aritmetik e logjik, dhe verifikimin e miratimit e të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë).*

*Kontrollin, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklarim për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara.*

*Verifikimi i miratimit të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë) bëhen për ato deklarime, të cilat, nga kontrollin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, paraqesin probleme, papajtueshmëri dhe parregullsi në justifikimin e burimeve të mbulimit të pasurisë ose në pasurinë e deklaruar dhe në deklarime të tjera, sipas skemës së kontrollit [...]”.*

*Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se: “Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë ose ai i ulët thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim”.*

argumentuar qartë çfarë do të konsiderohet deklaram i pasaktë i pasurisë dhe çfarë përbën deklaram të pamjaftueshëm të saj, si dhe peshën që ato kanë në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Bazuar në këtë analizë, trupi gjykues, pretendimet e subjektit për përdorimin abuziv të termave të mësipërm, e konsideron jo të drejtë dhe të pa argumentuar ligjërisht.

**16.5.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se parimi i sigurisë juridike është cenuar edhe për shkak se Komisioni ka marrë në shqyrtim në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, çështje të cilat gjenden në ndalimin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe çështje të cilat nuk i takojnë periudhës së rivlerësimit dhe duhet të trajtohen nga institucionet e juridiksionit të zakonshëm të kontrollit si ILD-ja e KLP-ja*, trupi gjykues konstaton e vlerëson si më poshtë.

**16.6.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe parashtrime, pothuajse për të gjitha çështjet profesionale të analizuara në vendim (për shkak të denoncimeve ose jo), fillimisht kundërshton vlerësimin e bërë për to nga Komisioni duke pretenduar se këto çështje/procedime penale/materiale kallëzuese nuk duhet të jenë objekt shqyrtimi/analize, pasi ato gjenden ende në fazë hetimi apo në shqyrtim gjyqësor. Referuar ankimit rezulton se subjekti në këtë grupim përfshin çështjet/procedimet penale të cilat: (i.) janë ende në fazën e hetimit paraprak<sup>11</sup>, duke u ndjekur nga organi i akuzës; (ii.) gjykata ia ka kthyer organit të akuzës për hetime të mëtejshme; (iii.) gjenden të depozituara pranë gjyqtarit të seancës paraprake<sup>12</sup>, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm<sup>13</sup> apo pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm<sup>14</sup>, në pritje të vendimmarrjes nga organet proceduese respektive.

**16.7.** Trupi gjykues, nga analizimi i përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, si dhe i të dhënave të hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e mësipërme, konstaton se të gjitha procedimet penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit apo materialet kallëzuese të trajtuara prej tij, të cilat ndodhet në faza të ndryshme të procedimit penal, qoftë ashtu si i pretendon subjekti, karakterizohen në thelb nga dy elementë të rëndësishëm që diktojnë vlerësimin e trupit gjykues lidhur me këtë pretendim. *Së pari*, subjekti i rivlerësimit ka marrë qëndrimet e tij lidhur me këto procedime, nëpërmjet vendimeve për pushimin e tyre apo dërgimin e tyre për gjykim ose ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materiale kallëzuese të analizuara. Për shkak të këtyre rrethanave, trupi gjykues vlerëson se këto vendime apo veprimtari hetimore të kryera prej subjektit në funksion të ndjekjes së këtyre çështjeve, dalin nga mbulimi apo ndalimi i nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili ndalon institucionet e rivlerësimit të marrin në

---

<sup>11</sup> Si çështje/procedime penale që në momentin e shqyrtimit nga Komisioni ato gjenden ende në fazën e hetimit paraprak subjekti identifikon: procedimin penal nr. {\*\*\*/2021; procedimin penal nr. {\*\*\*/2019; procedimin penal nr. {\*\*\*/2020; materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 04.08.2021 (procedimi penal nr. {\*\*\*/2023); procedimin penal nr. {\*\*\*/2020; procedimin penal nr. {\*\*\*/2020.

<sup>12</sup> Si çështje/procedime penale që gjenden për shqyrtim pranë gjyqtarit të seancës paraprake në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë subjekti identifikon: procedimin penal nr. {\*\*\*/2017; procedimin penal nr. {\*\*\*/2017; procedimin penal nr. {\*\*\*/2017.

<sup>13</sup> Si çështje/procedim penal që gjenden për shqyrtim pranë gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë identifikon procedimin penal nr. {\*\*\*/2019.

<sup>14</sup> Si çështje/procedim penal që gjenden për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, identifikon procedimin penal nr. {\*\*\*/2017.

analizë në funksion të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, çështje të cilat janë ende nën shqyrtim. Kolegji i Posaçëm i Apelit në jurisprudencën e tij<sup>15</sup>, tashmë të konsoliduar, ka mbajtur qëndrimin se mund t'i nënshtrohen kontrollit, çështje për të cilat subjektet e rivlerësimit kanë mbajtur qëndrimin e tyre përfundimtar nëpërmjet marrjes së një vendimi për disponimin lidhur me to, pavarësisht se ky qëndrim mund të jetë ende objekt kontrolli prej organeve proceduese apo edhe kthyer nga Gjykatat për hetime të mëtejshme. *Së dyti*, me rendësi në këtë vlerësim është edhe fakti nëse çështjet penale të zgjidhura më parë prej subjekteve të rivlerësimit, janë kthyer, apo potencialisht, mund të kthehen sërish në ngarkim të tyre për shkak të vendimeve të gjykatës që kanë vendosur plotësimin e mëtejshëm të hetimeve, veçanërisht kur subjektet janë prokurorë. Kjo rrethanë do të ishte sipas jurisprudencës së Kolegjit një pengesë që do të ndalonte analizimin e çështjes, në përputhje me parashikimin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në funksion të ndalimit me çdo mënyrë që procesi i rivlerësimit kalimtar për magjistratët të ndikonte në zgjidhjen e ndonjë çështjeje ende në shqyrtim prej magjistratit që i nënshtrohet procesit.

**16.8.** Në rastin objekt analize, nuk rezulton asnjë rast që për denoncimet e trajtuara prej Komisionit apo çështjet profesionale të marra në analizë prej tij, të ketë qenë nën shqyrtim prej subjektit të rivlerësimit në kohën e kryerjes së hetimit administrativ. Në këto kushte, hetimi i kryer prej Komisionit lidhur me to, përjashton çdo mundësi për ndikim tek magjistrati për zgjidhjen e tyre sipas këndvështrimit apo qasjes së Komisionit, të shfaqur në pyetje apo në barrë prove apo edhe në vendimin përfundimtar. Kjo situatë është kaq e vërtetë, sa që nuk mund as të aludohet ndonjë ndikim i subjektit, qoftë edhe hipotetik, të çështjet në shqyrtim nga magjistratë të tjerë, edhe për faktin se e gjithë veprimtaria funksionale e subjektit, e marrë në analizë prej Komisionit, është ushtruar prej tij në funksionet si prokuror në zyrat e Prokurorisë Sarandë e Pogradec, ndërsa në kohën e kryerjes së hetimit administrativ, subjekti ishte transferuar tashmë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke përjashtuar në terma absolutë, mundësinë që ai të trajtonte, në të tashmen apo të ardhmen e hetimit administrativ, ndonjë prej çështjeve të analizuara prej Komisionit.

**16.9.** Në përfundim, trupi gjykues konfirmon të njëjtin qëndrim me Komisionin se, pavarësisht faktit se çështjet që janë marrë në analizë lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale mund të gjenden në statusin *në hetim paraprak* apo *për shqyrtim para gjyqtarit të seancës paraprake*, pasi përveç të tjerave, verifikimi i faktit se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimet respektive për to dhe nuk ka më asnjë mundësi, qoftë edhe teorike, të rimarrë ato në shqyrtim, për shkak të transferimit në një prokurori e cila nuk i ka këto çështje në kompetencën e saj tokësore, bën të paaplikueshëm ndalimin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, vlerësohet se Komisioni ka ushtruar funksionet brenda kompetencave të tij ligjore duke shqyrtuar këto çështje në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.

**16.10.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka aplikuar në mënyrë të gabuar ligjin, pasi ka marrë në shqyrtim në funksion të kriterit të vlerësimit të aftësive*

---

<sup>15</sup> *Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr. 7/2019; (JR) nr. 44/2024.*

*profesionale, çështje/procedime penale të cilat janë regjistruar si të tilla pas hyrjes në fuqi<sup>16</sup> të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton e vlerëson sa vijon.*

16.11. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se, ndërsa vlerësimi profesional i magjistratëve përgjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar realizohet duke u bazuar në ligjin nr. 84/2016, si dhe në ligjin nr. 96/2016, periudha që duhet t'i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr. 84/2016, është ajo e shtrirë në tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016, dhe në mënyrë përjashtimore, vlerësimi profesional mund të shtrihet deri në 1 janar 2006. Në asnjë rast, sipas këtij pretendimi, institucionet e rivlerësimit nuk mund të analizojnë çështje që janë trajtuar prej subjekteve pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 e sidomos pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 96/2016"), periudhë për të cilën kompetencat kontrolluese ushtrohen prej ILD-së e KLP-së.

16.12. Trupi gjykues, lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, ashtu siç referon edhe Komisioni në vendim, sjell në vëmendje se tashmë Kolegji në jurisprudencën<sup>17</sup> e tij ka mbajtur një qëndrim të qartë edhe për sa i përket periudhës së rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke argumentuar se, si e tillë në referim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, kjo periudhë mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, deri në kohën e kryerjes së procesit hetimor administrativ e madje deri edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegji.

16.13. Në mbështetje të këtij arsytimi, Kolegji në jurisprudencën e tij ka analizuar një sërë elementesh, duke e potencuar fillimisht parashikimin e nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili ndërsa identifikon pikën fillestare të ecjes së afatit që përcakton shtrirjen e periudhës përgjatë së cilës subjektet mund t'i nënshtrohen kontrollit të aftësive profesionale, nuk ka përcaktuar një pikë fundore të tij, duke potencuar shprehimisht se kjo periudhë vijon të ketë relevancë për vlerësimin e kriterit profesional, përderisa vetë procesi i rivlerësimit është *në vazhdim*. Kolegji ka interpretuar në këtë mënyrë ligjin edhe për shkak të veçantisë që paraqet kontrolli mbi këtë kriter, i cili është vlerësuar të jetë dinamik dhe të mos ndalet me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 apo nisjen e procesit të rivlerësimit. Parashikimi ligjor që lejon paraqitjen e denoncimeve nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, si edhe fakti që institucionet e rivlerësimit mund të vlerësojnë në mënyrë të përgjithshme *të tri kriteret e rivlerësimit, apo edhe në tërësi procedurat*, në të cilat përfshihet edhe sjellja e subjektit të rivlerësimit në drejtim të bashkëpunimit për kriterin e aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit E, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës, sugjeron, kontrollin në dinamikë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Në përcaktimin e shtrirjes së periudhës së rivlerësimit përtej viteve 2013-2016, neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84.2016, përcakton se është i mjaftueshëm

---

<sup>16</sup> Në ankim subjekti si çështje të filluara pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.84/2016 identifikon: procedimin penal nr. {\*\*\*/2021; procedimin penal nr. {\*\*\*/2017; procedimin penal nr. {\*\*\*/2017; procedimin penal nr. {\*\*\*/2019; procedimin penal nr. {\*\*\*/2017; procedimin penal nr. {\*\*\*/2020; materialin kallëzues nr. {\*\*\*/, datë 04.08.2021 (procedimi penal nr. {\*\*\*/2023); procedimin penal nr. {\*\*\*/2017; materialet kallëzuese nr. {\*\*\*/, datë 17.05.2017, dhe nr. {\*\*\*/, datë 04.02.2022; procedimin penal nr. {\*\*\*/2020; procedimin penal nr. {\*\*\*/2020; procedimin penal nr. {\*\*\*/2019.

<sup>17</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. 16/2021(JR).

vetëm konsiderimi si domosdoshmëri i kryerjes së këtij vlerësimi, prej relatorit të çështjes apo vëzhguesit ndërkombëtar. Vetë dispozita nuk përcakton ndonjë formë të caktuar që duhet të veshë këtë vlerësim, dhe në rastin konkret, fakti që trupa gjykuese ka miratuar raportin për rezultatet e hetimit paraprak i cili ka shtrirë hetimin edhe përtej periudhës 2013-2016, provon vullnetin jo vetëm të relatores, por të gjithë trupës gjykuese të Komisionit, për ta shtrirë këtë proces në këta terma kohorë, vendim që vjen në përputhje edhe me interpretimin pajtues që bën Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017<sup>18</sup>. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur trupa e Komisionit edhe në vendimin përfundimtar, duke e shpallur qartë vullnetin e saj për realizimin e vlerësimit të aftësive profesionale në këto kufij kohorë, të cilët janë vendosur kryesisht si nevojë e hetimit të denoncimeve të ardhura për subjektin në Komision. I vetmi kufizim që duhet të konsiderojnë institucionet e rivlerësimit në këtë drejtim duket se është ndalimi i parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili nuk lejon shtrirjen e vlerësimit të aftësive profesionale në çështjet që janë në shqyrtim nga subjektet, në kohën e kryerjes efektivisht të procesit të rivlerësimit. Përveç se leximit si një kufizim, ky parashikim përforcon dhe mbështet qëndrimin e mbajtur se kontrolli mund të vijojë edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, përndryshe nuk do të kishte asnjë logjikë një parashikim i tillë kushtetues. Pikërisht ky përcaktim që ngrihet prej subjektit për të kufizuar kontrollin mbi çështjet që janë në shqyrtim, rrëzon pretendimin tjetër të tij, që periudha e cila mund të kontrollohet për efekt të kriterit profesional, nuk shtrihet përtej hyrjes në fuqi të ligjit. Në këtë kuptim, trupi gjykues nuk konstatoi asnjë veprimtari procedurale të Komisionit të kryer përtej parashikimit kushtetues e ligjor, apo të vinte në kontradiktë me jurisprudencën e Kolegjit, e në këtë sens, parimi i sigurisë juridike nuk konstatohet të jetë cenuar aspak.

**16.14.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit me të cilin kundërshton si jo të drejtë analizën e bërë nga Komisioni, për çështje/procedime penale/materialet kallëzuese, të cilat në momentin e analizimit nga Komisionit nuk kanë qenë në shqyrtim prej tij, për shkak të transferimit në një prokurori tjetër, trupi gjykues vlerëson se është pa relevancë për kontrollin e vendimit të Komisionit. Ashtu si edhe subjekti potencon, Komisioni ka ushtruar kontroll, bazuar kryesisht mbi denoncimet nga publiku, mbi veprimtarinë hetimore dhe vendimet e marra prej subjektit të rivlerësimit në çështjet e trajtuara, disa prej të cilave siç edhe trupi gjykues vërejt, nuk kanë qenë më në ngarkim të subjekti të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, por të prokurorëve të tjerë, edhe për faktin se ai është larguar nga zyrat e prokurorive për llogari të të cilave kishte kryer hetimet. Në këtë kontekst, rezulton i pakuptimtë pretendimi/shqetësimi i tij për sa kohë që subjekti është thirrur në përgjegjësi për mënyrën se si ai e ka ushtruar funksionin e tij në këto çështje dhe jo për fatin që kanë pasur çështjet pasi ato janë marrë për trajtim nga prokurorë të tjerë. Kjo fazë procedurale nuk ka afektuar në asnjë rast vlerësimin e Komisionit për aftësitë e subjektit, për pasojë, trupi gjykues e gjen atë pa asnjë ndikim në kontrollin e vendimit të Komisionit.

**16.15.** Lidhur me pretendimin e subjektit se pas miratimit të ligjit nr. 96/2016, kompetenca për vlerësimin e etikës dhe sjelljes së subjektit/magjistratit jashtë funksionit nuk i takon organeve të rivlerësimit por organeve kompetente, në këtë rast ILD-së apo KLP-së, trupi gjykues, duke iu referuar problematikës që Komisioni ka marrë në analizë për shkak të sjelljes së subjektit

---

<sup>18</sup> Paragrafi 57.

jashtë funksionit, vlerëson se ajo bën pjesë në tagrat e vlerësimit të komponentit të etikës së magjistratit, e cila lidhet jo vetëm me veprimtarinë profesionale, por edhe me sjelljen e tij jashtë saj. Procesi i rivlerësimit, ka si pjesë integrale të tij, kontrollin e figurës së magjistratëve, veprimtari e cila jo domosdoshmërisht lidhet me funksionin, por synon evidentimin e subjekteve që kanë sjellje të papërshtatshme për staturën e pritshme të një magjistrati e që lidhen me kontaktet e tyre me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në këtë kontekst, sjellja e subjektit të rivlerësimit jashtë funksionit, e cila është e shoqëruar me kontakte shoqërore me persona të cilët duket se cenojnë figurën dhe integritetin e tij nga perspektiva e një vëzhguesi të jashtëm, mbetet një atribut i institucioneve të rivlerësimit, për të konkluduar rreth mundësisë së cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pikërisht për shkak të kësaj sjellje. Në këtë kuptim, marrja në analizë e këtij komponenti, veçanërisht në kontekstin e matjes së besimit të publikut, vlerësohet prej trupit gjykues, si një prej kompetencave të institucioneve të rivlerësimit në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, edhe këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues e gjen të pabazuar dhe parimin e sigurisë juridike të pacenueshëm nga veprimtaria e Komisionit.

**16.16.** Në referim të sa analizuar më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit të adresuara për çdo çështje profesionale të analizuar në vijim, e që përsërisin pretendimet e marra në analizë si më lart, lidhur me shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor, do të duhet të kuptohen në funksion të këtij vendimi si të arsyetuara më lart të gjetura të pambështetura, pa përsëritur të njëjtën analizë që gjithsesi do të shoqëronte edhe individualisht secilën prej çështjeve të kriterit të aftësive profesionale.

### ***C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

17. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, pasurinë e paluajtshme nr. {\*\*\*}, me sip. 108,72 m<sup>2</sup>, të llojit garazh me vendndodhje në Tiranë, për të cilën Komisioni ka konkluduar se ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj. Në funksion të kontrollit të vendimit lidhur me këtë konkluzion, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton si të padrejtë dhe të pa bazuar ligjërisht, qëndrimin e Komisionit, duke pretenduar se: *i. prej tij nuk është investuar/shpenzuar asgjë për përfitimin e kësaj pasurie, pasi është krijuar nga i ati, dhe se subjekti e ka përfituar si trashëgimtar pas vdekjes së tij; ii. përfshirja në mënyrë të padrejtë e këtij shpenzimi në analizën financiare të subjektit për më tepër ka ndikuar rezultatin e analizës financiare për blerjen e automjetit në vitin 2007, si dhe për krijimin e kursimeve në cash të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës.* Nga analiza e pretendimeve të mësipërme bazuar në faktet e provuara gjatë hetimit administrativ ka rezultuar si vijon.

**17.1.** Në vendimin e Komisionit, për pasurinë e paluajtshme nr. {\*\*\*}, me sip. 108,72 m<sup>2</sup>, të llojit garazh me vendndodhje në Tiranë, është mbajtur qëndrimi se subjekti ka bërë deklarime të pasakta lidhur me burimin e krijimit të saj në deklaratën *vetting* dhe në atë të para fillimit të detyrës. Gjithashtu, Komisioni i ka konsideruar kontradiktore deklaratimet e subjektit lidhur me faktin se ai gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nuk ka kryer financime për fitimin e saj pasi kjo pasuri është fituar me anë të trashëgimisë ndërsa kontrata e shitblerjes tregon të kundërtën. Duke konsideruar se subjekti e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së

shitblerjes, Komisioni ka kontrolluar mundësinë e subjektit për ta krijuar atë me burime të ligjshme dhe nga analiza financiare i ka rezultuar se ai ka qenë në pamundësi të financojë atë me burime të ligjshme, pasi për periudhën 2005 – 2015 ka rezultuar me një balancë negative, për blerjen e ½ së garazhit dhe krijimin e pasurive të tjera, në shumën 3.275.572 lekë, nga të cilat shuma prej 2.700.000 lekë i përket pasurisë garazh, ndërsa për diferenca prej 500.000 lekë, i përket pasurisë automjetet dhe likuiditetet të deklaruar nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015. Pavarësisht këtyre konstatimeve, Komisioni në përfundim të vlerësimit të pasurisë ka konkluduar se: *pasaktësitë në deklaram të konstatuara në deklaratën vetting, si dhe mungesa e burimeve të ligjshme për pasuritë e krijuara para marrjes së detyrës së prokurorit, (në total balanca negative në shumën 3.2 milion lekë), nuk përbën shkak të mjaftueshëm për të aplikuar dispozitat e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por do të mbahen në konsideratë nga Komisioni, në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit.*

17.2. Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në ankim përsërit pretendimin e ngritur prej tij edhe në Komision, se ajo nuk duhet konsideruar si pasuri e krijuar me të ardhurat e subjektit, pasi sipas tij është një investim i kryer nga babai i tij. Sipas këtij pretendimi, pas vdekjes së babait të tij, me qëllim kalimin e pronësisë mbi pasurinë garazh, është përdorur *si instrument ligjor*, kontrata e shitblerjes e cila në fakt për subjektin nuk është shoqëruar me efekt financiar. Ndërsa lidhur me mosdeklarimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie si në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2015, ashtu dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka ndodhur për shkak të moskuptimit të qartë të përcaktimeve dhe të kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003) si dhe të ligjit nr. 84/2016, duke shpjeguar se ka vlerësuar si thelbësore deklarimin e pasurive dhe jo burimet e krijimit të tyre.

17.3. Përveç pretendimeve të mësipërme, subjekti ka prezantuar në parashtrimet e depozituara para seancës gjyqësore në Kolegj edhe kundërshti të tjera që lidhen me vendimin e Komisionit dhe që i adresohen moskalimit të barrës së provës për kostot e ndërtimit të kësaj pasurie, e cila duhet të llogaritet në një vlerë prej 40-42% të çmimeve referuese të EKB-së. Këto kundërshti synojnë të provojnë faktin se babai i tij ka pasur mundësi të ndërtojë këtë pasuri me burime të ligjshme, e cila më pas i ka kaluar subjektit, me anë të trashëgimisë pas vdekjes së tij.

17.4. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të mësipërme, fillimisht mori në analizë deklaratimet e bëra për këtë pasuri nga subjekti i rivlerësimit si dhe të dhënat e administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, nga të cilat rezulton se:

i. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Garazh<sup>19</sup> me sipërfaqe 108,72 m<sup>2</sup>, në Tiranë, blerë në datën 14.06.2013, me pjesë takuese ½, në vlerën 5.400.000 lekë.

---

<sup>19</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e njëzuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. {\*\*\*} rep., datë 24.10.2016:

ii. Në DVP-në e vitit 2015, (para fillimit të detyrës) subjekti ka deklaruar se: Pasuria nr. {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, Tiranë, e llojit “garazh”, sip.108,72m<sup>2</sup>, blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2013, bashkëpronësi e disponuar me certifikatë pronësie, me numër serie “{\*\*\*}” datë lëshimi 08.08.2013. Vlera: 5.400.000 lekë. Pjesa takuese: ½.

17.5. Nga të dhënat e mësipërme, si ato të akteve të përcjella në Komision prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “ASHK”), konstatohet se: (i.) ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, të drejtat e bashkëpronësisë mbi garazhin me sip. 108,72 m<sup>2</sup> në Tiranë, ai i ka siguruar nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., të lidhur më datë 14.06.2013; (ii.) këto të drejta bashkëpronësie, subjekti nuk i ndan me nënën dhe motrën e tij si trashëgimtarë ligjorë të babait, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2011, por i ndan me z. A. Z., i cili në kontratën e shitblerjes ashtu si dhe subjekti identifikohet si blerës i kësaj pasurie; (iii.) në deklaratën fillestare para fillimit të detyrës, të vitit 2015, si dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimet e financimit të përdorura për blerjen e garazhit në vitin 2013; (iv.) në kontratën noteriale të shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., të datës 14.06.2013, të lidhur ndërmjet palës shitëse I. K. e V. K. dhe palës blerëse Ilir Hoxha e A. Z., pasqyrohet se kalimi i pronësisë mbi këtë pasuri kryhet kundrejt pagimit të çmimit të saj i cili përcaktohet të jetë 5.400.000 lekë. *Palët pjesëmarrëse në këtë kontratë kanë rënë dakord që vlera e shitjes është likuiduar jashtë kësaj zyre noteriale në formën “me lekë në dorë”. Palët pjesëmarrëse në këtë kontratë nuk kanë asnjë pretendim për likuidimin e vlerës totale të çmimit të shitjes pasi janë likuiduar dhe nuk kanë asnjë pretendim për shumën e marrë.* Referuar në këto të dhëna, që burojnë nga kontrata e shitblerjes, e cila ka fuqinë provuese të një akti zyrtar me fuqi të plotë për sa palët kanë deklaruar në të, në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, dhe në mungesë të ndonjë akti tjetër zyrtar që do të tregonte të kundërtën, se kjo pasuri ka kaluar te subjekti në ndonjë formë tjetër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e arritur nga Komisioni se pronësia e subjektit mbi këtë pasuri është fituar nëpërmjet veprimit juridik të shitjes dhe jo trashëgimisë ligjore, siç pretendon subjekti.

17.6. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm që vjen nga analiza e çmuarja e vlerës provuese të provave, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet e detajuara të subjektit që synojnë të zhbëjnë vlerën provuese të kontratës së shitblerjes, nëpërmjet rrethanave të faktit që sipas tij provojnë se garazhi ka qenë pjesë e një ndërtimi të financuar prej babait të tij, së bashku e persona të tjerë si investitorë, dhe se kalimi te subjekti me kontratë shitblerje nuk është gjë

- 
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 6.8.2013, për pasurinë nr. {\*\*\*}, lloji “garazh”, me sip. 108,72 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, në emër të shtetasve Ilir Hoxha dhe A. Z., e shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;
  - kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I. K. e V. K. (R.), përfaqësuar me prokurë nga shtetasi I. K. dhe palës blerëse Ilir Hoxha e A. Z. Çmimi i shitjes 5.400.000 lekë i likuiduar cash jashtë zyrës noteriale;
  - prokurë e përgjithshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.10.2007, ku shtetasit V. K. (R.), A. K. dhe E. K. deklarojnë se emërojnë si përfaqësues të posaçëm shtetasin I. K. të cilit i japin të drejtën të veprorë në emër dhe për llogari të tyre, me të gjitha tagrat që i njeh ligji, në lidhje me pronat që janë në bashkëpronësinë e tyre;
  - certifikatë për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 7.2.2013, të pasurisë nr. {\*\*\*}, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, në emër të I. K., shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë.

tjetër veçse një formë që mundëson fitimin formal të të drejtave pasurore mbi këtë pasuri. Pikërisht për shkak të kësaj situatë, sipas subjektit të rivlerësimit, ai në deklaratat e pasurive ndër vite si dhe në deklaratën *vetting*, ka pasur në fokus mos lënien pa deklaruar të asnjë prej pasurive të paluajtshme, duke mos qenë i qartë se duhet të deklaronte burimin e financimit të tyre, qëndrim të cilin ai e ka mbajtur jo vetëm për garazhin, por edhe për pasuritë e tjera, për të cilat ai sërish nuk ka deklaruar burimin e krijimit (*përfshirë edhe automjetin e blerë në vitin 2007*).

17.7. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues vlerëson *a prima facie*, se ato nuk janë bindëse, për sa kohë si në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 30, 31 dhe 32 të ligji nr. 84/2016, ashtu edhe në ligjin nr. 9049/2003, në funksion të kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është mirëpërcaktuar detyrimi i subjekteve të rivlerësimit, për të deklaruar burimet e krijimit të pasurive në pronësi apo në përdorim, të cilat duhet më pas t'i nënshtrohen kontrollit prej institucioneve të rivlerësimit. Në të tilla kushte, trupi gjykues vlerëson se në referim të këtyre kërkesave ligjore, subjekti, mbi të gjitha në deklaratën *vetting*, duhet të jepte të dhëna e të identifikonte qartë të gjitha burimet e krijimit të secilës pasuri që kishte në pronësi apo përdorim, në momentin e plotësimit të kësaj deklarate. Gjithashtu, trupi gjykues sjell në vëmendje se edhe vetë formati i shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, e njohur si deklarata e pasurisë *vetting*, në rubrikat e saj ka të mirëpërcaktuar detyrimin për deklarimin e të gjitha burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim. Në këtë kontekst, ndonëse mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive, si në rastin konkret, nuk është përcaktuar përgjithësisht me një ndikim domethënës në vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektet e rivlerësimit, u analizua si më sipër për të arsyetuar pse trupi gjykues e gjen jo bindës shpjegimin e subjektit se ai nuk kishte qartësi për detyrimin e deklarimit të burimit të pasurisë objekt kontrolli. Lënia pa shpjegim/pa deklarim e një detyrimi të tillë, i lë mundësi subjektit që të modifikojë atë përgjatë hetimit administrativ në varësi të nevojave të tij e çështjeve të ngritura me gjasë prej Komisionit. Në këtë kuptim, mosdeklarimi prej tij i burimit të pretenduar, trashëgimisë ligjore, vlerësohet si një element që nuk i shërben besueshmërisë së tij në drejtim të ekzistencës së këtij burimi, në konsideratë edhe të rrethanave të tjera të faktit që kanë rezultuar prej hetimit lidhur me këtë pasuri.

17.8. Për sa më lart, trupi gjykues konstaton se ndonëse ka indikatorë që mund të sugjerojnë se pasuria *garazh* në Tiranë, rrjedh nga angazhimet si ndërtues që ka pasur babai i subjektit deri në vitin 2011, po ashtu konstatohen edhe të dhëna që e diferencojnë marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri nga raportet dhe angazhimet që subjekti ka tërhequr për pasuritë e tjera të përfituara/të prejardhura prej trashëgimisë ligjore pas vdekjes së babait të tij.

Kështu, ndërsa subjekti i rivlerësimit në kontratat e shitblerjes për pasuritë e llojit "*apartament*", pjesë të objektit në pronësi të z. I. K., e të krijuara prej shoqërisë investitore "{\*\*\*}" ShPK, në të cilën babai i subjektit ishte njëri prej ortakëve: i. ka vepruar me cilësinë e përfaqësuesit ligjor të babait të tij, duke iu kaluar pronësinë personave të tretë, me të cilët babai i subjektit kishte lidhur kontrata porosie dhe kishte përfituar pagesa; ii. në kalimin e pronësisë së garazhit, tek ai dhe bashkëpronari tjetër, z. A. Z., ai nuk shfaqet në këtë cilësi, por në atë të blerësit, ndonëse garazhi është pjesë e të njëjtit objekt të ndërtuar prej të njëjtëve investitorë. Këto rrethana dobësojnë besueshmërinë e shpjegimeve të subjektit drejt mënyrës

së fitimit të kësaj pasurie. Nëse kjo pasuri ishte pjesë e objektit të ndërtuar prej babait të tij dhe duhej të përfitohej prej subjektit në korrespondencë të pjesës së tij takuese në raport me investimin, ajo do të mund të fitohej prej subjektit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga z. I. K., në emër të të cilit ishte regjistruar i gjithë objekti për shkak të pasjes së pronësisë mbi truallin në të cilin ai ishte ndërtuar, pasi asnjë rrethanë penguese nuk rezultoi të ketë ekzistuar në këtë drejtim. Subjekti rezultoi të ketë vepruar mbi pasuritë e fituara për shkak të investimit të babait, si shitës ndaj të tretëve, që do të thotë se ai mund të fitonte drejtpërdrejtë të drejtat e pronësisë mbi këtë pasuri nëse ajo do të kishte rrjedhur nga i njëjti burim. Këto rrethana sugjerojnë se kjo pasuri nuk ka pasur të njëjtin status si pasuritë e tjera të cilat i takonin të fitoheshin prej babait të subjektit si pasojë e investimit të tij në objekt, për pasojë ajo është disponuar nëpërmjet një kontrate shitblerje.

17.9. Në mbështetje të arsytimit të mësipërm shkon edhe analiza e faktit se kjo pasuri figuron vetëm në emër të subjektit, si një prej tre trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij, ndërsa pasuritë e tjera të deklaruara se janë fituar me trashëgim, figurojnë në bashkëpronësi të tre trashëgimtarëve ligjorë, subjektit, nënës dhe motrës së tij. Pretendimi i subjektit se ky veprim është bërë me dakordësinë e dy trashëgimtarëve, nënës dhe motrës mbetet deklarativ, përderisa mënyra e fitimit të pronësisë nuk dikton këtë pëlqim, por edhe të faktit se pasuria vijon të figurojë vetëm në bashkëpronësi të subjektit dhe z. A. Z. Pretendimet e subjektit se këto fakte provohen nga deklaratimet e bëra në deklaratat noteriale<sup>20</sup> të shtetasve I. K., A. Z., si dhe nënës dhe motrës së tij, vlerësohen nga trupi gjykues pa peshë në drejtim të provueshmërisë së fakteve të pretenduara, në referim të qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit<sup>21</sup>, rreth fuqisë provuese të deklaratave noteriale të hartuara përgjatë procesit të rivlerësimit e të pambështetura nga të dhëna të tjera të kohës kur kanë ndodhur faktet që synohen të përdoren.

17.10. Pavarësisht trajtimit të pretendimeve si më lart, të argumentuara kryesisht mbi analizën ligjore të vlerës provuese të provave të administruara, trupi gjykues analizoi edhe rrethanat e faktit mbi të cilat subjekti mbështet pretendimet e tij se objekti i marrë në analizë është përfituar drejtpërdrejtë prej marrëdhënies së investimit që babai i tij ka pasur me pronarin e truallit mbi të cilin është ndërtuar godina ku gjendet ky objekt, nga të cilat u evidentuan një sërë mospërputhjesh e kundërshtish faktike e logjike, të cilat nuk lejojnë besueshmëri për pretendimet e subjektit.

17.11. Subjekti ka pretenduar se Komisioni nuk ka konsideruar të dhënat që japin aktet noteriale lidhur me angazhimin e babait të tij në ndërtimin e një objekti 5-katësh në pronën/truallin e z. I. K. dhe përfitimin e pjesës së tij takuese nga ky angazhim, duke identifikuar si të tillë aktin noterial “Kontratë paraprake sipërmarrje ndërtimi”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2007, në të cilin ndër të tjera ka qenë parashikuar që ndërtimi mbi këtë truall do të kryhej mbi bazën e një leje ndërtimi, e cila do të dilte nga organi kompetent. Subjekti shpjegon se në kushtet kur nuk është bërë e mundur të nxirrej leje ndërtimi, me marrëveshje verbale me njëri-

---

<sup>20</sup> Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2023, e shtetasit I. K.; deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.12.2023, e shtetasit A. Z.; deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2023, e nënës dhe motrës së subjektit të rivlerësimit.

<sup>21</sup> Vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 7/2019; (JR) nr. 34/2019; (JR) nr. 23/2020; (JR) nr. 24/2020; (JR) nr. 33/2020; (JR) nr. 11/2022.

tjetrin, (marrëveshje kjo e arritur në vitin 2007), shtetasit I. K., A. Z. dhe G. H., janë dakordësuar që mbi pronën/truallin e familjes K. të realizonin objektin banesë banimi 5 kate mbi tokë, dhe 1 kat nën tokë, *ku të gjitha fondet, kostot dhe të gjitha shpenzimet për realizimin e ndërtimit do të përballoheshin nga shtetasit G. H. dhe A. Z.*

17.12. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtyre pretendimeve, analizoi të dhënat që ofron praktika e përcjellë në Komision nga ASHK-ja, për legalizimin dhe regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme të objektit 5-katësh në pronë të familjes së z. I. K., duke konstatuar disa fakte si vijon: (i.) më datë 07.11.2007, z. I. K., ka depozituar pranë ALUIZNI-t Tiranë, formularin sipas shtojcës “A” të emërtuar “*Vetëdeklarim për legalizim objekti*” me përshkrimin shtëpi banimi 5 kate me bodrum, të ndërtuar sipas projektit të përgatitur nga z. A. S. dhe me zbatues z. A. Z.; (ii.) në formularin e vetëdeklarimit të z. I. K. pranë ALUIZNI-t, ai ka deklaruar se objekti 5-katësh ka qenë i ndërtuar që në vitin 2006. Pavarësisht këtij deklarimi për vitin e ndërtimit, ka mbetur pa shpjeguar prej subjektit pse një vit më vonë babai i tij me anë të “kontratë paraprake sipërmarrje ndërtimi”, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2007, ka marrë përsipër ndërtimin e këtij objekti duke përfituar si shpërblim 70% të objektit; (iii.) subjekti i rivlerësimit në ankim si dhe në Komision pretendon se pavarësisht faktit se ndërtimi i objektit është realizuar nga babai i tij, z. G. H., dhe z. A. Z., në kushtet kur objekti përfaqësonte një ndërtim informal, për lehtësi procedurash, dokumentacioni i tij është paraqitur për legalizim tek ALUIZNI nën emrin e shtetasit I. K., i cili ishte pronari i truallit, mbi të cilin ishte realizuar ndërtimi, ndërsa referuar legjislacionit në fuqi<sup>22</sup>, kjo situatë ishte lehtësisht e administrueshme duke paraqitur para organit kompetent, natyrën e vërtetë të marrëdhënies dhe aktet që e mbështesnin atë me qëllim, fitimin e të drejtave respektive të secilit prej kontribuuesve në investim në raport me pjesën e tyre; (iv) . sipas kontratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2007, pronari i truallit z. I. K. ka porositur shoqërinë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK<sup>23</sup> me ortakë z. G. H., z. A. Z. dhe z. H. Ç., për përgatitjen e dokumentacionit për miratimin e lejes së ndërtimit për një objekt shumëkatësh në truallin e porositësit, si dhe për ndërtimin e tij me shpenzimet e veta, dhe pas marrjes së lejes së ndërtimit do të hartohet mes palëve një “Aneks Kontratë” për përcaktimin e pjesëve takuese për pronarët, të cilët përfitojnë 30% të sipërfaqes së ndërtimit; (v.) pas përfundimit të procesit të legalizimit mbi bazën e të cilit objekti i ndërtuar u regjistrua në emër të pronarit të truallit z. I. K., si pronari

---

<sup>22</sup> Në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, në nenin 3, “Përkufizime”, përcaktohet se: “g) “Pronar i ndërtimit pa leje” është personi fizik ose juridik, që ka kryer vetë ose ka qenë investitor i ndërtimit pa leje dhe vërteton se e posedon ose e disponon lirisht atë dhe parcelën ndërtimore, pavarësisht nga fakti se pronësia mbi to është e paregjistruar në emër të tij në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP)”.

Në urdhrin e ALUIZNI-t nr. 46, datë 18.07.2006, të emërtuar “Manual i procedurave mbi procesin e vetëdeklarimit”, i cili përcakton rregulla për vetëdeklarimin e objekteve informale me qëllim legalizimin e tyre, ndër të tjera përcaktohet se: [...] “3.6.4 Në rastet kur deklaruesit sipas paragrafit të mësipërm, kanë realizuar marrëveshje noteriale për ndarjen e pjesëve takuese dhe fizike të objektit, si dhe parcelës ndërtimore, sipas përcaktimit të nenit 30 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, në këtë rubrikë shënohen gjeneralitetet e përfaqësuesit dhe aktmarrëveshja i bashkëlidhet formularit të vetëdeklarimit. Në këtë rast për objektin e vetëdeklaruar në formular, shënohet numri i familjeve dhe i banorëve sipas marrëveshjes noteriale. Formulari plotësohet në emër të përfaqësuesit të tyre”.

<sup>23</sup> Shoqëri e miratuar po në vitin 2007 me vendimin e gjykatës nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2007.

i vetëm i tij, me anë të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 05.06.2013, z. I. K., familjarët e tij (bashkëshortja dhe fëmijët) si dhe subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha së bashku me z. A. Z., deklarojnë se në zbatim të kontratës paraprake të sipërmarrjes objekti është ndërtuar nga z. G. H. dhe z. A. Z. dhe se ata do të përfitojnë 70% të sipërfaqes ndërtimore, ndërsa pronarët e truallit do të marrin 30% të sipërfaqes së ndërtimit. Në këtë deklaratë noteriale, deklaruesit e mësipërm deklarojnë se 8 (tetë) pasuri, ndër të cilat edhe pasuria me nr. {\*\*\*} e llojit garazh me sip.108,72 m<sup>2</sup>, janë pasuri të cilat z. G. K. duhet t'i transferojë pronësinë tek përfituesit real të tyre, të cilët kanë pasur marrëdhënie shitblerje me z. G. H. Përmbajtja e këtij dokumenti tregon se pasuria garazh, ishte e destinuar për t'u kaluar në pronësi të personave të tretë, të cilët duket se kishin hyrë në një marrëdhënie paraprake me babain e subjektit të rivlerësimit, ndërsa ai ishte në jetë, për pasojë pritej vetëm kalimi formal të drejtave të fituara, nga trashëgimtari, subjekti i rivlerësimit, përfituesit real të pasurisë; (vi.) pavarësisht parashikimit të mësipërm, rezulton se disa ditë më pas, subjekti së bashku me z. A. Z. në cilësinë e blerësit, më anë të kontratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., në datën 14.06.2013 kanë lidhur kontratë për shitblerje garazhi për pasurinë {\*\*\*}, duke deklaruar se ka paguar shumën 5.400.000 lekë, me lekë në dorë, jashtë kësaj zyre noteriale, fakt që tregon se ata vetë nuk kanë respektuar e kanë zhbërë deklaratimet e tyre në deklaratën noteriale të referuar më sipër, fakt që sugjeron për një ngjarje të ndodhur e cila ka devijuar parashikimet kontraktuale e ka përcaktuar një mënyrë tjetër të disponimit të kësaj pasurie, ndryshe nga të gjitha pasuritë e tjera të përcaktuara në deklaratën noteriale të nënshkruar më 5.06.2013, si dhe në parashikimet kontraktuale të kontratës së sipërmarrjes; (vii.) nga të dhënat që ofrojnë aktet e cituara më sipër, mbetet pa shpjegim, roli dhe përfitimet nga kjo kontratë e ortakut tjetër të shoqërisë z. H. Ç., i cili ka nënshkruar si një nga ortakët në kontratën noteriale paraprake të sipërmarrjes dhe që duhej sipas parashikimeve të saj, të kishte gjithashtu pjesën e tij takuese pas ndërtimit të objektit.

17.13. Për sa referuar më lart, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se informacioni që ofron "kontrata paraprake e sipërmarrjes së ndërtimit", nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2007, dëshmon për angazhimin si investitor/ndërtues të babait të tij në objektin 5-katësh, në truallin e z. I. K., nga i cili do të përfitonte 70% të objektit, duket se nuk provohet tej çdo dyshimi. Mes të dhënave rezulton se ka devijime të rëndësishme nga parashikimet kontraktuale si edhe rrethana që nuk shpjegohen me informacionin që jep subjekti gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Duket se marrëdhënia mes babait të subjektit dhe investitorëve të tjerë, dhe pronarit të truallit, ka qenë komplekse dhe jo çdo ngjarje juridike ka gjetur pasqyrim në aktet e administruara apo edhe gjetskë, duke prodhuar paqartësi e kontradikta mes asaj që aktet pasqyrojnë në disa raste dhe fakteve të tjera që kanë ndodhur jo në përputhje me to. Për rrjedhojë, në këtë situatë minimalisht ambigue, analiza e vetme objektivist por edhe ligjërish e bazuar, mbetet ajo mbi kontratën e shitblerjes me anë të së cilës subjekti ka fituar formalisht të drejtat e bashkëpronësisë mbi pasurinë në kontroll. Në këto kushte trupi gjykues e gjeti përfundimisht të drejtë analizën e Komisionit lidhur me të dhe konsiderimin se subjekti e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet investimit të tij të drejtpërdrejtë, siç pasqyrohet në kontratën e shitblerjes.

17.14. Lidhur me pretendimin e subjektit se analiza financiare për burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë garazh duhet kryer duke konsideruar që kostot e ndërtimit të garazhit aplikohen në një raport prej 40-42% të çmimit referues sipas EKB-së, për sa kohë ky pretendim nuk është ngritur në Komision dhe as në ankim, por është një pretendim i ri i ngritur nga subjekti vetëm me parashtrimet e sjella në Kolegj si një përpjekje për të reduktuar vlerat e analizës financiare të kryer nga Komisioni, por edhe për shkak të faktit se ai nuk qëndron në princip, duke qenë se pasuria është fituar nëpërmjet pagimit të një çmimi sipas kontratës dhe nuk ka vend për analiza të kostos, që zbatohen në rastet e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinare me anë të ndërtimit, trupi gjykues e vlerësoi atë pa relevancë në këtë proces.

17.15. Në përfundim, lidhur me pasurinë e llojit garazh me nr. {\*\*\*}, me sip. 108,72 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Tiranë, të deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting*, si pasuri në bashkëpronësi me pjesë takuese prej 1/2, trupi gjykues arriti në konkluzionin se është i drejtë vlerësimi i Komisionit se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie në vitin 2013, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë një sërë elementësh të analizuar edhe nga Komisioni, por jo vetëm, si: (i.) faktin që subjekti pronësinë mbi këtë pasuri e ka siguruar nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 14.06.2013 në të cilën përcaktohet se çmimi i shitjes është 5.400.000 lekë dhe se *vlera e shitjes është likuiduar jashtë kësaj zyre noteriale në formën “me para në dorë”*; (ii.) faktin që subjekti gëzon të drejtat e pronësisë mbi këtë pasuri jo në bashkëpronësi me nënën dhe motrën e tij, të cilat janë trashëgimtare ligjore të babait të subjektit dhe nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia, u konsiderua në analizën e pretendimeve të subjektit se garazhi në Tiranë është një pasuri e krijuar nga babai i tij, e cila pas vdekjes së babait i ka kaluar subjektit me burim nga të drejtat trashëgimore; (iii.) faktin që subjekti nuk paraqiti asnjë arsye të qenësishme/domethënëse që justifikonte kryerjen e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie vetëm si një mjet për fitimin e pronësisë që nuk përfaqësonte natyrën e vërtetë të transaksionit, në vend të përdorimit të një prej mënyrave të tjera ligjore të mundshme dhe që do të demonstroi vullnetin real të palëve siç subjekti pretendon; iv. përcaktimin e kësaj pasurie në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 05.06.2013, si një pasuri të destinuar për persona të tretë, të cilët kishin shlyer detyrime financiare ndaj babait të subjektit dhe ndaj të cilëve ekzistonte detyrimi i shitësit të kësaj pasurie I. K., për kalimin e pronësisë.

Të gjitha rrethanat e mësipërme në vlerësimin e trupit gjykues konfirmojnë konkluzionin se subjekti i rivlerësimit në pasurinë garazh gëzon të drejta bashkëpronësie jo për shkak të trashëgimisë ligjore, por për shkak të përfshirjes personale të tij në një marrëdhënie shitblerjeje e cila, është pasqyruar nëpërmjet kontratës noteriale të datës 14.06.2013.

18. Në vijim, trupi gjykues, duke konsideruar konkluzionet e mësipërme lidhur me pasurinë garazh në Tiranë, analizoi pretendimet e tjera të subjektit që lidhen me: (i.) financimin e automjetit; (ii.) gjendjen e *cash*-it; si dhe (iii.) analizën financiare në tërësi, për të cilën subjekti ndër të tjera ka pretenduar edhe për gabime në përlllogaritjen e disa zërave të saj.

18.1. Në ankim subjekti pretendon se përfshirja në analizën financiare e vlerës së shpenzimit për pasurinë garazh në Tiranë, në mënyrë të padrejtë ka ndikuar rezultatin e analizës financiare

për blerjen e automjetit në vitin 2007 si dhe për krijimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015. Në reflektim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues e konsideroi të pabazuar pretendimin për mospërfshirjen në analizë të shpenzimit për blerje të garazhit në vitin 2013 me ½ e vlerës së shitjes të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie dhe u ndal në analizimin e kërkimeve të tjera të subjektit lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*} ({\*\*\*}), me të cilat pretendon se konkluzioni i analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me blerjen e tij nuk është i saktë, pasi kjo analizë në mënyrë të gabuar është kryer për periudhën 2005-2015, duke pretenduar se analiza duhet të fillojë në vitin 1995, kur subjekti ka filluar të gjenerojë të ardhura nga punësimi dhe të përfundojë në vitin 2007, në momentin e blerjes së këtij automjeti.

**18.2.** Në vendimin e Komisionit lidhur me analizën financiare në të cilën përfshihet edhe verifikimi i burimeve për blerjen e automjetit, rezulton se ajo është bërë në mënyrë kumulative për vitet para se subjekti të fillojë të ushtrijë funksionet e prokurorit, dhe ka rezultuar me një balancë negative në vlerën prej 500.000 lekë, përveç balancës negative prej 2.700.000 lekë që i përket blerjes së garazhit, e cila afekton sipas Komisionit në mënyrë të pacaktuar në vlerë, dy pasuritë që janë krijuar prej subjektit gjatë kësaj periudhe, automjeti dhe gjendja e *cash-it*.

**18.3.** Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që lidhen me këtë pasuri, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e bëra prej tij lidhur me automjetin e deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe ato të bëra me cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, nga të cilat rezultoi se:

➤ Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Automjet i markës “Mercedes Benz” me targa “{\*\*\*}” blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes<sup>24</sup> nr. {\*\*\*}, datë 22.05.2007, disponuar me certifikate pronësie me numër serie {\*\*\*}, datë lëshimi 25.08.2007. Vlera 220.000 lekë dhe pjesa takuese 100%.*

➤ Në DVP-2015 (para fillimit të detyrës), subjekti ka deklaruar: *Automjet i markës “Mercedes Benz” me targa “{\*\*\*}” i blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} datë 22.05.2007, vlera 220.000 lekë dhe pjesa takuese 100%.*

**18.4.** Komisioni ka konstatuar se mungon deklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie, në deklaratat e përmendura dhe i ka kërkuar subjektit ti deklarojë ato, si dhe të shpjegojë arsyen e mosdeklarimit të tyre në deklaratën *vetting*. Subjekti në lidhje me këtë konstatim, ka shpjeguar se siç ka ndodhur edhe në rastin e pasurisë garazh, mosdeklarimi i burimit për automjetin ka ardhur vetëm për shkak të perceptimit të gabuar për mënyrën e deklarimit. Ndërsa në lidhje me burimet e krijimit të automjetit, subjekti ka shpjeguar se shuma prej 220.000 lekësh e përdorur për blerjen e tij përfaqëson kursime nga puna e tij ndër vite si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për të cilën ka depozituar në

---

<sup>24</sup> Nga dokumentacioni i disponuar në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se subjekti ka lidhur kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.5.2007, me shitësin Th. B., për blerjen e automjetit tip “M-B”, me vit prodhimi 1992, në vlerën 220.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në datën 25.08.2007, subjekti është pajisur me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor.

Komision dhe dokumentacion provues<sup>25</sup> për të ardhurat e përfituara. Subjekti ka pretenduar se ai ka filluar punë që prej datës 01.04.1995, dhe se të ardhurat e përfituara nga puna si dhe kursimet ishin të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën 22.05.2007.

**18.5.** Trupi gjykues, nga analizimi i konkluzioneve të Komisionit si dhe i pretendimeve të subjektit për automjetin “Mercedes Benz”, vlerëson se:

*Së pari*, ashtu si edhe për pasurinë garazh, në kushtet kur subjekti edhe për automjetin, nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratimet periodike vjetore burimet e krijimit të kësaj pasurie, ai gjendet në një situatë e cila e vendos subjektin në kushtet e një deklarimi të pasaktë, i cili nuk përmbush kërkesat e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

*Së dyti*, subjekti në vitin 2003-2004, në deklarin e pasurisë së bërë gjatë ushtrimit të funksionit si Oficer i Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGJ”), nuk rezulton të ketë deklaruar disponim të kursimeve në formë *cash* apo likuiditete në bankë, të cilat do të mund të përdreshin si burime financimi për blerjen e automjetit. Në këto kushte, konstatohet se analiza financiare e kryer nga Komisioni ka si vit nisje janarin e vitit 2005, për shkak se korrespondon me vitin pasardhës pas vitit të fundit të deklarin të bërë nga subjekti si OPGJ, që është deklarimi periodik që i përket vitit 2004. Meqenëse subjekti përgjatë viteve 2005-2015 nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarin e interesave pasurorë, nga ana e Komisionit është vlerësuar që analiza financiare lidhur me këtë periudhë të jetë kumulative, pasi aplikimi i kësaj metodologjie jep mundësinë e përdorimit të çdo kursimi të rezultuar potencialisht në fund të çdo viti, dhe mundëson korrektimin e rezultatit financiar në opsionin me të mirë të mundshëm për subjektin. Në aplikim të kësaj metodologjie, në analizën e kryer nga Komisioni janë përfshirë të gjitha të ardhurat si dhe të gjitha pasuritë e përfituara nga subjekti për periudhën 2005-qershor 2015, dhe nga rezultati i saj është konstatuar një diferencë negative prej (-) 575.572 lekësh që i atashohet blerjes së automjetit dhe pasurisë likuiditet të disponuar prej subjektit (*në cash apo likuiditet gjendje në bankë*), si të vetmet ndryshime pasurish që kanë ndodhur në këtë periudhë.

*Së treti*, trupi gjykues, në funksion të analizimit të plotë të pretendimeve të subjektit, konstatoi se edhe në versionin që analiza financiare, siç pretendon subjekti, do të bëhet duke e shtrirë atë vetëm për periudhën 2005-22.05.2007, që është data e blerjes së automjetit, do të rezultonte që ndonëse subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit, ai do të kishte sërish një balancë negative prej rreth 359.608 lekësh<sup>26</sup>, deri në vitin 2015, e cila do të afektonte krijimin e pasurisë likuiditete të deklaruar nga subjekti si të disponuara në deklaratën para fillimit të detyrës, duke mos ndryshuar rezultatit financiar për të gjithë periudhën sipas konkluzionit të Komisionit. Ky përfundim e bën jo relevante analizën që pretendon subjekti, për sa kohë edhe vetë Komisioni nuk e ka atashuar balancën negative prej 500.000 lekësh, posaçërisht tek automjeti apo likuiditetet, por e ka konsideruar atë si përgjithësuese për të dyja këto pasuri.

---

<sup>25</sup> Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në Komision: vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila konfirmon të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e realizuara nga subjekti si oficer i policisë gjyqësore gjatë periudhës 01.04.1995 – 03.06.2015.

<sup>26</sup> Sipas të dhënave të analizës financiare të kryer në Kolegj, në paragrafin vijues 20.15 të këtij vendimi.

19. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit me të cilin kundërshton si të padrejtë analizën e Komisionit lidhur me gjendjen e *cash-it* të deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në shumën 900.000 lekë, duke e pretenduar se edhe në këtë rast është arritur në konkluzione të gabuara si pasojë e përfshirjes në mënyrë të padrejtë në analizën financiare të shpenzimit për blerjen e garazhit në Tiranë në shumën 2.7 milion lekë.

19.1. Subjekti edhe për këtë pasuri, pretendon kryerjen e një analize financiare duke përfshirë në të, të gjitha të ardhurat e përfituara prej tij dhe bashkëshortes që nga viti 1994 e deri në qershor të vitit 2015<sup>27</sup>, meqenëse burimi i krijimit të gjendjes së *cash-it* prej 900.000 lekësh të deklaruar në deklaratën fillestare të datës 15.06.2015, kanë qenë të ardhurat nga punësimi të siguruara prej tij dhe bashkëshortes.

19.2. Për sa i përket pretendimit më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje të gjitha argumentet e përdorua në kontrollin e analizës financiare të kryer për blerjen e automjetit në vitin 2007, e cila ishte ndërtuar mbi parimin se meqenëse në deklaratat fillestare të pasurisë në vitin 2004 e 2005, subjekti nuk kishte deklaruar gjendje *cash*, atëherë nga kjo periudhë, kjo e dhënë do të konsiderohej me vlerën zero. Gjithashtu, duke qenë se në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2015, subjekti nuk ka deklaruar se gjendja *cash* është krijuar me burim nga të ardhurat e siguruara para vitit 2005, dhe se në deklaratën *vetting* për shumën 1.000.000 lekë të disponuar si kursime në *cash*, subjekti nuk deklaroi burimet e krijimit të saj, me të drejtë Komisioni ka vlerësuar se kursimet e mundshme të pretenduara prej subjektit deri në deklaratën e parë të pasurisë, nuk mund të përdoren si burim për krijimin e likuiditetit. Në këto kushte, trupi gjykues ashtu si edhe Komisioni vlerëson se analiza financiare për periudhën 2005-2015 rezulton me balancë negative prej rreth 3 (tre) milion<sup>28</sup> lekësh, prej të cilës nëse përjashtohet vlera e blerjes së garazhit me shumën 2.7 milion lekë, për diferencën subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar kursimet në *cash* të deklaruara në deklaratën *vetting*.

20. Krahas shkaqeve të analizuara më sipër, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim e të detajuara më në hollësi në parashtrimet para seancës, lidhur me korrigjimin/saktësimin e elementëve të caktuar të analizës financiare të Komisionit, sipas të cilave janë të pasakta vlerat e përfshira në këtë analizë që kanë të bëjnë me: i. shpenzimet e udhëtimit; ii. të ardhurat nga paga të subjektit; iii. të ardhurat e bashkëshortes nga shpërblimi i lindjes; iv. shpenzimet e jetesës; v. shpenzimet e mobilimit; vi. shpenzimet e shkollimit, si dhe vii. gjendja e likuiditeteve në bankë në datën 01.01.2015.

---

<sup>27</sup> Në mbështetje të këtij pretendimit të cilin subjekti e ka ngritur edhe në Komision, nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ rezulton se ka paraqitur aktet: i. shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2016, e lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në të cilën konfirmohen shuma totale e të ardhurave prej 10.343.356 lekësh (gjatë periudhës 1995-2015, subjekti ka përfituar pagën në shumën totale prej 10.343.356 lekësh si dhe dieta në shumën 334.200 lekë. Shuma totale e konfirmuar nga shkresa e disponuar në fashikull është në shumën 10.677.556 lekë); ii. shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.10.2016, e lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila informon mbi nivelin e të ardhurave të siguruara përgjatë periudhës kohore 16.01.2001-15.10.2001 në shumën e totale prej 297.293 lekësh; iii. shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.10.2016, e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor, e cila informon mbi nivelin e të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortes si infermiere përgjatë periudhës kohore 1994-2015, në shumën e totale prej 4.450.320 lekësh.

<sup>28</sup> Referoju rezultatit të analizës financiare në fund të trajtimit të shkaqeve që kanë lidhje me vlerësimin e pasurisë.

**20.1.** Lidhur me shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2005-2016, subjekti ka pretenduar se ato ishin kryesisht udhëtime disaorëshe në drejtim të Maqedonisë së Veriut, në të cilat nuk ka udhëtuar me automjetin e tij dhe nuk ka pasur kosto për mbulimin e shpenzimeve për karburant, dhe siguracion automjeti. Për pasojë, shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni për karburant dhe siguracion në masën 1.500 lekë/ditë, me vlerë totale prej 208.500 lekësh, duhet të zbriten nga shpenzimet e udhëtimit, pasi ato nuk përfaqësojnë kosto të mbuluara prej subjektit dhe mbi këtë bazë duhet të kryhen përlllogaritjet e shpenzimeve të udhëtimeve<sup>29</sup> nga Kolegji për periudhën e analizuar.

**20.2.** Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve, konstatohet se subjekti në rastet kur nuk ka udhëtuar me automjetin e tij është ngarkuar me shpenzime në masën 1.500 lekë për kategorinë e shpenzimeve si karburant, karton jeshil dhe në masën 2.000 lekë/ditë për kategorinë e shpenzimeve të qëndrimit. Nga kjo përlllogaritje e kryer nga Komisioni, për të cilën subjekti është bërë me dije nga rezultatet e hetimit administrativ, shpenzimet e përlllogaritura për periudhën 2005-qershor 2015 kanë qenë në masën 630.680 lekë. Pavarësisht se në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti nuk ka pretenduar ndryshimin apo përlllogaritje të ndryshme të këtyre shpenzimeve, në funksion të shqyrtimit të plotë të pretendimeve të tij, dhe aplikimin e njëjtë të standardeve mbi të cilët kontrollohet analiza financiare e subjekteve, trupi gjykues aplikoi për kontrollin e tyre metodologjinë e përdorur nga Kolegji<sup>30</sup> në jurisprudencën e tij. Në këto kushte, nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit duke aplikuar këtë metodologji është bërë një përlllogaritje, në të cilën janë konsideruar të dhënat si vijon: (i.) në rastet kur nga subjekti është deklaruar që udhëtimet janë kryer me automjete të personave të tjerë (miqve apo të njohurve) dhe vetë ka qenë pasagjer, analiza e tij financiare nuk është ngarkuar me kosto për karburant apo për siguracion mjete, por vetëm për kosto qëndrimi; (ii.) në rastet kur subjekti ka udhëtuar i shoqëruar nga bashkëshortja dhe fëmijët, udhëtime për të cilat ka deklaruar se ka përdorur vetë automjete të miqve apo shokëve, subjekti është ngarkuar vetëm me shpenzime për karburant duke përjashtuar shpenzimet e siguracionit të mbuluara nga poseduesit e mjeteve; (iii.) për udhëtimet brenda ditës, kosto e qëndrimit për subjektin dhe familjarët është përlllogaritur në gjysmën e masës së përcaktuar në metodologjinë e Kolegjit të dhënë në vendimin (JR) 11/2019; (iv.) për përlllogaritjen e shpenzimeve për fëmijë, është aplikuar fasha moshore e cila në rastin konkret përfshinte moshën nga 5-18 vjeç me një vlerë ditore prej 25 eurosh.

**20.3.** Nga kontrolli i analizës financiare mbështetur në korrektimet e mësipërme rezultoi se kosto e shpenzimeve të udhëtimit, është në shumën 618.264 lekë, e cila u përfshi si e tillë në analizën financiare, përkundrejt shumës së përcaktuar nga Komisioni, në vlerën prej 630.688 lekësh. Lidhur me pretendimet e ndryshme/të reja, të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit në parashtrime, (të reja në raport me ato të paraqitura në Komision dhe në ankim), duke synuar reduktimin e tyre në vlera akoma më të ulëta dhe zvogëlimin në këtë mënyrë edhe të balancës

---

<sup>29</sup> Kosto e shpenzimet e udhëtimit të pretenduara nga subjekti që duhet të reduktohen nga analiza financiare: viti 2005 në shumën 4.500 lekë; viti 2006 në shumën 18.000 lekë; viti 2007 në shumën 18.000 lekë; viti 2008 në shumën 34.500 lekë; viti 2009 në shumën 28.500 lekë; viti 2010 në shumën 15.000 lekë; viti 2011 në shumën 21.000 lekë; viti 2012 në shumën 18.000 lekë; viti 2013 në shumën 16.500 lekë; viti 2014 në shumën 18.000 lekë; viti 2015 në shumën 16.500 lekë. Shuma totale 208.500 lekë.

<sup>30</sup> Metodologji e shpjeguar në vendimin e Kolegjit 11/2019(JR).

negative, trupi gjykues vlerësoi të mos i konsiderojë ato më tej në analizë, duke pasur në konsideratë kufizimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 për paraqitjen e fakteve të reja në ankim e aq më tepër në parashtrime.

**20.4.** Trupi gjykues, korrektoi pasi e gjeti të pasaktë objektivisht zërin “*të ardhura nga punësimi*”, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pranuar pretendimin e subjektit se vlera e këtij zëri duhet të ishte në masën 7.395.908 lekë dhe jo 7.384.873 lekë, të përcaktuar prej Komisionit. Ky gabim në përlllogaritje konstatohet prej Njesisë së Shërbimit Ligjor se ka ardhur për shkak se të ardhurat e subjektit për periudhën janar-qershor 2015 janë përlllogaritur me metodën e të ardhurës mesatare, e cila ka sjellë në analizën financiare një efekt negativ në masën 11.035 lekë. Në kushtet kur ka të dhëna shkresore që evidentojnë të ardhurën e saktë të siguruar për këtë periudhë prej subjektit, trupi gjykues, korrektoi këtë vlerë në analizën financiare duke përfshirë si të saktë shumën e pretenduar prej subjektit.

**20.5.** Trupi gjykues konstatoi se me parashtrimet e paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar vetëm korrigjim/saktësim të vlerave të analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me pagat, por në disa raste ai ngre edhe pretendime të reja të cilat nuk i ka paraqitur as në Komision por as në ankim, me anë të të cilave ndryshon tërësisht qëndrimin dhe pretendimet e mëparshme, ndryshime të cilat bëhen me fokus/në funksion të përmirësimit të rezultatit të analizës financiare. Në këtë linjë evidentohet se me parashtrimet e sjella në Kolegj, subjekti ka pretenduar se përveç të ardhurave neto nga paga, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, ka siguruar edhe pagesa të tjera në formën e dietave<sup>31</sup>, të cilat, përgjatë periudhës kohore 01.01.2005 – 03.06.2015, rezultojnë të jenë të kredituara në llogarinë e tij të pagës pranë Raiffeisen Bank në shumën 191.000 lekë. Sipas parashtrimeve të subjektit, nga llogaria e pagës pranë Raiffesen Bank janë debituar (tërhequr) vazhdimisht vlerat e dietave që përfaqësojnë “flukse hyrëse të likuiditeteve në gjendjen *cash* në banesë”, duke pretenduar se fondet në formën *cash* të rrjedhura nga këto debitime (tërheqjet nga llogaria) që subjekti i ka bërë në mënyrë të vazhdueshme prej llogarisë së tij bankare, kanë sjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë “rritje të përfitimeve ekonomike” të likuiditeteve në formën gjendje *cash* në banesë. Nëpërmjet këtij pretendimi, subjekti synon të provojë faktin se gjendja e *cash*-it të disponuar prej tij në banesë, është krijuar pjesërisht nga tërheqjet e dietave të kredituara në llogarinë bankare<sup>32</sup>.

**20.6.** Trupi gjykues, edhe në këtë rast, përveçse risjell në vëmendje qëndrimin për faktet e reja të paraqitura për herë të parë në parashtrime e të analizuara më sipër, i cili nuk lejon marrjen në konsideratë të këtyre pretendimeve që nuk i janë nënshtruar as shqyrtimit të Komisionit dhe as janë ngritur në ankim, vlerëson të potencojë qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit rreth efektit financiar të fondeve financiare që vijnë nga dietat, i cili edhe në abstragim të qëndrimit të mësipërm të imponuar nga neni 47 i ligji nr.49/2012, nuk lejon konsiderimin e tyre në analizën

---

<sup>31</sup> Vlera e të cilave, ashtu si edhe paga e subjektit gjenden të përcaktuara në shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

<sup>32</sup> Në mbështetje të këtij pretendimi të ri, subjekti me parashtrimet ka paraqitur si provë të re, shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.03.2025, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në të cilën janë paraqitur shumat e paguara nga institucioni si shpenzime (dieta + hotel + transport) në shumën 191.000 lekë të kategorizuara, duke ndarë veçmas vlerën e dietave prej 166.500 lekë.

financiare si të ardhura të ligjshme pasi ato, dietat, duhet të jenë pjesë e saj si një e ardhur dhe njëkohësisht dhe si shpenzim i subjektit në funksion të ushtrimit të detyrës, përfshirje e cila në terma financiarë në analizën e ekonomisë familjare të subjektit do të kishte realisht efektin “zero” përfitim. Thënë ndryshe, nëse një veprim i tillë do të ishte reflektuar në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, përsëri rezultati financiar për periudhën e analizuar nuk do të ndryshonte. Ky qëndrim vjen edhe për shkak të faktit se në praktikën e institucioneve shtetërore dhe jo vetëm, pagesat në formën e *dietave* jepen pasi provohet kryerja e shpenzimit lidhur me to. Në paralelizëm të arsytimit të bërë nga subjekti në prapësime, nëse dietat e kredituara në llogarinë bankare të pagës së subjektit do të konsideroheshin si të ardhura, si rrjedhim dhe debitimi i tyre duhet të kishte destinacionin e përcaktuar, i cili përkon me veprimin kontabël/financiar të institucionit, që është rimbursimi i shpenzimeve të kryera më herët. Në të tilla kushte ekuacioni kontabël merr kuptim, pasi fonde të dedikuara (sipas ligjit), që kreditohen si zë në llogarinë e “*dietave*” duhet të kontabilizohen si debitim apo shpenzim në llogarinë e shpenzimeve ditore, të destinuara në funksion të ushtrimit të detyrës, për aktivitete larg vendit të banimit dhe jo për krijimin e likuiditeteve apo gjendjeve *cash* në banesë.

**20.7.** Mbi bazën e të gjitha argumenteve të mësipërme, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit lidhur me dietat, përveçse është një pretendim i ri, i papranueshëm në kuptim të përcaktimeve të nenit 47 të ligjit 49/2012, nuk qëndron as në thelbin e tij, në këndvështrim të jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit<sup>33</sup>.

**20.8.** Trupi gjykues në kuadër të korrektimit të analizës financiare për fakte që objektivisht provohen të jenë ndryshe nga analiza e Komisionit dhe të ngritura si pretendime prej subjektit, pasi verifikoi pasaktësitë e pretenduara lidhur me “*shpërblimin për lindje*” të përfituar nga bashkëshortja e tij, e gjeti atë të drejtë dhe pasqyrojti të ardhura shtesë në analizën financiare të vitit 2006, vlerën prej 6.257 lekë, e cila i korrespondon këtij shpërblimi sipas akteve në dosje.

**20.9.** Trupi gjykues, verifikoi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor edhe pretendimet e subjektit për pasaktësi e vlerësim të gabuar të zërit shpenzime jetese për periudhën 2005-qershor 2015, të cilat sipas subjektit duhet të korrektohen duke i reduktuar ato në shumën 27.823 lekë. Trupi gjykues i vlerësoi këto pretendime pavarësisht paraqitjes së tyre në fazën e parashtrimeve, por me synimin e një qëndrimi garantist e zbatimin e standardeve të përdorura për të gjithë subjektet për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës.

**20.10.** Në këtë kontekst, Njësia e Shërbimit Ligjor pasi verifikoi zërin e shpenzimeve të jetesës në analizën financiare të Komisionit, identifikoi se ka pasaktësi: (i) në vitin 2006 kur familja e subjektit është shtuar me fëmijën e dytë, për të cilin janë përllogaritur disa ditë më shumë shpenzime jetese, si dhe (ii) me mospërllogaritjen nga Komisioni të shpenzimeve për 3 ditët e muajit qershor 2015, në funksion të asaj që do të konsiderohet si data e fillimit të detyrës, duke konsideruar si të tillë datën e emërimit në detyrë apo nisjen e efekteve financiare lidhur me këtë emërim. Nisur nga këto të dhëna, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim i subjektit është i

---

<sup>33</sup> *Shih vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 1/2020; (JR) nr. 21/2020; (JR) nr. 24/2020; (JR) nr. 27/2021.*

drejtë dhe për pasojë analiza financiare e Komisionit lidhur me shpenzimet e jetesës për periudhën 2005 - qershor 2015, u reduktua në shumën 27.823 lekë.

**20.11.** Referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit për reduktim të shpenzimeve të jetesës të vitit 2007, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij se përcaktimi i vlerave për shpenzimet e jetesës është bërë duke u referuar në standardin ligjor të pranuar se përfaqësojnë të dhënat e ofruara nga ILDKPKI, i cili ka përcjellë<sup>34</sup> në institucionet e rivlerësimit vlerat zyrtare të publikuara nga INSTAT-i, sipas rezultateve të anketës së buxhetit të familjeve në Shqipëri. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit së këto vlera, për vitin 2007, duhen konsideruar më të ulëta, është i pabazuar dhe, si rrjedhim, shpenzimet e jetesës për këtë vit nuk mund të ndryshojnë.

**20.12.** Në parashtrimet e paraqitura në Kolegj konstatohet se subjekti ndër të tjera, ka kërkuar saktësimin e analizës financiare të Komisionit edhe për sa i përket *shpenzimeve të mobilimit*, duke pretenduar se referuar deklarimeve të tij gjatë hetimit administrativ nuk mund të ketë shpenzime për mobilim mbi vlerën 585.764 lekë.

**20.13.** Në funksion të verifikimit të këtij zëri të analizës financiare, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se në analizën e Komisionit, për vitet 2014 dhe 2015, shpenzimet e mobilimit, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e shkollimit janë miksuar me njëra-tjetrën, duke u pozicionuar në qeliza të gabuara dhe, si rrjedhim, kanë prodhuar shumatore të gabuara. Njësia e Shërbimit Ligjor saktësoi vlerat dhe llojin e shpenzimit, duke korrigjuar specifikisht shpenzimet e mobilimit të vitit 2014 në shumën 114.000 lekë dhe vlerën totale të të gjithë periudhës në shumën 545.764 lekë. Nisur nga këto konstatime, trupi gjykues e konsideroi të drejtë korrigjimin e analizës së Komisionit, tek e cila u kryen saktësimet duke ngarkuar për vitin 2014 *shpenzimet e mobilimit* në vlerën 114.000 lekë dhe duke zbritur në vitin 2015 *shpenzimet për shkollim* në shumën 114.000 lekë.

**20.14.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet, ka ngritur një pretendim të ri, duke kërkuar korrigjimin e gjendjes së likuiditeteve në bankë më datë 03.06.2015. Lidhur me këtë pretendim, u konstatua se prej Komisionit, likuiditetet e përfshira në analizën financiare në shumën 2.043.702 lekë, i përkasin gjendjes së datës 01.06.2015, ndërsa shuma prej 2.113.674 lekësh, e pretenduar nga subjekti me parashtrimet, i korrespondon vlerës së likuiditeteve më datë 03.01.2015. Pavarësisht konstatimit se ky pretendim paraqitet rishtas në parashtrime, trupi gjykues, në funksion të qëllimit të pasjes së një analize financiare sa më afër fakteve të provuara objektivisht, vlerësoi situatën nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, e cila në kushtet kur subjekti: (i.) në deklaratën fillestare të para fillimit të detyrës, ka deklaruar se ka filluar ushtrimin e detyrës më datë 01.06.2015; (ii.) dhe në deklaratën *vetting* ka konfirmuar se ka filluar ushtrimin e detyrës si prokuror më datë 01.06.2015, verifikoi likuiditetet në bankë pikërisht më datë 01.06.2015. Nga verifikimi i të dhënave të analizës së Komisionit për likuiditetet e datës 01.06.2015, nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj u konstatuan pasaktësi të cilat pasi u korrigjuan, ndryshuan vlerën e likuiditeteve, duke përfshirë si të tillë në analizë vlerën 2.108.018 lekë.

---

<sup>34</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2019.

20.15. Trupi gjykues, pas reflektimit të konkluzioneve të mësipërme lidhur me shkaqet e ankimit që i referohen analizës financiare si dhe të pretendimeve për korrektimin/saktësimin e vlerave të saj, arriti në konkluzionin se për periudhën 01.01.2005 - 01.06.2015, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve<sup>35</sup> të ligjshme në shumën 3.059.608 lekë, për të përballuar krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, mangësi e cila afektoi në shumën 2.700.000 lekë krijimin e pasurisë “garazh” në Tiranë, dhe diferenca prej 359.608 lekësh afektoi pasurinë “likuiditet”.

#### ***D. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale***

21. Trupi gjykues, në vijim, mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshtoi si të pabazuar ligjërisht dhe në shkelje të standardeve të vendosura nga organet e rivlerësimit, konkluzionet e Komisionit lidhur me kriterin e aftësive profesionale. Në parantezë, sillet në vëmendje qëndrimi i trupit gjykues i mbajtur për pretendimet e subjektit lidhur me këtë kriter, që adresoheshin brenda shkaqeve me natyrë procedurale, të cilat janë analizuar në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi e janë gjetur të pabazuara. Në këto kushte, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit që u adresohen vlerësimeve të Komisionit lidhur me: (i) “të dhënat nga burimet arkivore” për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2021 dhe procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019; (ii) problematikat e emërtuara si “gjetje të tjera të kriterit profesional” për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2017; (iii) problematikat e konstatuara në 10 (dhjetë) denoncime nga publiku, për të cilat konstaton e vlerëson sa vijon.

21.1 *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2021, i cili lidhet me katër ankime të përsëritura e të depozituara në ILD nga znj. A. L., trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

21.1.1. Denoncuesja A. L., në katër ankime të drejtuara Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në vitet 2021-2022, ka pretenduar se ish-bashkëshorti i vajzës së saj ka ushtruar dhunë/abuzim fizik ndaj saj në dyqanin ku ajo punon. Ajo ka depozituar kallëzim penal për këtë fakt dhe për hetimin e tij, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 4.2.2021, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”. Denoncuesja pretendon se subjekti/prokurori Ilir Hoxha nuk ka kryer veprime hetimore, pasi nuk e ka marrë në pyetje si viktimë, si dhe nuk ka pranuar aktin e ekspertimit mjekoligjor, ku provohej se denoncuesja ka mbetur e dëmtuar për shkak të dhunës së ushtruar nga ish-bashkëshorti i vajzës së saj. Sipas denoncueses, eksperti mjekoligjor i

---

<sup>35</sup> Analiza financiare e kryer në Kolegj pas konsiderimit të të gjitha shkaqeve të trajtuara nga Kolegji për periudhën 01.01.2005- 01.06.2015, rezultoi me të dhënat si vijojnë:

- Zëri “pasuri” në shumën 3.820.000 lekë [në të cilën përfshihet a) automjeti i blerë në vitin 2007 prej 220.000 lekësh, b) Garazhi në shumën 2.700.000 lekë si dhe c) gjendja e cashit sipas deklarimeve të subjektit në shumën 900.000 lekë];
- Zëri “të ardhura” në shumën 11.219.983 lekë [në të cilën janë përfshirë a) të ardhura nga paga e subjektit në shumën 7.395.908 lekë; b) të ardhura nga paga e bashkëshortes në shumën 3.117.818 lekë; c) të ardhura nga shpërbllim lindja në shumën 6.257 lekë si dhe d) kredia e marrë nga “Raiffeisen Bank” në shumën 700.000 lekë];
- Zëri “shpenzime” në shumën totale 9.251.572 lekë [në të cilën janë përfshirë a) shpenzime jetese në shumën 6.199.401 lekë, b) shpenzime udhëtimi në shumën 618.264 lekë; c) shpenzime mobilimi në shumën 545.764 lekë d) shpenzime shkollimi në shumën zero lekë; e) huadhënie shtetasit A. H. në shumën 980.770 lekë, f) shpenzime për pagesë këst kredie në shumën 907.374 lekë];
- Mungesa e burimeve të ligjshme në shumën (-) 3.059.608 lekë.

caktuar nga organi i akuzës<sup>36</sup>, ka qenë në konflikt interesi me të pandehurin. Ajo ka bërë ankim kundër vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin datë 12.5.2021, lënë në fuqi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2021, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e ka kthyer çështjen në Prokurori për hetime shtesë. Komisioni, në “Raportin e hetimit administrativ”, i ka kërkuar shpjegime subjektit për ankesat e shtetases A. L., lidhur me çdo hap procedural të ndërmarrë prej tij për hetimin e çështjes, mbështetur në dokumentacion provues. Subjekti, në shpjegimet e dhëna për këtë çështje, ka shpjeguar arsyen e mospranimin të aktit të ekspertimit të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, duke e konsideruar të drejtë shpjegimin tij, të mbështetur në përcaktimet e nenit 182 të Kodit të Procedurës Penale, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues, me arsyetimin se çështja hetohet tashmë nga një prokuror tjetër dhe se nuk disponon aktet e fashikullit penal.

**21.1.2.** Komisioni, pasi është njohur me shpjegimet e subjektit, ndërsa ka konstatuar se: *prej tij nuk është depozituar dokumentacion provues, me argumentin se kjo çështje ndodhet ende nën hetim. Fakti që kjo çështje aktualisht është nën hetim nga një prokuror tjetër, nuk e bën atë një çështje në shqyrtim sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë është ezauruar roli dhe puna e subjektit të rivlerësimit dhe gjykatat janë shprehur lidhur me vendimmarrjen e subjektit dhe veprimet hetimore të ndërmarra prej tij – ka pranuar shpjegimin e bërë prej subjektit për çështjen që lidhet me pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit të ekspertit E. S. Pavarësisht këtij qëndrimi, Komisioni, duke iu referuar pretendimeve të ngritura në denoncimet e kësaj shtetaseje e të bëra prezente nëpërmjet referimit në rezultatet e hetimit, ka konkluduar në përfundim lidhur me këtë çështje se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës në lidhje me këtë procedim penal, duke shfaqur mangësi profesionale në hetimin e kësaj çështjeje, sipas kërkesës në pikën 2 të nenit 73 të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

**21.1.3.** Subjekti i rivlerësimit, në ankim, lidhur me këtë procedim, ka pretenduar se ai nuk duhet të jetë objekt shqyrtimi pasi: **(i)** është përtej periudhës së rivlerësimit; **(ii)** është një çështje që gjendet ende në fazën e hetimit paraprak pasi, me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë dhe asaj të Apelit Gjirokastër, vendimi i subjektit “Për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2021”, datë 31.01.2023, është prishur dhe çështja i është kthyer organit të prokurorisë Sarandë<sup>37</sup> për hetime të mëtejshme; **(iii)** dhe se pas këtij momenti, denoncuesja A. L. ka bërë

---

<sup>36</sup> Nëpërmjet aktit procedural “Vendim për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit mjekoligjor”, të datës 27.01.2021, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është urdhëruar kryerja e ekspertimit mjekoligjor të dëmtimeve të evidentuara te shtetasja A. L., ku me detyrën e ekspertit është caktuar eksperti mjekoligjor, z. A. T. E dëmtuara A. L. nuk është paraqitur pranë ekspertit A. T. për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor dhe nuk ka paraqitur arsye e as ka lajmëruar për mungesën e saj. Më tej, e dëmtuara është drejtuar për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor tek eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S., i cili në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2021, ka konkluduar se dëmtimet e A. L. [...] hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat kanë sjellë për pasojë humbjen e përkohshme të aftësisë për punë, në masën mbi 9 (nëntë) ditë.

<sup>37</sup> Në shpjegimet e dhëna në Komision më datë 10.01.2024, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Duke ju rikonfirmuar të dhënat e mëparshme, ju bëj me dije se nëpërmjet e-mail-it të datave 05.01.2024 dhe 10.01.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë më konfirmon faktin se procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2021 (A. L. – ankuese) është çështje që gjendet ende në fazën e hetimit paraprak.

kallëzim kundër subjektit (protokolluar me nr. {\*\*\*}, datë 16.03.2022), i cili për këtë shkak ka dhënë dorëheqjen nga hetimi i çështjes (më datë 24.03.2022), me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, dhe se për këtë arsye subjekti pretendon se nuk ka informacion mbi vijimin e hetimeve për këtë procedim.

**21.1.4.** Pavarësisht pretendimeve me karakter procedural, subjekti duke kërkuar administrimin e fashikullit të procedimit penal {\*\*\*}/2021, i cili nuk është administruar gjatë hetimit administrativ, kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka shfaqur mangësi në hetimin e procedimit penal {\*\*\*}/2021<sup>38</sup>, duke shpjeguar rrethanat e faktit dhe pretenduar se:

**i.** Në kuadër të dokumentimit të rrethanave të kallëzuara nga shtetasja A. L., më datë 27.01.2021, është kryer veprimi hetimor i këqyrjes së jashtme të kësaj shtetaseje, prej nga janë konstatuar lëndime të ndryshme trupore [...] dhe se nëpërmjet aktit procedural “Vendim për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit mjekoligjor” të datës 27.01.2021, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, është urdhëruar kryerja e ekspertimit mjekoligjor të dëmtimeve të evidentuara te shtetasja A. L., dhe me detyrën e ekspertit është caktuar eksperti mjekoligjor, z. A. T. Subjekti shpjegon se vendimi për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor i datës 27.01.2021, i është komunikuar, duke i dhënë kopje të tij, të dëmtuarës A. L.

**ii.** Shtetasja A. L., edhe pse është njoftuar për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor, nuk është paraqitur para ekspertit mjekoligjor, z. A. T., rrethanë e cila ka gjetur pasqyrim në shkresën nr. {\*\*\*}, datë 05.03.2021, që eksperti T. i ka nisur organit procedues, me të cilën e informon se pasi ka komunikuar në telefon me të dëmtuarën A. L., ajo ka refuzuar të paraqitet te mjeku për kryerjen e ekspertimit, duke u shprehur se *nuk dëshironte më ta kryente ekspertimin mjekoligjor.*

**iii.** Ndërkohë, teksa materiali kallëzues i regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2021, gjendej në fazën e verifikimit paraprak, pra ende pa u regjistruar procedimi penal, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2021, Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë ka vënë në dispozicion të organit procedues, aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2021, kryer nga eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S.

**iv.** Bazuar në konkluzionet e aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2021, i kryer nga eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S., pavarësisht parashtrimeve nga ana e kallëzueses A. L. mbi ekzistencën në rastin e kallëzuar prej saj, të figurës së veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i Kodit Penal, prokurori (subjekti i rivlerësimit), më datë 04.02.2021, ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2021, për kundërvajtjen penale “Plagosja e lehtë me dashje”, kryer në dëm të shtetases A. L., parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

---

<sup>38</sup> Denoncuesja A. L. ka denoncuar në polici ish-bashkëshortin e vajzës E. Dh. për ushtrim dhune në ambientet e dyqanit të denoncueses. Mbi bazën e këtij denoncimi, nga oficeri i policisë gjyqësore të Komisarariatit, në Policinë e Shtetit Sarandë, është hartuar materiali kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2021, mbi bazën e të cilit më pas, më datë 04.02.2021, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2021, për kundërvajtjen penale “Plagosja e lehtë me dashje”, kryer në dëm të shtetases A. L., parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, e cila nuk i është atribuar ndonjë shtetasi konkret.

v. Subjekti ka shpjeguar në Komision se, në kushtet e regjistrimit të procedimit penal, ndodhur në situatën procedurale të shkaktuar nga kryerja e ekspertimit mjekoligjor nga eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S., me qëllim verifikimin nëse ky ekspert, për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të dëmtimeve të evidentuara te shtetasja A. L., është caktuar me detyrën e ekspertit mjekoligjor nëpërmjet ndonjë akti procedural të panjohur nga ana e prokurorit të çështjes, apo të paadministruar në aktet e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2021, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2021, Komisarariatit të Policisë Sarandë iu kërkua informacioni përkatës. Ky institucion, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 18.02.2021, informon:

- *Nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore J. P., është pajisur shtetasja A. L. me vendim mjekoligjor të caktuar z. A. T., pranë spitalit “Petro Nako”.*
- *Nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore J. P., nuk është urdhëruar për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të shtetasës A. L. pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S.*
- *Nga ana e Komisarariatit të Policisë Sarandë, nuk na rezulton se ndonjë nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të ketë lëshuar vendim mjekoligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, ku shtetasja A. L. të bënte ekzaminimin përkatës.*

Subjekti ka referuar në Komision se, ndërkohë, Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 23.02.2021, njofton Prokurorinë Sarandë se: “Akti i ekspertimit nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2021, është kryer në bazë të vendimit të datës 21.01.2021, lëshuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore J. P.”.

**vi.** Për sa më sipër, konstatohet se, nëpërmjet aktit procedural “Vendim për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit mjekoligjor”, të datës 27.01.2021, Oficeri i Policisë Gjyqësore J. P. ka caktuar me detyrën e ekspertit mjekoligjor z. A. T., dhe jo ekspertin mjekoligjor të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S., në referim të nenit 179 të Kodit të Procedurës Penale, rrethanë kjo që nuk e legjitimon këtë të fundit në detyrën e ekspertit për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të shtetasës A. L. Po ashtu, rezulton se në kuptim të përcaktimeve të nenit 181 të Kodit të Procedurës Penale, e dëmtuara A. L., kur është njoftuar për kryerjen e ekspertimit nga mjeku ligjor, nuk e ka kundërshtuar kryerjen e ekzaminimeve pranë ekspertit A. T. dhe as ka ngritur pretendime për konflikt interesi.

**vii.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit parashtron se duke vlerësuar se veprimet e kryera nga ana e ekspertit mjekoligjor të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S., në drejtim të kryerjes së një ekspertimi mjekoligjor për llogari të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, pa qenë i ngarkuar me detyrën e ekspertit mjekoligjor nëpërmjet ndonjë akti procedural, më datë 31.03.2021, ka urdhëruar regjistrimin e një procedimi penal të veçantë, pikërisht atij me nr. {\*\*\*} të vitit 2021, që bën fjalë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**viii.** Pas këtij momenti, ndodhur në këtë situatë procedurale, bazuar në rrethanat e evidentuara nga eksperti mjekoligjor, z. A. T., i cili në shkresën e protokolluar me nr. {\*\*\*}, datë

05.03.2021<sup>39</sup>, evidenton nevojën për pasjen e të dhënave që provojnë dëmtimet, subjekti i rivlerësimit (prokurori), nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 09.03.2021, i ka kërkuar ekspertit mjekoligjor, z. A. T., që kryerja e ekspertimit të urdhëruar nëpërmjet vendimit përkatës të datës 27.01.2021, të kryhet bazuar në “materiale të çështjes”, të cilat i janë vënë ekspertit në dispozicion. Në ankim, subjekti thekson se nuk ka qenë për faj të organit të akuzës moskryerja e ekzaminimit fizik të shtetasës A. L., dhe nuk ka qenë as rrjedhojë e veprimeve të organit të akuzës që nga data e dëmtimit të A. L., më 27.01.2021, e deri më datë 05.03.2021 kur eksperti kërkoj prova për dëmtimet e saj, ka kaluar një kohë e konsiderueshme, e cila ka ndikuar në humbjen e gjurmëve të dëmtimeve fizike të kësaj shtetaseje/kallëzueseje.

**ix.** Eksperti mjekoligjor, z. A. T., ka përmbushur detyrën e ngarkuar dhe tek akti i ekspertimit mjekoligjor të datës 12.03.2021, protokolluar pranë organit procedues me nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2021, ka konkluduar se: *dëmtimet e konstatuara te shtetasja A. L. hyjnë në kategorinë e rrahjeve.*

**x.** Subjekti ka shpjeguar në Komision dhe në ankim se, referuar konkluzioneve të aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 12.03.2021, rezulton se dëmtimet e konstatuara te shtetasja e dëmtuar A. L. hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të parashikuara nga neni 90/2 i Kodit Penal, “Dëmtime të tjera me dashje”, dispozita e të cilit parashikon: *Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune [...] kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.*

**21.1.5.** Mbështetur në faktet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se në rastin konkret, fakti penal i ndodhur përmban elementet e figurës së kundërvajtjes penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, dhe se në referim të nenit 59, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale<sup>40</sup>, “viktima akuzuese”, për shkak të pasojës mjekoligjore të ardhur, e dëmtuara nga kjo kundërvajtje penale, duhet t’i drejtohet gjykatës për të bërë të mundur vërtetimin e akuzës për kundërvajtjen penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal. Bazuar në këtë analizë, në referim të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, paragrafi 1, germa “d” e Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar që procedimi penal në fjalë, për kundërvajtjen penale “Dëmtime të tjera me dashje”, kryer në dëm të shtetasës A. L., parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, të pushohet, duke marrë vendimin përkatës të datës 31.03.2021.

**21.1.6.** Pas marrjes së vendimit të mësipërm, e dëmtuara A. L. ka depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ankim kundër tij, duke parashtruar: **(i)** kundërshti në lidhje me kualifikimin e veprës penale për të cilën është regjistruar fillimisht procedimi penal, duke kërkuar që ky procedim penal të regjistrohej për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i Kodit Penal; **(ii)** si dhe kundërshti në lidhje me pavlefshmërinë e shpallur

---

<sup>39</sup> Në këtë shkresë, shprehet se: “Për vënien në dispozicionin tuaj të aktit të ekspertimit do të ishte i nevojshëm ekzaminimi objektiv i së dëmtuarës A. L. ose vlerësimi i materialeve të çështjes, si: fotot, kartelat klinike ose çdo material tjetër që ju dispononi dhe që mund të ndihmojë ekspertin të arrijë në konkluzione”.

<sup>40</sup> Neni 59 i K.Pr.Penale, pika 1 parashikon: “Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga neni 90 [...] të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit”.

nga prokurori të aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2021, kryer nga eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S. **(iii)** Gjithashtu, në ankimin e saj në gjykatë, shtetasja A. L. ka parashtruar edhe kërkesën për pavlefshmëri të aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 12.03.2021, protokolluar pranë organit procedues me nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2021, kryer nga eksperti mjekoligjor A. T., duke pretenduar se ky i fundit “është në varësi të E. Dh.”, rrethanë për të cilën parashtron se përbën “konflikt interesi [...] ndërmjet detyrës publike<sup>41</sup> dhe interesit privat të zyrtarit<sup>42</sup>”.

Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2021, ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë pranë kësaj gjykate dhe vazhdimin e hetimeve në funksion të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2021. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.11.2021, ka lënë në fuqi vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

Pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, në kushtet kur procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2021, është marrë sërish për veprime hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, shtetasja A. L., më datë 16.03.2022, ka kryer kallëzim penal për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

Subjekti, pasi është njohur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2022, të denoncueses, ka paraqitur para drejtuesit të prokurorisë dorëheqjen nga hetimi i kësaj çështjeje, nr. {\*\*\*}/2021, si dhe asaj të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2021 për ekspertin E. S., që është regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Për shkak të kësaj situatë, subjekti në ankim ka pretenduar se kjo çështje vijon të jetë ende në fazën e hetimit paraprak dhe e ka objektivisht të pamundur të paraqesë dokumentacion argumentues se edhe Komisioni nuk ka pasur këtë informacion, për këtë arsye kërkon nga Kolegji çeljen e shqyrtimit gjyqësor të çështjes me qëllim administrimin në seancë gjyqësore të fashikullit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2021.

**21.1.7.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka treguar asnjë mangësi profesionale në hetimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2021, duke evidentuar se ai është kujdesur të provojë se eksperti mjekoligjor A. T. nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në kryerjen e detyrës pasi: **(i)** edhe pse nga kallëzuesja A. L. është pretenduar një fakt i tillë, sepse eksperti mjekoligjor A. T. ishte në varësi të E. Dh. (dhunuesit të denoncueses), i cili ushtronte funksionin e drejtorit të Shërbimit Spitalor Sarandë, rrethana që, sipas saj, përbëjnë konflikt interesi mes ushtrimit të detyrës publike dhe interesit privat, ai është i pabazuar. Për të provuar këtë fakt, subjekti referon se, në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 14.05.2021, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Sarandë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2021, informon se: *Shtetasi A. T. që prej datës 27.06.2012 ushtron funksionin si drejtor/mjek pranë Qendrës Shëndetësore Konispol.*

<sup>41</sup> Nënkupto detyrën që përmbushte eksperti mjekoligjor A. T.

<sup>42</sup> Nënkupto shtetasit E. Dh., që në ato çaste përmbushte detyrën e drejtorit të Shërbimit Spitalor Sarandë.

*Emërtimi i tij është bërë nga Bordi i ish-Drejtorisë së Shëndetit Publik Sarandë [...]; Titullari i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Sarandë është A.K. (ii) Subjekti, në ankim, gjithashtu parashtron se: mjafton vetëm referimi te vendimi nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2021, i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, për të kuptuar se në rastin konkret, nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk janë "shfaqur mangësi profesionale në hetimin e kësaj çështjeje", por ka qenë krejt e kundërta. Te ky vendim arsyetohet se: Gjykata çmon si përfundim se, bazuar në provat e administruara dhe të marra në shqyrtim, nuk ekzistojnë elemente të figurës së veprës penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal".*

**21.1.8.** Lidhur me këtë procedim penal, rezulton se Inspektorati i Lartë të Drejtësisë (në vijim "ILD"), me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.07.2021, ka marrë vendim "Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja A. L." dhe ka administruar fashikullin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2021, si dhe ka kërkuar informacion për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2021, regjistruar për veprën penale "Shpërdorim i detyrës"<sup>43</sup>. Në përfundim, pas verifikimit të ankesës, ILD-ja, me vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2025<sup>44</sup>, ka vendosur "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara, të paraqitura nga shtetasja A. L.", me argumentin se nga analiza e të dhënave të grumbulluara nga verifikimi, arrihet në konkluzionin se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e ndonjë hetimi disiplinor, për kryerjen e shkeljeve disiplinore të parashikuara nga ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**21.1.9.** Për sa më lart, trupi gjykues, në konsideratë të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, në raport me konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje, vlerësoi se me të drejtë Komisioni ka konkluduar për mangësi profesionale të subjektit në mënyrën se si ka ndërmarrë hetimin e çështjes dhe arritjen e konkluzioneve përfundimtare lidhur me të, pavarësisht disa qëndrimeve të ndryshme për disa nga çështjet e ngritura prej denoncueses.

*Së pari*, trupi gjykues çmon se nuk mund të ketë një çështje për t'u zgjidhur nga organet e rivlerësimit, që konsiston në cilësimin ligjor të veprimeve të kryera nga personi të cilit i atribuohet vepra penale, pasi lidhur me këtë kualifikim, për të cilin janë ngritur pretendime në vazhdimësi nga denoncuesja A. L., ka mbajtur një qëndrim përfundimtar gjykata që ka shqyrtuar ankimin e saj ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal, duke mos e gjetur të drejtë kualifikimin e faktit penal si "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, siç pretendon denoncuesja. Trupi gjykues vlerëson se ky kualifikim lidhet kryesisht me analizën e elementeve të veprës penale "Dhuna në familje", e cila kushtëzohet nga marrëdhënia mes së dëmtuarës dhe autorit të dyshuar, si ish-krushqi, e cila nuk përfshihet në kategorinë e mbrojtur prej kësaj dispozite, dhe jo nga përcaktimi i nivelit të dëmtimeve, për pasojë, analiza ligjore e bërë prej subjektit, e cila është gjetur edhe e drejtë prej gjykatave, mbetet një çështje jashtë analizës së trupit gjykues.

---

<sup>43</sup> Në përgjigje të kërkesës për marrje informacioni nga gjyqtarja relatores e çështjes, bazuar në nenin 15, pika 5, shkronja "ç" e ligjit nr. 84/2016, ILD-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.07.2025, me anë të së cilës është përcjellë vendimi i ILD-së "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara, të paraqitura nga shtetasja A. L." nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2025.

<sup>44</sup> Vendim i cili është përcjellë në Kolegj me shkresën e ILD-së nr. {\*\*\*} prot., datë 03.07.2025.

*Së dyti*, për sa i takon pretendimit tjetër të denoncueses, të gjetur të dejtë nga Komisioni, e që lidhet me pretendimet se eksperti mjekoligjor A. T. ishte në kushtet e konfliktit të interesit për kryerjen e detyrës për shkak të marrëdhënieve të punësimit/varësisë me të dyshuarin, trup gjykues vlerëson se përgjigjja e referuar në informacionin e ofruar nga shkresa me nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2021, e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Sarandë, shkëput çdo dyshim për ndonjë marrëdhënie të tillë dhe zhvesh nga problematika përzgjedhjen e subjektit për caktimin e tij si ekspert, si edhe moskonsiderimin në vijim të pretendimeve të denoncueses për ekzistencën e këtij konflikti dhe afektimin e konkluzionit të aktit të ekspertimit prej saj.

*Së treti*, lidhur me pretendimin tjetër të denoncueses, për pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit të hartuar prej ekspertit mjekoligjor E. S., të konstatuar prej subjektit, trupi gjykues, pavarësisht faktit se Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit lidhur me marrjen e këtij vendimi, vlerëson se pikërisht në mënyrën se si është administruar ky veprim hetimor nga ana e prokurorit, qëndron edhe problematika thelbësore e hetimit të çështjes, e konstatuar edhe prej vendimeve gjyqësore që kanë urdhëruar hetimin e mëtejshëm të çështjes. Trupi gjykues, përtej faktit se nuk ngarkon dot disiplinarisht subjektin për shkak të mangësive të konstatuara në konstatimin e pavlefshëm të aktit të ekspertimit të hartuar prej ekspertit E. S., meqë Komisioni ka pranuar si bindëse shpjegimet e tij rreth kësaj vendimmarrje, sipas një vlerësimi incidental, vëren se subjekti i rivlerësimit, në konstatimin e pavlefshëm të këtij akti, ka tejkalluar parashikimin ligjor të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: *Aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ky Kod*, ndërsa nenet 179 e 181 të Kodit të Procedurës Penale, cituar prej tij si bazë ligjore për pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit, përveç se parashikojnë rregullat për caktimin e ekspertit, nuk parashikojnë një pasojë të tillë në kushtet e moszbatimit të tyre, siç duket se ka ndodhur në rastin konkret.

**21.1.10.** Përtej konstatimit të mësipërm, trupi gjykues vëren se konstatimi i pavlefshëm i aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. {\*\*\*} të vitit 2021, të kryer nga eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S., është bërë prej subjektit në datën 08.03.2021, megjithëse subjekti ishte vënë në dijeni të aktit të ekspertimit që në datën 02.02.2021<sup>45</sup>, i cili dhe ishte përdorur prej tij si akti bazë për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, që do të thotë se është pranuar si i saktë konkluzioni i tij dhe pasojat që ai ka prodhuar. Kjo situatë sugjeron se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të kryerjes së këtij akti prej ekspertit të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, dhe në prezumimin që subjekti e dinte se vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit caktonte një ekspert tjetër, ai duhej të kishte reaguar në raport me këtë akt, që në momentin fillestar të regjistrimit të procedimit penal. Kryerja e veprimeve hetimore në këtë rend dhe në këtë aspekt kohor, do të mundësonte ekspertin e caktuar prej oficerit të policisë gjyqësore, z. A. T., të kryente ekspertimin bazuar në këqyrjen dhe ekzaminimin e së dëmtuarës

---

<sup>45</sup> Subjekti, në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit në Komision, ka referuar se:

“Ndërkohë, teksa materiali kallëzues i regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2021, gjendej në fazën e verifikimit paraprak, pra ende pa u regjistruar procedimi penal, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2021, të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, në dispozicion të organit procedues është vënë akti i ekspertimit mjekoligjor nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2021, kryer nga eksperti mjekoligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, z. E. S.

drejtpërdrejt dhe jo mbi bazën e fotografive, siç ka ndodhur pas dy muajsh, kur shenjat e dëmtimeve nuk gjendeshin më në trupin e së dëmtuarës. Në këtë mënyrë, eksperti do të kishte mundësi të hartonte një akt ekspertimi mbi baza shkencore, që do të përcaktonte nivelin real të dëmtimeve dhe, për pasojë, edhe kualifikimin e saktë ligjor të veprës penale të kryer. Reagimi me vonesë i subjektit të rivlerësimit, duke abstraguuar nga besueshmëria në ligj e vendimit për pavlefshmëri të aktit të ekspertimit, ka shkaktuar defektimin e vendimit të tij për kualifikimin ligjor të faktit penal e, për pasojë, ka demonstruar mangësi të aftësive profesionale që kanë cenuar interesat e shtetasve, e të cilat me të drejtë janë vlerësuar nga Komisioni sipas indikatorëve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

**21.2.** Në këto kushte, trupi gjykues konsideron të padrejta pretendimet e subjektit si më sipër arsyetuar, lidhur me konkluzionet e Komisionit sa i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}/2021 që ka të bëjë me kallëzimin e shtetas A. L.<sup>46</sup>, dhe i bëri këto konkluzione pjesë të vlerësimit të subjektit në raport me procesin e tij të rivlerësimit, në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**22.** *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019, që i përket ankimit në ILD<sup>47</sup> të shtetas F. H., trupi gjykues vlerëson sa vijon.*

**22.1.** Në vendimin e Komisionit, lidhur me denoncimin e shtetas F. H., është analizuar dhe konkluduar se: *Komisioni vlerëson se subjekti në prapësimet e tij, ndonëse ka analizuar dhe arsyetuar shkaqet për të cilat ka vendosur mosfillimin e procedimit penal bazuar në normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, vëren se subjekti nuk ka shpjeguar dhe as dokumentuar veprimet konkrete hetimore të kryera prej tij, pas regjistrimit të procedimit penal (pas shtatorit të vitit 2019), përveçse administrimit të praktikës së pasurisë nga ASHK-ja Sarandë në datën 8.10.2019. Nisur nga shpjegimet e subjektit, Komisioni evidenton se nga muaji tetor 2019, kur është administruar praktika nga ASHK-ja, deri në janar 2020, kur është kërkuar pushimi i çështjes penale, subjekti i është dashur më shumë se 3 muaj për të konkluduar se vepra penale është parashkruar. [...] Në përfundim të analizës, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës në lidhje me këtë procedim penal, duke shkaktuar zvarritje të pajustificuar në hetimin e kësaj çështjeje penale, të cilat përbëjnë mangësi profesionale, referuar parashikimeve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.*

**22.2.** *Subjekti i rivlerësimit, me ankimin, kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke shpjeguar dhe pretenduar se, në kallëzimin penal të shtetas F. H., i cili në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë është regjistruar si material kallëzues me nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2018, denoncuesja ngre pretendime mbi ekzistencën e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Sipas këtyre pretendimeve,*

---

<sup>46</sup> Në vendimin e përmbledhur të datës 15.07.2025, paragrafi 6.7, si një gabim material është referuar çështja që i përket denoncueses A. L., si çështje për të cilën janë vlerësuar si të drejta dhe të argumentuara qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësim i cili i përket çështjes me ankuese F. H., të trajtuar në vijim.

<sup>47</sup> Ankuesja F. H. rezulton se ka paraqitur në ILD ankesat e regjistruara me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.10.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 05.11.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 15.07.2021, si dhe {\*\*\*} prot., datë 15.07.2021, për të cilat ILD-ja, pas shqyrtimit fillestar të tyre me vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 28.03.2023, ka vendosur: "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja F. H."

falsifikimi i supozuar i dokumentacionit të depozituar në proceset gjyqësore të sipërcituara, është kryer deri në datën e vendimmarrjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pra deri në datën 05.03.2004. Nisur nga ky deklaram i kallëzueses, subjekti i rivlerësimit, në konsideratë të masës së dënimit të parashikuar në nenin 186/1 të Kodit Penal, ka vlerësuar se në referim të nenit 66, paragrafi 1, germa "c" e Kodit Penal, ndjekja penale nuk mund të ushtrohej pasi tashmë ajo ishte e parashkruar. Për këtë arsye, në datën 08.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka marrë "Vendim për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2018", kundër të cilit kallëzuesja F. H. ka ushtruar ankim. Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi ka shqyrtuar ankimin e kallëzueses F. H., me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2019, ka vendosur "Shfuqizimin e vendimit të prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të datës 08.11.2018, për "Mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2018", vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjjirokastër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.03.2019.

**22.3.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se, në kushtet kur për materialin kallëzues të F. H., në zbatim të vendimeve të mësipërme të gjykatave, u regjistrua si procedimi penal {\*\*\*}, më datë 13.09.2019, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", i parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, subjekti, pas regjistrimit të tij, ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, duke administruar më datë 08.10.2019, informacion dhe praktikën e përcjellë nga ASHK Sarandë, nga e cila rezulton se pasuria e paluajtshme për të cilën ishte paraqitur kallëzimi i kësaj shtetaseje, është regjistruar për herë të parë më datë 13.12.2001. Subjekti ka vlerësuar se kjo e dhënë provon faktin se për kallëzimin e znj. H. nuk mund të ushtrohet ndjekje penale për veprën penale falsifikim dokumentacioni, pasi në aplikim të nenit 66 të Kodit Penal, ushtrimi i ndjekjes penale është parashtruar. Ndodhur në këto kushte, subjekti referon se më datë 28.01.2020, ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë pushimin e akuzës për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019, kërkesë e cila është miratuar me vendimin e kësaj gjykate të datës 11.03.2021. Subjekti, në ankim, gjithashtu pretendon se nuk është i saktë përshkrimi i paragrafit 67.2.6 të vendimit të Komisionit se kjo çështje është nën hetim, pasi vendimi nr. {\*\*\*} i datës 11.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Komisioni, kishte marrë formë të prerë, dhe këtë fakt ai ia ka bërë prezent Komisionit me *e-mail*-in e datës 24.01.2024, si dhe në seancën dëgjimore publike.

**22.4.** Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton, *së pari*, se qëndron pretendimi lidhur me statusin e procedimit penal, të cilin subjekti e ka saktësuar në *e-mail*-in e datës 14.01.2024, dërguar Komisionit dhe në seancën dëgjimore të datës 18.01.2024. Në këtë kontekst, nuk ka dyshime për statusin e çështjes dhe rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që ka pranuar kërkesën e subjektit për pushimin e procedimit penal, ka marrë formë të prerë.

**22.5.** Në kushtet e mësipërme, trupi gjykues mori në analizë konkluzionin e Komisionit se kalimi i një afati kohor prej tre muajsh prej subjektit, për marrjen e vendimit të pushimit të procedimit penal, përbën shkelje dhe tregon për mangësi në aspektin e kriterit të aftësive profesionale. Në këtë këndvështrim, ky konkluzion i Komisionit, i cili mbështetet vetëm në kalimin një afati tremujor, nga administrimi i praktikës prej ASHK-së që provonte se pasuria për të cilën është paraqitur kallëzim për falsifikim dokumentacioni, është regjistruar për herë

të parë më 13.12.2001, deri në paraqitjen prej tij në gjykatë, të kërkesës për pushimin e procedimit të datës 28.01.2020, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk përmban elementet e nevojshme për t'u ngritur në nivelin e një problematike domethënëse që mund të analizohet në kuadër të vlerësimit të subjektit për aftësitë e tij profesionale. Vonesa, në marrjen e këtij vendimi, ndonëse konfirmohet se ka ndodhur, pa një analizë të mirëfilltë të rrethanave që e kanë shkaktuar atë dhe në perspektivën e përgjithshme të një ngarkese në punë, nuk mund të ketë peshë në konsiderimin e çështjes sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në këtë drejtim, trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me të.

23. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2017<sup>48</sup>, për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjera”, të trajtuar në vendimin e Komisionit në rubrikën “Gjetje të tjera të kriterit profesional”, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

23.1. Komisioni, në vendim, evidenton se duke iu referuar informacioneve të marra nga autoritetet verifikuese, vlerësoi të administrojë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë 6 (gjashtë) dosje penale, si dhe disa akte procedurale të subjektit të rivlerësimit Ilir Hoxha, për të cilat kishte referim në këto informacione, prej të cilave iu kërkuan shpjegime subjektit për 5 (pesë) prej tyre dhe, në përfundim të vlerësimit të bërë prej Komisionit, pas shpjegimeve të sjella nga subjekti, u gjetën problematika lidhur me procedimin penal me nr. {\*\*\*}/2017.

23.2. Lidhur me këtë procedim penal, Komisioni në vendim analizon dhe konkludon se: *sa i përket vonesës dhe moskoherencës së veprimeve hetimore në dërgimin e letërporosive drejtuar autoriteteve të huaja, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe të shpjegojë bindshëm arsyen e zvarritjes së veprimeve hetimore, si dhe moskryerjen e ballafaqimit midis drejtuesve të mjeteve, bazuar në nenet 169 dhe 170 të Kodit të Procedurës Penale, nisur nga deklarimet kontradiktore të dhëna prej tyre, të cilat mund të çonin në zbardhjen e rrethanave të çështjes penale dhe zgjidhjen e saj. Trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore në një kohë të arsyeshme në trajtimin e kësaj çështjeje penale, pasi kërkesat për ndihmë juridike, drejtuar autoriteteve gjyqësore në Kroaci dhe Kosovë, mund t'i kishte dërguar në të njëjtën kohë, pra në vitin 2017, ndërsa njërën prej këtyre kërkesave e ka dërguar pas 3 vitesh. Gjithashtu, Komisioni konstaton zvarritje të hetimit të kësaj çështjeje, e cila është regjistruar si procedim penal në maj të vitit 2017 dhe akti i fundit i prokurorit ka qenë kërkesa e datës 21.06.2023, për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017. Përfundimisht, Komisioni çmon se subjekti ka krijuar vonesa të qëllimshme duke zvarritur hetimin e kësaj çështjeje penale, çka përbën cenim të veprimtarisë së organit të akuzës dhe moskryerje të detyrës në nivelin e duhur nga ana e subjektit.*

23.3. Subjekti, në ankim, fillimisht kundërshton konkluzionet e mësipërme të vendimit të Komisionit duke i kundërshtuar ato për elementet e trajtuara më sipër, që kanë të bëjnë me pretendimin se çështja penale nr. {\*\*\*}/2017 nuk duhej të vlerësohej nga Komisioni, pasi ishte në proces gjykimi nga gjyqtari i seancës paraprake dhe duhej trajtuar në kuadër të kufizimeve të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Pa përsëritur analizën e bërë më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin se veprimtaria që merret në analizë, është veprimtaria hetimore e

---

<sup>48</sup> Dërguar në Komision me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 04.07.2023.

subjektit për periudhën 2017-2023, derisa ai ka vendosur të kërkojë pushimin e procedimit penal, duke e mbyllur veprimtarinë e tij hetimore. Çështjet e ngritura nga Komisioni në rezultatet e hetimit, për të cilat është kaluar barra e provës, i përkasin aktivitetit të subjektit të rivlerësimit në vitet 2017-2020, e cila është një veprimtari hetimore e përmbyllur dhe e pamundur të ndikohet nga hetimi administrativ që ka kryer Komisioni, që do të thotë në garantim të plotë të asaj që synon të mbrojë kufizimi i nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht së subjektit në vendimmarrjen e tij. Për më tepër, veprimtaria hetimore e Komisionit lidhur me këtë procedim penal, është iniciuar nga informacionet e organeve ligjzbatuese, që duket se kanë krijuar dyshime rreth veprimtarisë së subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë qenë të nevojshme të verifikohen.

**23.4.** Në këto kushte, edhe në këtë rast, trupi gjykues e gjeti hetimin e kryer nga Komisioni në përputhje me diskrecionin e këtij organi e, si pasojë, vijoi me shqyrtimin e pretendimeve që i adresoheshin themelit të çështjes, të parashtruara si vijon.

**23.4.1.** Nuk qëndron konstatimi i Komisionit se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm *moskryerjen e ballafaqimit midis drejtuesve të mjeteve, në kushtet kur kishte deklarime kontradiktore të drejtuesve të tyre*, duke pretenduar se:

**i.** Shtetasi M. S., më datë 18.05.2017, është paraqitur personalisht para subjektit të rivlerësimit dhe ka dhënë deklaratimet e tij të evidentuara nga subjekti në aktin procedural “Kërkesë për pushimin e çështjes së procedimit penal {\*\*\*}/2017 të datës 21.06.2023”.

**ii.** Shtetasi kroat L. T., bazuar në urdhërimet e subjektit, është marrë në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore të çështjes të nesërmen, më datë 19.05.2017, duke dhënë deklarime me shkrimin e tij në gjuhën kroate, të cilat janë përkthyer në gjuhën shqipe, nga të cilat rezultuan të dhëna që tregojnë inkriminimin e tij, e që sipas nenit 37, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale konsiderohen “deklarime që tregojnë vetëpërgjegjësi”. Në këto kushte, oficeri i policisë gjyqësore ka ndërprerë marrjen e deklaratimeve nga shtetasi kroat L. T. Subjekti, në ankim, evidenton se në këto momente oficeri i policisë gjyqësore duhet ta paralajmëronte deklaratuesin T. se, bazuar në këto deklarime, mund të nisnin hetime ndaj tij dhe ta ftonte për të marrë një avokat, detyrim të cilin oficeri i policisë gjyqësore nuk e ka përmbushur.

**iii.** Oficeri i policisë gjyqësore, në zbatim të vendimit të nxjerrë nga subjekti “Për delegimin e veprimeve hetimore”, kishte detyrimin që për çdo veprim hetimor të kryer, të njoftonte subjektin, dhe nuk e ka kryer këtë detyrë, për pasojë subjekti ka ardhur në dijeni të deklaratimeve të shtetasit kroat L. T. shumë kohë më pas, rreth momentit kur subjekti ka bërë letërkërkesën për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore në Republikën e Kosovës, për afërsisht në shtator të vitit 2017, kohë në të cilën shtetasi kroat ishte larguar nga territori shqiptar.

**iv.** Në zbatim të përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale, deklaratimet që tregojnë vetëpërgjegjësi të shtetasit kroat L. T. jo vetëm që nuk mund të shfrytëzoheshin kundër tij, por nuk mund të citohen as si provë dhe nuk mund të përdoren si të tilla. Subjekti shpjegon se, gjendur në këto kushte, me qëllim përfundimin e provave të nevojshme për ecurinë e hetimeve të këtij procedimi penal, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 16.06.2020, u ka parashtruar autoriteteve gjyqësore të Republikës së Kroacisë letërkërkesë për ndihmë juridike

në fushën penale, me të cilën është synuar marrja e deklarimeve nga shtetasi T. Subjekti evidenton se nga ekzekutimi i letërkërkesës për ndihmë juridike në fushën penale nga ana e autoriteteve gjyqësore kroate, nuk është arritur të merret asnjë deklaram i shtetasit L. T. dhe nuk është përfituar asnjë provë që provon dyshimet se kishim të bënim me inskenim të ngjarjes objekt hetimi i procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se pavarësisht se është i vërtetë fakti se intervali kohor mes periudhës kur autoriteteve gjyqësore të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Kroacisë iu janë përcjellë letërkërkesat respektive për ndihmë juridike, respektivisht shtator 2017 dhe qershor 2020, është një periudhë prej gati 3 (tri) vitesh, por kjo ka ardhur si pasojë e faktit se parashtrimi i këtyre kërkesave është bërë në momentet procedurale<sup>49</sup> kur është vlerësuar e nevojshme nga prokurori i çështjes.

v. Zgjatja 6 (gjashtë) vite e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, ka qenë e ndikuar nga nevoja e ekzekutimit të letërkërkesave për ndihmë juridike në fushën penale nga Kosova dhe Kroacia, të cilat nuk janë ekzekutuar, si dhe janë ndikuar edhe nga ngarkesa në punë e subjektit të rivlerësimit, i cili u ka dhënë prioritet çështjeve të tjera që në atë kohë janë vlerësuar se kanë qenë më të ngutshme.

vi. Në kushtet ku autoritetet kroate nuk kanë kthyer përgjigje mbi letërkërkesën për ndihmë juridike, si dhe faktin që nuk është përftuar asnjë provë për zgjidhjen përfundimtare të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, rrethana e mosdërgimit të letërkërkesës në shtetin kroat në të njëjtë kohë kur është përcjellë edhe në Kosovë mbetet pa peshë, pasi edhe nëse përcilleshin në të njëjtën kohë, sërish nuk do të mund të siguroheshin prova.

vii. Bazuar në situatën e përshkruar më sipër, është i gabuar dhe jo i drejtë konkluzioni i Komisionit që e ka ngarkuar me përgjegjësi për moskryerje të ballafaqimeve mes shtetasit kroat L. T. dhe drejtuesit kosovar të mjetit tjetër, shtetasit M. S.

23.4.2. Trupi gjykues, nga analizimi i pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2017, konstaton se kundërshtimet e tij lidhur me konkluzionin e Komisionit, *së pari*, duket se u referohen mangësive apo problematikave të lidhura me veprimtarinë hetimore të oficerit të policisë gjyqësore, i cili, sipas subjektit, nuk ka kryer si duhet detyrën e tij lidhur me pyetjen e shtetasit kroat L. T., e cila ka pasjellë edhe mungesën e veprimtarisë hetimore që do të duhej të ushtrohej prej prokurorit. Lidhur me këtë

---

<sup>49</sup> Në ankim, subjekti shprehet se: "Komisioni ka anashkalluar faktin se vlerësimi i strategjisë së hetimit çmohet vetëm nga prokurori i çështjes si organ i ushtrimit të ndjekjes penale dhe Komisioni nuk mund të hyjë në interpretimin e prokurorit për një çështje konkrete dhe, rrjedhimisht, Komisioni nuk mund të interpretojë në lidhje me kohën se kur duhet parashtruar një letërkërkesë për ndihmë juridike në fushën penale. Referuar parashikimeve në nenin 509 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe parashikimeve në ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009, "Për marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja në çështje penale", i ndryshuar, që rregullojnë nga ana procedurale dërgimin e letërkërkesave për ndihmë juridike autoriteteve të huaja, nuk përcaktohen afate apo momente konkrete të një çështjeje apo procedimi penal në të cilën një autoriteti të huaj i dërgohet letërkërkesë për ndihmë juridike. Në të tilla rrethana, momenti procedural në të cilin një letërkërkesë për ndihmë juridike i parashtrohet autoritetit të huaj mbetet vetëm në vlerësim të organit procedues, në rastin konkret të subjektit të rivlerësimit".

pretendim, trupi gjykues sjell në vëmendje se veprimtaria hetimore e oficerit të policisë gjyqësore ushtrohet nën autoritetin e kontrollin e prokurorit të çështjes, i cili ka për detyrë të monitorojë me dilijencën e duhur këtë veprimtari, në përputhje me parashikimet e neneve 24<sup>50</sup>, 33, pikat 1 dhe 2<sup>51</sup>, 293, pika 1<sup>52</sup> e 304, pika 2<sup>53</sup> e Kodit të Procedurës Penale. Ai duhet të sigurojë që të jetë i informuar në kohë për kryerjen e veprimtarisë hetimore, aq më tepër për çështje me një natyrë delikate, siç ishte rasti në fjalë, një fakt penal i shoqëruar me vendngjarje, e me elemente të huaja, për të cilin kujdesi dhe vëmendja duhej të ishte e shtuar. Pretendimi i subjektit, sipas të cilit ai është vënë në dijeni të pyetjes së shtetasit kroat vetëm tre muaj më pas dhe, për pasojë, e ka pasur të pamundur të operojë me kryerjen e veprimit hetimor të ballafaqimit, tregon për mangësi profesionale dhe më së paku neglizhencë në kryerjen e detyrës, e cila ka afektuar cilësinë dhe mbarëvajtjen e procedimit penal. Nga rrethanat e rastit, duket se ka qenë me rëndësi të posaçme marrja e deklarimeve në mënyrën e duhur ligjore prej shtetasi kroat L. T. dhe më pas ballafaqimi i tij me shtetasin M. S., të cilët, ndonëse deklarojnë për të njëjtat ngjarje, i kanë sjellë ato në mënyra të ndryshme para organit të akuzës, duke deformuar të vërtetën, të paktën njëri prej tyre. Sqarimi i rrethanave të faktit prej këtyre dy shtetasve, ka rezultuar me rëndësi për zbardhjen e çështjes. Mungesa e marrjes së deklarimeve të shtetasit kroat, në përputhje me dispozitat procedurale, dhe mungesa e ballafaqimit të tij me shtetasin S. kanë sjellë si pasojë pamundësinë që këto burime provash të rikuperohen në të ardhmen, dhe kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në dështimin e hetimit për zbulimin e ngjarjes.

**23.4.3. Së dyti**, edhe pse subjekti në ankim, ashtu si edhe në Komision, është përpjekur të japë shpjegime se zgjatja në kohë e hetimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2016 nuk është varur prej tij, rezulton se mbeten të pashpjeguara arsyet përse subjekti, nga shtatori 2017 (kur ai vetë pretendon se është informuar për deklaratimet që e ngarkojnë me vetëpërgjegjësi shtetasin kroat), nuk ka vijuar menjëherë me përcjelljen e letërkërkesës për ndihmë juridike në fushën penale në Kroaci. Nisja rreth 3 (tri) vite më vonë e letërkërkesës në shtetin kroat jo vetëm që duket se ka ulur shanset/mundësitë për të marrë nga ky shtet të dhëna të vlefshme e prova për hetimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, por duket ka shërbyer edhe si element procedural për ta mbajtur të hapur këtë procedim penal për një kohë të gjatë e të paarsyeshme, në kundërshtim me detyrën funksionale të prokurorit, e cila duhet të synojë përfundimin hetimit në një kohë sa

---

<sup>50</sup> “Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.”

<sup>51</sup> “1. Policia gjyqësore përgjigjet përpara prokurorit për veprimtarinë e kryer prej saj gjatë procedimit penal. 2. Policia gjyqësore kryen detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe e njofton atë menjëherë mbi rezultatet e tyre.”

<sup>52</sup> “Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit.”

<sup>53</sup> “Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit dhe ballafaqimet, në të cilat merr pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Në këtë rast, policia gjyqësore respekton dispozitat për caktimin dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit në veprimet hetimore.”

më të shpejtë duke kryer veprimtarinë hetimore në mënyrë të logjikshme e efikase. Lënia pa veprime, madje e pezulluar e veprimtarisë procedurale për një periudhë trevjeçare, për të nisur më pas një letërkërkesë tjetër, pas rihapjes së saj tri vite më vonë, vonesë për të cilën subjekti nuk jep asnjë argumentet justifikues e bindës, jo vetëm që është e paarsyeshme dhe në kundërshtim me një strategji hetimore efikase, por ka rezultuar edhe në mosvjeljen e asnjë të dhëne në dobi të hetimit, pavarësisht kohës tejet të gjatë që ai ka marrë.

23.5. Për rrjedhojë, trupi gjykues, referuar në sa analizuar më sipër, veçanërisht duke pasur në konsideratë se këto shkelje janë konstatuar edhe në sfondin e informacioneve të institucioneve ligjzbatuese, çmon se lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2017, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit *ka krijuar vonesa të qëllimshme duke zvarritur hetimin e kësaj çështjeje penale, çka përbën cenim të veprimtarisë së organit të akuzës dhe moskryerje të detyrës në nivelin e duhur nga ana e subjektit*, është i drejtë dhe i argumentuar

24. *Lidhur me problematikat e prezantuara ne denoncimet<sup>54</sup> e përcjella në Komision për subjektin e rivlerësimit, duke analizuar respektivisht pretendimet e subjektit për secilin prej tyre, trupi gjykues vlerëson sa vijon.*

25. *Lidhur me denoncimin e z. V. Q., i cili lidhet me procedimin penal nr. {\*\*\*/2017, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

25.1. Sipas vendimit të Komisionit, denoncuesi V. Q. *ankohet për zvarritje të hetimit përreth 2 vjet, lidhur me çështjen penale nr. {\*\*\*}, viti 2017, në ngarkim të shtetasve Ll. Zh. dhe Th. K., të akuzuar për veprat penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 143 dhe 186/1 të Kodit Penal, si dhe për zgjatjen e afatit të hetimit për arsye të papranueshme për shkak të kërkesës së të pandehurve që të njihen me materialet e çështjes në ngarkim të tyre dhe për të paraqitur prova të reja. Pas kryerjes së hetimit administrativ lidhur me këtë denoncim dhe marrjes së shpjegimeve të subjektit lidhur me të, Komisioni ka arritur në konkluzionin se çmon se shpjegimet e tij lidhur me zgjatjen e afateve hetimore për disa raste, kanë qenë për arsye objektive, ndërsa konstaton se vendimet e disponuara prej tij për zgjatje të afateve hetimore, janë të paarsyetuara dhe të pashoqëruara me veprime hetimore shtesë për të përligjur këto vendimmarrje, fakt ky i konfirmuar edhe nga*

---

<sup>54</sup> Denoncimet e analizuara, për të cilat subjekti ka paraqitur pretendime duke kundërshtuar qëndrimin e Komisionit, janë:

- i. denoncimi i shtetasit V. Q., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2017;
- ii. denoncimi i shtetasit S. D., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2018 dhe nr.{\*\*\*/2018;
- iii. denoncimi i shtetasit A. B., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2017;
- iv. denoncimi i shtetasit M. A., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2020;
- v. denoncimi i shtetasit A. M., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2023 (në Vlorë me nr. {\*\*\*/2023);
- vi. denoncimi i shtetasit A. H., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2017;
- vii. denoncimi i shtetasit D. B., që ka të bëjë me çështjen e materialeve kallëzuese nr. {\*\*\*/2017 dhe nr. {\*\*\*/2022;
- viii. denoncimi i shtetasit J. D., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2020;
- ix. denoncimi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2019;
- x. denoncimi i shtetasit K. R., që ka të bëjë me çështjen e procedimit penal nr. {\*\*\*/2020.

*kontrolli gjyqësor, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e datës 20.9.2018, ndër të tjera, ka urdhëruar organin e akuzës të përfundojë hetimet dhe të njoftojë personat e interesuar për përfundimin e tyre. Sa i përket njoftimit të palëve për përfundimin e hetimeve, subjekti ka shpjeguar se e ka kryer këtë veprim procedural në datën 24.9.2018, në respektim të nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni evidenton se ky akt duhej të ndërmerrej nga subjekti para se gjykata ta konstatonte këtë mangësi procedurale përmes vendimit të datës 20.9.2018, ku nga ana e subjektit janë përfunduar veprimet e mundshme dhe të nevojshme hetimore për të provuar akuzat, por pa njoftuar përfundimin e hetimeve, ka vendosur të vërë në dispozicion aktet e hetimeve paraprake të të pandehurit Th. K. Kjo e drejtë, sipas nenit 327/2, lind vetëm pasi më parë njoftohet përfundimi i hetimeve. Përfundimisht, trupi gjykues çmon se subjekti ka zvarritur pa arsye hetimin e çështjes.*

**25.2.** Subjekti i rivlerësimit ka kontestuar këto konkluzione, *së pari*, me pretendimin se procedimi penal nr. {\*\*\*/2018, gjendet për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë dhe, për këtë shkak, në aplikim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, kjo çështje nuk duhet të përfshihet në grupin e çështjeve që Komisioni do të shqyrtonte në funksion të kriterit të vlerësimit të atësive profesionale të subjektit, pasi përfaqëson një çështje “në shqyrtim”. Gjithashtu, lidhur me arsyetimin e Komisionit për zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti pretendon se:

**i.** Fillimisht është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*/2017, në ngarkim të shtetasit Ll. Zh., emri i të cilit është regjistruar në regjistrat e njoftimit të veprave penale më 01.02.2017, për veprën penale “Mashttrim” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Më pas, mbi bazën e denoncimit të dytë të z. V. Q., të datës 29.01.2018, është regjistruar edhe procedimi penal nr. {\*\*\*/2018, datë 29.01.2018, në ngarkim të shtetasit Th. K., për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Bazuar në nenin 92/1/c të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, duke vlerësuar se këto dy procedime penale lidhen me njëri-tjetrin, më datë 27.02.2018, i ka bashkuar në një procedim të vetëm, atë me nr. {\*\*\*/2017.

**ii.** Janë kryer veprime të shumta hetimore, si: sekuestri i aktesh, këqyrje dokumentacioni, marrje deklaramesh të shtetasve që jetonin jashtë vendit, të cilat kanë qenë të shtrira në kohë dhe janë zhvilluar në përputhje me dinamikën e hetimit, por që nuk kanë mundur përfundimin e tij brenda afatit dhe, për këtë arsye, është bërë zgjatja e afatit të hetimeve sipas parashikimit të nenit 323/2 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, subjekti shpjegon se arsyet e zgjatjes së afatit të hetimeve, janë të rrjedhura nga nevoja e kryerjes së aktit të ekspertimit grafik të z. V. Q. në aktet noteriale, i urdhëruar me vendimin e datës 11.9.2017, veprim i cili ka passjellë zgjatjen e afatit të hetimit më datë 31.10.2017. Po ashtu, lidhur me veprën penale të “Mashttrimit”, sipas nenit 143/2 të Kodit Penal, ishte i domosdoshëm identifikimi i vlerave reale që shtetasi Ll. Zh. kishte mundur të përfitonte nga falsifikimi i akteve noteriale, veprim i cili nuk ishte e mundur të kryhej për shkak se shumë nga përfituesit ndodheshin jashtë vendit, fakt që subjekti e identifikon si një arsye që solli zgjatjen tjetër të afatit të hetimit të procedimit penal nr. {\*\*\*/2017, me vendimin përkatës të datës 31.01.2018. Në vijim, zgjatja e radhës së afatit të hetimeve, është bërë nga subjekti më datë 02.05.2018, për shkak se nuk ishin administruar ende rezultatet e aktit të ekspertimit grafik krahasues në këtë

rast, të nënshtrimit të shtetasit V. Q. në disa akte noteriale, të kërkuar nga subjekti me vendimin përkatës të datës 27.02.2018. Akti i ekspertimit grafik, sipas shpjegimeve të subjektit, është i datës 23.05.2018

iii. Pasi provat e administruara ishin të plota, më datë 26.06.2018, subjekti ka ngritur akuzë ndaj shtetasve Ll. Zh. dhe Th. K. Subjekti pretendon se të pandehurit, pasi janë njohur me akuzat, kanë paraqitur kërkesë për t'u njohur me provat dhe për t'i marrë ato. Në ankim, subjekti thekson se është pikërisht respektimi i të drejtave të të pandehurve për të marrë aktet e fashikullit të procedimit penal që u njihet nga ligji procedural penal, rrethana e cila nuk ka mundësuar përfundimin në kohë të hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, së cilës iu bashkua edhe fakti se muaji gusht ishte koha kur stafi prokurorisë ishte me leje vjetore, si një arsye që shtyu subjektin që më datë 02.08.2018, të marrë vendimin tjetër për zgjatjen e katërt të afatit të hetimit për këtë procedim.

iv. Rrethanat e përshkuara më sipër, sipas subjektit, tregojnë se: (i) zgjatja e afatit të hetimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017 është bërë gjithmonë për arsye objektive, të pavarura nga vullneti i subjektit; (ii) pas marrjes së çdo vendimi për zgjatje të afatit të hetimit, rezulton që prej subjektit të rivlerësimit të jenë kryer veprime konkrete hetimore dhe procedurale të nevojshme për realizimin e hetimeve sa më të plota. Pasi janë njoftuar të pandehurit, si dhe pala e dëmtuar V. Q., lidhur me vendimin e datës 02.08.2018, *për zgjatjen e afatit të hetimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017*, ky i fundit e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, e cila, me anë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 20.09.2018, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës ankimore të viktimës V. Q. Detyrimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë të kryejë përfundimin e veprimeve hetimore dhe të njoftojë palët [...] jo më vonë se 5 ditë nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi: Të ndjekë procedurat duke respektuar afatet e parashikuara nga paragrafët 4, 5 dhe 6 të nenit 327 të K.Pr.Penale*. Subjekti referon se, duke marrë në konsideratë qëllimin final për realizimin e një procedimi sa më objektiv, transparent dhe efektiv, ai nuk ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës nr. {\*\*\*}, datë 20.09.2018, duke passjellë marrjen formë të prerë të këtij vendimi më datë 11.10.2018, kohë gjatë së cilës të pandehurit ishin njoftuar për përfundimin e hetimeve dhe kishin marrë aktet e fashikullit. Mbështetur në këto të dhëna, subjekti pretendon se nuk provohet se për këtë procedim penal, përfundimi i hetimeve është bërë kur është urdhëruar nga gjykata pasi, sipas subjektit, pikërisht shtyrja e fundit e hetimeve është bërë jo për të kryer veprime hetimore, por për të garantuar të drejtat procedurale të palëve të paditura.

25.3. Gjithashtu, subjekti kundërshton si të padrejtë edhe konkluzionin e Komisionit në lidhje me njoftimin e të pandehurit Th. K. me aktet, pa njoftuar përfundimin e hetimeve, duke pretenduar se, pasi më datë 26.06.2018, subjekti ka ngritur akuzën ndaj të pandehurit Th. K., për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, kjo akuzë i është njoftuar të pandehurit më datë 04.07.2018. Nëpërmjet kërkesës së datës 10.07.2018, i pandehuri Th. K. ka kërkuar vënien në dispozicion të akteve të fashikullit të procedimit penal dhe organi procedues i ka kërkuar të specifikojë aktet konkrete që kërkonte t'i viheshin në dispozicion. Në vijim, i pandehuri Th. K., nëpërmjet kërkesës së datës 23.07.2018, ka kërkuar vënien në dispozicion të akteve që lidheshin me akuzën e ngritur ndaj tij. Subjekti pretendon

se, duke marrë në konsideratë gjendjen e procedimit penal, si dhe normat procedurale të parashikuara në nenet 1, 34/a/1, 39 dhe 105/1 të Kodit të Procedurës Penale, cituar më sipër, pranimi i një kërkimi të kësaj natyre është vlerësuar dhe vlerësohet se ka qenë në përputhje edhe me qasjen ligjore që organi procedues duhet të ketë karshi respektimit të të drejtave legjitime të të pandehurit. Sipas subjektit, aplikimi i nenit 234 dhe nenit 237/3 të Kodit të Procedurës Penale normojnë veprimtarinë e organit procedues *në momentin e përfundimit të hetimeve* dhe nuk rregullojnë veprimtarinë e mëparshme procedurale, sikundër është njohja e të pandehurit me “materialet e çështjes”, në kuadër të përmbushjes së të drejtave procedurale të parashikuara nga neni 34/a i Kodit të Procedurës Penale, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Bazuar në këto të dhëna, subjekti pretendon se konstatimi i Komisionit se pa i njoftuar përfundimin e hetimeve të pandehurit Th. K., subjekti i ka vënë atij në dispozicion kopje të akteve të hetimeve paraprake, në kundërshtim me nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, është një konkluzion që nuk bazohet në norma procedurale penale dhe që nuk përputhet me veprimet e kryera në këtë procedim penal.

25.4. Lidhur me konkluzionin e Komisionit për zvarritje pa arsye të hetimit të çështjes, subjekti pretendon se nuk qëndron pasi: në çdo rast ka argumentuar domosdoshmërinë për zgjatjen e afatit të hetimeve për të cilat ka nxjerrë vendimet përkatëse<sup>55</sup>; pas çdo vendimi për zgjatje afati, subjekti ka kryer veprime konkrete hetimore; ka ndjekur me korrektësi ecurinë procedurale të përfundimit të hetimeve duke u kujdesur për respektimin e të drejtave të çdo subjekti të procedimit penal; ka kryer brenda një afati hetimor të arsyeshëm të gjitha veprimet hetimore për të mundësuar përcjelljen për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*/2017.

25.5. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit si më sipër referuar, në konsideratë të konkluzionit të Komisionit se ai ka zvarritur hetimin e këtij procedimi penal, konstaton se, referuar shpjegimeve që ka dhënë vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se nga data 27.02.2018, kur është bërë bashkimi i procedimit nr. {\*\*\*/2017 me procedimin nr. {\*\*\*/2018, deri më datë 02.05.2018 kur është bërë zgjatja e tretë e hetimeve, subjekti ka pritur rezultatet e aktit të ekspertimit grafik të nënshkrimeve të kallëzuesit V. Q.<sup>56</sup>, për realizimin e të cilit ai nuk ka shpjeguar nëse ka ndërmarrë ndonjë veprim për të ndihmuar apo përshpejtuar kryerjen prej ekspertëve të këtij akteksptimi.

25.6. Gjithashtu, konstatohet se për pjesën e procedimit penal nr. {\*\*\*/2017, që ka të bëjë me të pandehurin tjetër Ll. Zh., subjekti nuk jep në ankim asnjë informacion lidhur me kohën kur i ka komunikuar atij akuzën dhe kur ai është njohur dhe ka marrë aktet e hetimit të këtij procedimi penal. Pavarësisht se subjekti pretendon se ai nuk disponon dosjen me aktet e procedimit penal dhe se Kolegji duhej të çelte shqyrtimin gjyqësor për të administruar atë, subjekti përdor në ankimin e tij të dhëna të detajuara për veprimtarinë hetimore të kryer prej tij, që sugjerojnë se ai disponon aktet e hetimit penal, por ka zgjedhur të mos i paraqesë ato as me ankimin dhe as me parashtrimet. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstaton se ndonëse sipas

---

<sup>55</sup> Të datave 31.01.2017; 31.01.2018; 02.05.2018 dhe 02.08.2018.

<sup>56</sup> Sipas përshkrimit të dhënë në vendimin e datës 02.08.2018 “Për zgjatjen e hetimeve”, me motivin për të njohur me provat personat ndaj të cilëve janë ngritur akuzat, i cili gjendet bashkëlidhur denoncimit të shtetasit V. Q., referohet se akteksptimi grafik është i datës 23.05.2018.

vetë shpjegimeve të subjektit në ankim, procedimi penal ndaj shtetasit Ll. Zh., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal (sipas parashikimit të kohës), është regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale në datën 01.02.2017, ai nuk ka dhënë asnjë shpjegim se si dhe pse, ai ka mbajtur nën hetim këtë procedim pa marrë asnjë zgjatje afati, të paktën të deklaruar deri në datën 30.10.2017, kur referohet zgjatja e parë. Kjo e dhënë e munguar tregon se subjekti ose ka marrë edhe zgjatje të tjera afati përpara kësaj date, të cilat nuk dihet se në çfarë kushtet janë marrë, ose nuk ka marrë aspak vendim për zgjatje afati, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 324 të Kodit Procedurës Penale, i cili përcakton se afati për hetimin paraprak është tre muaj nga dita e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Kjo analizë e trupit gjykues vlen për të mbështetur konkluzionin e Komisionit se hetimi i çështjes është zvarritur edhe përtej katër vendimeve për zgjatje të afatit të hetimeve të marra në analizë.

**25.7.** Përveç sa më sipër, trupi gjykues konstaton se ndonëse në aspektin formal, marrja e vendimeve për zgjatje të afatit të hetimit, të datave 31.10.2017, 31.01.2018 dhe 02.05.2018, duket e justifikuar për shkak të pritjes së akteve të ekspertimit për nënshkrimet grafike dhe vlerës së dëmit të shkaktuar nga mashtrimi, nuk rezulton asnjë veprim aktiv i subjektit për t'i përshpejtuar ato apo edhe për të vendosur që në krye të herës kryerjen e këtyre akteve të rëndësishme për hetimin. Përveç kësaj, rezulton se vendimi për zgjatjen e afatit, i datës 02.05.2018, është marrë pas kalimit të katër muajve nga zgjatja e fundit në datën 31.01.2018, në kundërshtim me nenet 323 e 324 të K.Pr.Penale, duke vënë në rrezik në drejtim të ligjshmërisë edhe veprimtarinë hetimore të kryer prej tij në periudhën njëmuajore 31.04 - 02.05.2018, për të cilën hetimet duket se janë zhvilluar jashtë afatit.

**25.8.** Për sa i përket zgjatjes së fundit të afatit të vendosur në datën 02.08.2018, akt i cili është administruar në fashikull nga denoncuesi V. Q., përveçse i konsideruar si i padrejtë edhe nga kontrolli gjyqësor i kryer mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit, edhe nga analiza që i bën trupi gjykues, nuk konstaton në të asnjë veprim procedural konkret që duhej kryer, por vetëm një përshkrim të përgjithshëm se afati i hetimit zgjatej edhe tre muaj për të plotësuar kërkesat e palëve për prova të reja, pa cituar konkretisht se cilat ishin ato. Në këtë kontekst, merr peshë të posaçme analiza që bën gjykata që ka kontrolluar këtë vendim, e cila me të drejtë referon përcaktimet ligjore që detyrojnë prokurorin të plotësojë kërkesat e palëve për prova, pasi ai i ka njoftuar ato me përfundimin e hetimeve, në përputhje me nenin 327 të K.Pr.Penale, ndërsa në rastin konkret, zgjatja e afatit në datën 02.08.2018, e bërë për këtë qëllim, është marrë para se të merret vendimi për përfundimin e hetimeve, në kundërshtim me parashikimet e kësaj dispozite. Në këtë kuptim, edhe për trupin gjykues, ky vendim ka synuar zvarritjen pa arsye të hetimit të çështjes prej subjektit, e cila është ndërprerë vetëm për shkak të ndërhyrjes së gjykatës. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur pa arsye të justifikuar hetimin e këtij procedimi penal, në këndvështrim të indikatorëve të parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, situatë e cila vlerësohet në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**25.9.** Lidhur me konkluzionin se subjekti ka shkelur ligjin duke njohur të pandehurin Th. K. me aktet pa përfunduar hetimet paraprake dhe në kundërshtim me nenin 327 të K.Pr.Penale, trupi gjykues ndan qëndrim të ndryshëm. Në vlerësimin e trupit gjykues, prokurori i çështjes

administron në funksion të ruajtjes dhe sigurisë së sekretit hetimor, njohjen e të pandehurit me aktet e dosjes, duke pasur në pikën fundore detyrimin për ta njohur atë me to, pas përfundimit të hetimeve paraprake, në zbatim të nenit 327 të K.Pr.Penale. Ky detyrim i prokurorit, për njohjen me aktet e hetimit në përfundim të tij, nuk përjashton apriori të drejtën e palëve, në këtë rast të të pandehurit, për t'u njohur me to ose me një pjesë të tyre, në një fazë tjetër të hetimit, nëse prokurori e vlerëson këtë njohje të padëmshme për hetimin. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me kryerjen e këtij veprimi, ka përdorur diskrecionin e tij, në përputhje me parashikimin e nenit 279 të K.Pr.Penale dhe e gjen të padrejtë konkluzionin e Komisionit lidhur më këtë çështje.

26. *Lidhur me denoncimin e z. S. D., që i adresohet procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018 dhe nr. {\*\*\*}/2018, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstatoi sa vijon.*

26.1. Nga të dhënat e fashikullit të Komisionit tek i cili janë administruar fashikujt penalë të Prokurorisë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Sarandë, konstatohet se denoncuesi S. D., në denoncimet e paraqitura, referon dy kallëzime penale<sup>57</sup> të trajtuara nga prokurori Ilir Hoxha, për të cilat ankohet për shkelje të procedurës penale, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e duhura për të verifikuar dy kallëzimet e paraqitura prej tij, si edhe nuk i ka dhënë informacion dhe përgjigje për mënyrën e zgjidhjes së tyre, të cilat në thelb paraqisnin të njëjtin shqetësim, që lidhej me konsumimin e ujit të papijshëm në banesën e tij, për shkak të ndotjes së lartë.

26.2. Në vendimin e Komisionit lidhur me denoncimin e shtetasit S. D., është analizuar dhe konkluduar se, pas analizës së prapësimeve të subjektit dhe përmbajtjes së vendimeve të gjykatës në të dyja shkallët, që kanë kontrolluar vendimin e mosfillimit të subjektit për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018, ka rezultuar se subjekti, në rolin e prokurorit të ngarkuar me trajtimin e çështjes, nuk ka kryer veprimet e duhura për hetimin e vërtetësisë së faktit të pretenduar në kallëzim. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka dhënë shpjegime se cili ka qenë fati i procedimit penal edhe pas dhënies së vendimit, datë 01.10.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka prishur vendimin e mosfillimit të prokurorit. Komisioni ka gjetur pa relevancë pretendimin e subjektit se ai është mbështetur në vendimin unifikues nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për orientim në trajtimin e këtij materiali kallëzues, i cili, sipas Komisionit, kishte specifikat e tij, të cilat duhej të verifikoheshin në mënyrën e duhur. Sa i përket materialit kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2018, Komisioni, pas verifikimit të vendimit të mosfillimit të hetimeve të datës 03.12.2018, ka konstatuar se ai nuk i është komunikuar kallëzuesit në përputhje me dispozitat procedurale. *Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se për këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njoftimi i vendimmarrjes së prokurorit, si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore, duket se është cenuar.*

26.3. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, në lidhje me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018, përveç pretendimit se procedimi penal nr. {\*\*\*}/2019, i regjistruar për të pas

<sup>57</sup> *Materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2018, si dhe materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018.*

vendimit të gjykatës të cituar më sipër, është ende në fazën e hetimit paraprak, pretendim i cili konsiderohet i trajtuar në vlerësimin e përgjithshëm, bërë për shkaqe ankimi të kësaj natyre, pretendon gjithashtu se: **(i)** shqyrtimi i këtij materiali kallëzues është bërë dhe vlerësuar duke aplikuar orientimet unifikuese të dhëna në vendimin nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>58</sup>, lidhur me vendimin për mosfillim të procedimit penal apo të mosregjistrimit të procedimit penal; **(ii)** kur ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, *së pari* ka vlerësuar nëse ky vendim mund të merret duke u bazuar në të dhënat/informacionin që japin aktet e administruara, të cilat në rastin konkret e lejonin këtë gjë, duke parashtruar se *për prokurorin nuk është e detyrueshme kryerja e veprimeve hetimore*. Në rastin konkret, subjekti pretendon se aktet e sjella nga kallëzuesi S. D. së bashku me kallëzimin, siç janë dokumenti fletë analize nr. {\*\*\*}, datë 14.11.2018, i Drejtorisë së Shëndetit Publik Sarandë, e cila tregon se uji në cisternën e pallatit nuk përmbush kushtet higjieno-sanitare dhe se është i papërshtatshëm për përdorim, të analizuara së bashku me përcaktimet e ligjit nr. 7643, datë 02.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, si dhe ligjin nr. 10112, datë 09.04.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, i ka konsideruar të mjaftueshme për të vlerësuar materialin kallëzues, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal për të; **(iii)** vendimi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 28.05.2019, që ka prishur vendimin e subjektit “Për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018”, si dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër i datës 27.12.2018, që e ka lënë në fuqi atë, për të cilat subjekti pretendon se janë vendime të marra nën trysinë e ushtruar nga ankuesi S. D., dhe jo se subjekti ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e çështjes; **(iv)** nuk është përgjegjësi e subjektit mosnjoftimi i kallëzuesit lidhur me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2018”, pasi përgjegjëse për njoftimet, ashtu siç përcaktohet edhe në pikën 2 të këtij urdhri, është zyra e sekretarisë pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; **(v)** po ashtu, nuk ka qenë përgjegjësi e tij ndjekja e zbatimit të urdhrin për njoftimin e palëve.

**26.4.** Trupi gjykues, për t’u dhënë përgjigje pretendimeve të mësipërme të subjektit, analizoi të dhënat e akteve të fashikullit të Komisionit, prej të cilave konstatoi sa vijon.

**26.4.1.** Denoncuesi S. D. ka paraqitur dy kallëzime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të regjistruara me nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2018 dhe nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018. Nga përmbajtja e denoncimit të parë të bërë prej tij në datën 20.11.2018, rezulton se ai ka paraqitur në prokurori pretendime që lidhen me pasjen në banesën e tij të ujit me një ndotje të lartë, në nivelin 16m/si, e cila, sipas tij, është shkaktuar si pasojë e kryerjes pa cilësi të punimeve prej sipërmarrësit të objektit, z. A. C., në shkëlqe të projektit dhe kushteve teknike, pasi ai nuk e ka ndërtuar depozitën e ujit në katin përdhe të banesës, por ka vendosur një depozitë uji në tarracën e objektit, e cila, sipas deklarimeve të kallëzuesit, është e paaksesueshme për t’i bërë shërbimet e mirëmbajtjes, pastrimit e dezinfektimit. Këto shkëlqe, sipas kallëzuesit, janë bërë të mundura edhe nga lejimi i organeve shtetërore të cilat kanë heshtur dhe kanë lejuar ndërtuesin të vendosë depon për ujin e pijshëm në kundërshtim me kondicionet e lejes së ndërtimit, si edhe ato të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi.

---

<sup>58</sup> Shih: <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/vendime-unifikuese-ne-vite>.

26.4.2. Nga përmbajtja e denoncimit të dytë, të paraqitur në datën 04.12.2018 para oficerit të policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Sarandë e të referuar e regjistruar në prokurori në datën 19.12.2018, sipas përmbajtjes së vendimit të mosfillimit të këtij procedimi, marrë prej subjektit të rivlerësimit në datën 27.12.2018, rezulton se z. Q. denoncon për herë të dytë mosndërrhyrjen e organeve shtetërore për zgjidhjen e problemit të ujit të pijshëm në banesën e tij, por edhe në të gjithë pallatin, edhe pas ankesave që ai i ka bërë Drejtorisë Ujësjetllës Kanalizime Sarandë dhe Bashkisë Sarandë, pas marrjes së konfirmimit për ndotjen e ujit në nivel të lartë, që e bën atë të papijshëm, nga analizat e kryera prej Drejtorisë së Shëndetit Publik Sarandë.

26.5. Nisur nga këto të dhëna, trupi gjykues konstaton se nga përmbajtja e të dy denoncimeve që janë trajtuar nga i njëjti prokuror, rezulton se problematika e krijuar me cilësinë e ujit të pijshëm në banesën e denoncuesit, z. S. D., lidhet me disa probleme që evidentohen në to, që ngrihen si mbi faktin se depoja e ujit është e paaksesueshme dhe e hapur, duke krijuar premisa për ndotjen, por edhe mbi faktin e pretenduar se vendosja e saj mbi tarracë, është bërë në shkelje të kondicioneve të lejes së ndërtimit dhe atyre urbane të parashikuara nga ligji. Në këto kushte, kuptohet se fakti i ndotjes së ujit i cili është i provuar nga analizat biologjike të realizuara nga organet kompetente shtetërore, është derivat/pasojë e vendosjes së një depozite kundër të gjitha standardeve të parashikuara, në tarracën e objektit nga ndërtuesi i godinës dhe jo nga banorët e pallatit. Nga këto të dhëna të evidentuara në denoncime, duket se ekzistojnë mjaftueshëm indicie për të merituar një vlerësim më të thelluar të prokurorit, rreth vërtetësisë së fakteve të pretenduara dhe kërkimit të përgjegjësisë penale, nëse ajo do të rezultonte se ekzistonte pas kryerjes së veprimtarisë hetimore.

26.6. Nga ky këndvështrim, trupi gjykues vlerëson se analiza ligjore që subjekti ka bërë në vendimin e tij të mosfillimit, është shtrirë vetëm në planin teorik, duke anashkaluar rrethanat faktike që përcillen me kallëzimet. Qëndrimi i mbajtur, se nga përdorimi i ujit të ndotur si i pijshëm, nuk janë krijuar fatalitete apo dëmtime të dukshme të shëndetit, nuk vlerësohet i arsyeshëm për të ndaluar/kufizuar veprimtarinë hetimore, për sa kohë që edhe shkelja e dispozitave të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar<sup>59</sup> dhe e akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij, në kuadër të veprimtarisë së autoriteteve shtetërore apo subjekteve private, mund të ishin objekt i kësaj veprimtarie edhe në mungesën e pasjes së një pasoje të drejtpërdrejtë në shëndetin e individëve, por për sa kohë që konstatohej ndotja në nivele shqetësuese e ujit të pijshëm, një produkt jetik për jetën e

---

<sup>59</sup> Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 107/2014, është shfuqizuar ligji nr. 10 119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në ligjin nr. 107/2014, i ndryshuar, në nenin 3, “Përkufizime”, përcaktohet se:

“22. “Ndërtim në shkelje të lejes” janë punime dhe/ose ndërtime të kryera në shkelje të kushteve dhe kritereve teknike dhe/ose ligjore të lejes, pavarësisht krijimit të shtesave dhe volumeve në ndërtim [...]

37. “Rregullore ndërtimi” është rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton normat dhe kushtet teknike bazë të detyrueshme për garantimin e qëndrueshmërisë së strukturave, hapësirave të emergjencës, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës, në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve, si dhe për përshtatjen e hapësirave për përdorimin nga persona me aftësi të kufizuara. Rregullorja bazohet në standardet ndërkombëtare dhe përfshin norma teknike të përshtatura për Shqipërinë”.

banorëve. Orientimi i problematikës në këtë drejtim, do të zbehte argumentet që ka përdorur subjekti rreth ligjit që rregullon bashkëpronësinë e detyrueshme, si një kuadër ligjor i zbatueshëm për të zgjidhur problematikën e shtruar, për sa kohë që vendosja e depos së ujit në një pozicion që lejon ndotjen dhe kufizon pastrimin, referohet se nuk është bërë për shkak të vullnetit të përbashkët të banorëve dhe zbatimit të parashikimeve të këtij ligji. Qëndrimi i subjektit se inspektimi i cilësisë së ujit është një çështje administrative që i përket inspektoratit shëndetësor, nuk mund të jetë një argument që ndalon hetimin penal, për sa kohë që faktet që janë përcjellë me denoncimin, nuk ngrenë problematika vetëm në këtë drejtim, por edhe për arsye të tjerë që e kanë shkaktuar ndotjen dhe pasojën që ajo mund të sjellë në shëndetin e individëve.

26.7. Trupi gjykues vlerëson se edhe pretendimi se analiza e bërë prej subjektit bazohet në orientimet që ka dhënë vendimi unifikues nr. 2/2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është po ashtu një justifikim në nivel teorik, por i palidhur me rastin konkret. Situata konkrete kërkonte, sipas vlerësimit të trupit gjykues, por edhe të gjykatës që ka kontrolluar këtë vendim të prokurorit, që ai të kryente veprime hetimore për të arritur në konkluzionet e duhura dhe për të përcaktuar drejt përgjegjësinë penale në rrethanat e faktit të referuar. Vetëm trajtimi teorik i veprimtarisë verifikuese, nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se në çdo rast, ajo duhet aplikuar si e tillë. Në këtë kuptim, referimi të vendimi unifikues nuk u jep përgjigje konkluzioneve të arritura nga Komisioni dhe as zgjidhjes së çështjes.

26.8. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e këtij materiali kallëzues, të cilat janë konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor.

26.9. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë detyrë e tij për të realizuar dhe ndjekur procesin e njoftimit të palëve me vendimin për mosfillim të procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2018, të marrë nga subjekti më datë 03.12.2018, trupi gjykues, nga analizimi i akteve, konstaton sa vijon: **(i)** Në vendimin për mosfillim të procedimit penal, në pikën 3 të tij, subjekti ka urdhëruar që: *për ekzekutimin e urdhërimit në pikën nr. 2, ngarkohet zyra e sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.* **(ii)** Në ankim, subjekti ka referuar aktet ligjore dhe nënligjore, si ligjin nr. 97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë”, lidhur me strukturën e këtij organi, sipas të cilit, në nenin 57, pika 1/c parashikon se: *shërbimet mbështetëse që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimit të njoftimeve [...], si dhe nenin 59, pika 2 e këtij ligji, të emërtuar “Sekretaria e Prokurorisë”, ku parashikohet se detyrat e saj përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjithashtu, subjekti referon udhëzimin e përgjithshëm dhe detyrues nr. 1, datë 06.02.2017, të nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë Sarandë më datë 06.02.2017, me të cilin miratohet rregullorja e kësaj prokurorie, në të cilën, ndër të tjera, në nenin 27, parashikohet se: [...] Sekretari përgjegjës për mbajtjen e protokollit kryen procedurat për realizimin e njoftimit të pushimit dhe vendimit të mosfillimit, sipas destinacionit të përcaktuar në shkresën përcjellëse të vendimit të firmosur nga drejtuesi i prokurorisë.* Nisur nga këto parashikime të akteve nënligjore, konstatohet se pretendimi i subjektit se njoftimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk ka qenë detyrë e tij, është i argumentuar, por nga ana tjetër, në referim të përcaktimeve të nenit 24, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin, ndër të tjera, parashikohet se prokurori i çështjes *mbikëqyr*

*ekzekutimin e vendimeve, ku si i tillë është edhe vendimi i datës 03.12.2018, për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të z. S. D., trupi gjykues gjithashtu vlerëson se subjekti nuk shkarkohet plotësisht nga përgjegjësia për mosnjohimin e këtij vendimi. Për më tepër që nga aktet në dosje, rezulton se denoncuesi është paraqitur me kërkesa zyrtare në prokurori<sup>60</sup>, për marrjen e informacionit dhe vendimeve respektive për zgjidhjen e kallëzimeve të tij, situatë që duhet të kishte ndërgjegjësuar dhe vënë në lëvizje subjektin për verifikimin e pretendimeve të denoncuesit lidhur me njohimin e vendimit.*

**26.10.** Në këto kushte, trupi gjykues, edhe për sa i përket këtij elementi të denoncimit të shtetasit S. D., vlerëson se konkluzioni i vendimit të Komisionit se *subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njohimi i vendimmarrjes së prokurorit, si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore, duket se është cenuar, është një konkluzion i drejtë dhe i argumentuar.*

**27.** *Lidhur me denoncimin e z. A. B. që i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

**27.1.** Në vendimin e Komisionit lidhur me këtë denoncim, është analizuar dhe konkluduar se: *Komisioni konstaton mangësi dhe zvarritje të veprimeve hetimore nga momenti i dhënies së vendimit gjyqësor datë 14.6.2019 deri më 19.2.2020, kur gjykata është shprehur për plotësimin e aktit të ekspertimit e, më pas, nga ky moment deri në datën 17.2.2021, ku sërish gjykata është shprehur për plotësimin e hetimeve brenda afatit 5-mujor. Lidhur me afatin 5-mujor të përcaktuar nga gjykata për kryerjen e hetimeve, Komisioni vlerëson se edhe nëse konsiderohet fakti se dosja është marrë nga subjekti në dhjetor të vitit 2022, sërish evidentohen vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore prej 9 muajsh, nga data 22.12.2022 deri më 18.9.2023, kur subjekti ka kërkuar sërish pushimin e çështjes. Në përfundim, Komisioni evidenton zvarritje dhe mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga kontrolli gjyqësor, që e ka urdhëruar dy herë prokurorin për plotësim të hetimeve.*

**27.2.** Subjekti ka ngritur pretendimet se kjo çështje është hetuar fillimisht nga një prokuror tjetër dhe se prej tij është marrë për hetim më datë 11.09.2019, dhe pas marrjes në dorëzim të çështjes, ai ka kryer të gjitha hetimet e kërkuara në zbatim të një vendimi të mëparshëm të gjyqtarit të seancës paraprake<sup>61</sup>, dhe sërish e ka përcjellë çështjen për pushim pranë tij. Subjekti pretendon se nga momenti kur ka marrë në dorëzim këtë procedim penal, pra nga data 11.09.2019 deri më datë 17.02.2021, ka realizuar të gjitha veprimet hetimore të kërkuara nga gjyqtari i seancës paraprake dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit se ka mangësi dhe zvarritje të hetimeve nuk qëndron. Gjithashtu, subjekti referon se prej tij është ankimuar vendimi i datës 17.02.2021 të gjyqtarit të seancës paraprake në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë,

---

<sup>60</sup> Kërkesat e datës 31.01.2019 dhe datës 08.03.2019.

<sup>61</sup> Subjekti evidenton se nga momenti kur ka marrë në dorëzim këtë procedim penal, pra nga data 11.09.2019 deri më 17.02.2021, ka realizuar të gjitha veprimet hetimore të kërkuara nga gjyqtari i seancës paraprake dhe pretendon se, bazuar në të dhënat e dala nga hetimi, konkluzioni i vendimit të Komisionit se ka mangësi dhe zvarritje të hetimeve, nuk qëndron.

e cila, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.05.2022, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit penal të datës 17.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për plotësim hetimesh”. Ky vendim i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër është vënë në dispozicion të prokurorit/subjektit nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Subjekti shpjegon se nga studimi i fashikullit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, i vitit 2017, rezultoi se ai ishte i mangët pasi nuk i ishin vënë në dispozicion aktet shkresore dhe provat që nga prokurori i ishin paraqitur gjyqtarit të seancës paraprake, të domosdoshme për ecurinë e mëtejshme të hetimit. Në këto kushte, duke qëndruar në pritje të këtyre provave, për të cilat ishte konfirmuar se mungesa rezultonte për shkak të një gabimi njerëzor nga ana e sekretarisë gjyqësore, në mungesë të paraqitjes së tyre, i është drejtuar shkresërisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila në vijim i ka vënë në dispozicion këto prova. Subjekti parashtron se nuk është në gjendje të specifikojë ekzaktësisht shkresën e prokurorisë apo atë të gjykatës, me të cilën këto prova janë përcjellë, por si periudhë mund të ketë qenë në ditët e para të muajit mars 2023<sup>62</sup>.

27.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, nga momenti kur i ka kaluar për ndjekje procedimi penal nr. {\*\*\*}/2017, pra nga 11.09.2019<sup>63</sup> deri në datën 17.02.2020, kur është disponuar me vendim nga gjyqtari i seancës paraprake, ka kryer një sërë veprimesh hetimore që kanë të bëjnë me kryerjen e riekspertimit auto-teknik, si dhe përsëritje të eksperimentit hetimor. Nga këto të dhëna, rezulton se subjekti është përpjekur të ndjekë kërkesat për hetime të gjyqtarit të seancës paraprake (vendimit të mëparshëm të datës 14.06.2019), dhe se njëfarë vonese në ecurinë e këtij procedimi penal është shkaktuar nga mospërcjellja/kthimi i dosjes së plotë gjyqësore pas gjykimit të saj në apel më datë 25.05.2022. Të dhënat e marra nga fashikulli i Komisionit referojnë<sup>64</sup> se, bazuar në kërkesën e subjektit me objekt “Për kërkim prove dhe shkresa të procedimit penal”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, më datë 01.03.2023, këto kopje i janë vënë në dispozicion prokurorisë së këtij rrethi më datë 03.04.2023. Në këto kushte, në referim të shpjegimeve që subjekti ka dhënë në ankim<sup>65</sup>, konkluzioni i Komisionit se, nëse konsiderohet që dosja është marrë nga subjekti në dhjetor 2022, fakti që subjekti vetëm më datë 18.09.2023, ka kërkuar pushimin e çështjes së procedimit penal, tregon vonesë prej 9 muajsh në hetimin e saj, nuk është i mbështetur në një

---

<sup>62</sup> Nga analizimi i të dhënave të fashikullit të Komisionit, konstaton se gjendet e administruar shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me të cilën i bën me dije se lidhur me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 01.03.2023, “Për kërkim prova dhe shkresa të procedimit penal”, ju dërgojmë kopje të akteve të administruara në fashikullin gjyqësor që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 25.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

<sup>63</sup> Në fashikullin e Komisionit nuk ka të dhëna të sakta që provojnë momentin kur subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha ka zëvendësuar prokurorin e mëparshëm të kësaj çështjeje S. H.

<sup>64</sup> Përkatësisht në shkresën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të datës 03.04.2023, të drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

<sup>65</sup> Për këtë procedim penal, rezulton se element kryesor i hetimit janë aktet e ekspertimit auto-teknik, të cilat, nga informacioni që jep shkresa e datës 03.04.2023, duket se subjekti ia ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që t’i përcillen kopjet e akteve që i janë vënë në dispozicion gjyqtarit të seancës paraprake me qëllim riekspertimin auto-teknik të mjetit të përfshirë në ngjarje për pjesët që gjykata evidenton se kanë ngelur të pahetuara.

analizë të plotë të të dhënave që u referuan më lart. Këto të dhëna tregojnë që vonesa në përfundimin e hetimeve nuk është shkaktuar nga sjella e subjektit, por nga faktorë që nuk vareshin prej tij, ndërsa rezulton se ai ka treguar dilijencën e duhur për të vijuar me zhvillimin e hetimit në një afat të arsyeshëm.

27.4. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues i konsideroi të drejta dhe të argumentuara pretendimet e subjekti të rivlerësimit lidhur me këtë çështje dhe nuk konstatoi problematika të vlerësueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

28. *Lidhur me denoncimin e z. M. A., i cili i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

28.1. Sipas vendimit të Komisionit lidhur me këtë çështje, rezulton se denoncuesi ka depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, i trajtuar prej subjektit të rivlerësimit me cilësinë e prokurorit. Sipas kallëzimit të kryer ndaj shtetases V. T., punonjëse e ASHK-së Sarandë, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, denoncuesi pretendon se janë kryer disa veprimeve nga punonjës të ish-ZVRPP-së, të cilët nuk kanë regjistruar një dëshmi trashëgimie, por kanë ekzekutuar një testament për trashëgimlënësin e denoncuesit dhe, për rrjedhojë, në datën 20.11.2018 ky institucion ka lëshuar certifikatat e pronësisë në favor të trashëgimtarëve testamentarë, duke tjetërsuar pasurinë e denoncuesit në favor të personave të tjerë. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit lidhur me këtë kallëzim, me arsyetimin se regjistruesi i kohës, i ndjeri A. H., kishte ndërruar jetë e, për pasojë, kjo rrethanë nuk lejonte nisjen e procedimit penal. Ky vendim i subjektit është prishur nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër mbi ankimin e denoncuesit dhe është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore për zbardhjen e saj.

28.2. Komisioni, pasi ka shqyrtuar pretendimet e denoncuesit dhe konsideruar edhe shpjegimet e subjektit lidhur me këtë çështje, ka konkluduar se: *hetimet e kryera nga subjekti nuk kanë qenë shteruese, e konfirmuar kjo edhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, e cila me vendimin e datës 23.6.2020, ndër të tjera, ka evidentuar se regjistrimi i pronës është kryer para se të ndërronte jetë regjistruesi, i ndjeri A. H. dhe, në vijimësi, janë veprimet e punonjësës V. T., ato që i kanë shkaktuar dëm ekonomik kallëzuesit, pasi pjesën e tij të tokës në bashkëpronësi të trashëguar nga nëna ia kanë grabitur, duke e regjistruar në emër të personave të tjerë. Referuar vendimit gjyqësor ku konstatohet fakti se regjistrimi i pasurive ishte kryer në kundërshtim me ligjin dhe kishte të dhëna për ekzistencën e kryerjes së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, Komisioni çmon se këto veprime duhej të ishin hetuar nga prokurori. Në prapësime, subjekti ka pohuar se kjo çështje penale aktualisht është nën hetim paraprak, fakt i cili konfirmon se çështja është zvarritur për të paktën 3 vjet, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal në datë 4.11.2020 dhe të paktën deri në datën 30.09.2023, kur subjekti është transferuar në një prokurori tjetër. Në përfundim, Komisioni evidenton zvarritje në hetimin e çështjes nga ana e subjektit të rivlerësimit, të cilat përbëjnë mangësi profesionale referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 73 të ligjit 96/2016, i ndryshuar.*

28.3. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2020<sup>66</sup>, kundërshton qëndrimin e mësipërm të Komisionit, duke sjellë sërish në vëmendje faktin se kjo çështje është ende në fazën e hetimit paraprak<sup>67</sup> e, për pasojë, gjen zbatim kufizimi i nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pretendim i konsideruar i shtjelluar në pjesën hyrëse të vendimit, si dhe jep shpjegimet si vijojnë.

28.3.1. Pasi ka marrë në shqyrtim kallëzimin penal të shtetasit M. A., ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistonin rrethana që nuk lejonin fillimin e ndjekjes penale, ndaj në datën 05.11.2019, ka vendosur: "Mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2019". Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim shtetasi M. A., i cili është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, por është pranuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila, nëpërmjet vendimit nr. {\*\*\*}, datë 23.06.2020, ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 10.02.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë" dhe, për rrjedhojë, më datë 04.11.2020, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}/2020. Subjekti shpjegon se edhe më datë 11.11.2020, nëpërmjet aktit përkatës, kryerja e veprimeve hetimore i është deleguar Oficerit të Policisë Gjyqësore A. Sh., prej të cilit nuk është bërë i mundur përfundimi i tyre, deri në momentin e transferimit të oficerit në një prokurori tjetër. Në të tilla kushte, procedimi penal nr. {\*\*\*}/2020 ka mbetur në fazën e hetimit paraprak.

28.3.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *konkluzioni i Komisionit se ka zvarritur hetimet për 3 vjet*, nuk ka marrë në konsideratë gjendjen në të cilën është gjetur përgjatë viteve 2020 – 2023, trupa e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila ka pasur mangësi të theksuara, duke pasjellë ngarkesë mbi normat për subjektin e rivlerësimit, dhe njëkohësisht ka ndikuar në zvarritjen e hetimeve dhe veprimeve procedurale për disa çështje.

28.4. Nga të dhënat që rezultojnë nga aktet që denoncuesi M. A. ka paraqitur në Komision, konstatohet si vijon.

28.4.1. Denoncuesi ka paraqitur kallëzim në prokurori për shkak se ka konstatuar se nga ZRVPP Sarandë, në zbatim të dëshmisë së trashëgimisë testamentare nr. {\*\*\*}, datë 28.10.2015, është lëshuar vërtetim pronësie me nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, më datë 18.11.2018, në favor të znj. M. A., pa u kryer asnjë verifikim dhe pa marrë në konsideratë faktin se kjo sipërfaqe toke e fituar nëpërmjet ligjit nr. 7501 të vitit 1991, ishte regjistruar në emër të anëtarëve të familjes, dhe nuk mund të tjetërsohej kjo bashkëpronësi duke i kaluar e gjitha trashëgimtares testamentare. Denoncuesi, për kryerjen e këtij veprimi të paligjshëm si shpërdorim i detyrës, ka identifikuar punonjësen e ZRVPP-së, e cila është marrë me shqyrtimin e praktikës, znj. V. T.. Nga të dhënat e fashikullit të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nisur nga fakti se certifikatat e pronësisë me të cilat është bërë tjetërsimi i pasurisë së familjes bujqësore<sup>68</sup>, janë lëshuar më datë 20.11.2018, ka vlerësuar se për sa, në zbatim të përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr. 33/2012, lëshimi i certifikatave të pronësisë është

---

<sup>66</sup> Në citimin që bën subjekti në ankim, ka një lapsus për numrin e procedimit, nga {\*\*\*} në {\*\*\*}.

<sup>67</sup> Çështja penale ndodhej në fazën e hetimit paraprak në kohën e shqyrtimit të çështjes në Komision, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nga një prokuror tjetër.

<sup>68</sup> Pasuri që kanë të dhënat nr. {\*\*\*} në zonën kadastrale {\*\*\*}, e llojit "arë", me sip. 570 m<sup>2</sup> dhe me nr. {\*\*\*} në zonën kadastrale {\*\*\*}, e llojit po "arë", me sipërfaqe 4.230 m<sup>2</sup>.

kompetencë e drejtuesit të ZRVPP-së dhe ka konstatuar se në atë kohë si drejtues i ZRVPP Sarandë ka qenë z. A. H., i cili ka ndërruar jetë më datë 26.02.2019, në aplikim të nenit 290, pika 1/a e K.Pr.Penale, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal” për materialin kallëzues nr. {\*\*\*} të datës 21.10.2019.

**28.4.2.** Gjykata e Apelit Gjirokastrë, në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 23.06.2020, vendim i marrë mbi ankimin e denoncuesit, ka analizuar se nuk është i drejtë vendimi për mosfillim të procedimit penal, pasi nuk mund të thuhet se mungojnë elementet e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa u kryer hetime se kush i ka kryer këto veprime, nëse ato përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës të kryer me dashje dhe nëse janë dëmtuar interesat e kallëzuesit M. A. Në këtë vendim, evidentohet se në kohën e regjistrimit fillestar të pasurisë, datë 07.10.2017, nuk rezulton që titullari i ZRVPP Sarandë të ketë qenë i ndjeri A. H.

**28.4.3.** Trupi gjykues konstaton se në ankim dhe në parashtrime, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim përse prej tij vendimmarrja për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues {\*\*\*}, datë 21.10.2019, të z. M. A., është bazuar vetëm në momentin kohor të lëshimit të certifikatës së pronësisë, datë 20.11.2018, në të cilën titullari i ZRVPP-së i asaj kohe, kishte ndërruar jetë, dhe ka lënë jashtë analizës momentin e regjistrimit fillestar të pasurisë, i cili ka qenë në vitin 2017. Po ashtu, subjekti nuk jep asnjë shpjegim lidhur me vijimin e hetimeve dhe zgjatjen pa përfundim të tyre për tre vjet, pas dhënies së vendimit më datë 23.04.2020, nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, por mjaftohet duke referuar se me ndjekjen e saj ka ngarkuar OPGJ-në, i cili ka qenë shumë i ngarkuar me punë, dhe më pas se ai vetë është transferuar në një prokurori tjetër.

**28.4.4.** Bazuar në faktet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer në mënyrën e duhur detyrën e tij si prokuror i çështjes, duke anashkaluar në trajtimin e materialit kallëzues elemente të rëndësishme, të cilat duhet ta kishin dërguar atë në nevojën për kryerjen e hetimeve lidhur me të. Argumenti i përdorur prej subjektit e që lidhet me ndërrimin e jetës së regjistruarit të kohës, është krejtësisht sipërfaqësor e në mungesë të vlerësimit, përveçse të kohës së ndodhjes së veprimit të denoncuar, por edhe të përgjegjësive të punonjësve të ZRVPP-së, të cilët kishin si detyra funksionale trajtimin e materialeve të tilla, përpara se titullari të dispononte për regjistrimin e pasurisë. Kjo mënyrë të e vlerësuarit duket se ka shmanjur nga vënia nën përgjegjësi të punonjësve përgjegjës si edhe ka lënë pa asnjë përgjigje kallëzimin në drejtim të personit, të cilit kallëzuesi i atribuon faktin penal.

**28.4.5.** Po ashtu, mbeten të drejta edhe konstatimet e Komisionit se subjekti ka zvarritur për rreth 3 vjet hetimet e kësaj çështjeje, nga momenti i dhënies së vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në datën 23.06.2020. Pretendimet e subjektit se përgjegjësia në këtë rast i takon oficerit të policisë gjyqësore, i cili nuk ka mundur të përfundojë hetimin, është krejt i pavend, për sa kohë që përgjegjësia për hetimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore, është e prokurorit të çështjes, si i vetmi titullar i ushtrimit të ndjekjes penale.

**28.4.6.** Për rrjedhojë, trupi gjykues i konsideron të drejta, të argumentuara dhe të bazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit lidhur me denoncimin e shtetasit M. A. Për pasojë, mangësitë profesionale të subjektit, të shfaqura në trajtimin e tij, bien nën indikatorët e

parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe konsiderohen të vlerësueshme në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

29. Lidhur me denoncimin e z. A. M., që i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*}/2023, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

29.1. Nga vendimi i Komisionit lidhur me denoncimin e z. A. M., rezulton se ai është drejtuar ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili, me cilësinë e prokurorit, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal më datë 4.8.2021, për një kallëzim të depozituar prej denoncuesit, si përfaqësues me prokurë i z. M. M., në ngarkim të shtetasit F. M., për veprat penale “Shkatërrimi i pronës”, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Pushtimi i tokës”. Kallëzuesi pretendon se si pasojë e veprimeve të të kallëzuarit i është cenuar prona e tij në Njësinë Administrative Lukovë, për të cilën është pronar i ligjshëm, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi. Sipas denoncuesit, mbi pronën e tij, kallëzuesi ka kryer punë ndërtimi në mënyrë të kundërligjshme dhe vendimi i prokurorit për mosfillim është jashtë çdo dispozite ligjore, duke i cenuar në mënyrë flagrante pronën e tij, në favor të personave të tjerë, për qëllime përfitimi.

29.2. Pasi Komisioni ka analizuar pretendimet e denoncuesit dhe shpjegimet e subjektit, mbështetur në aktet e administruara, ka konkluduar se *subjekti, në vendimin e tij për mosfillimin e procedimit, datë 9.8.2021, ka kryer një analizë të thelluar të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, si dhe ka analizuar elementet e figurës për të tria veprat penale të pretenduara nga kallëzuesi, por në asnjë pikë të vendimit nuk ka cituar veprimet hetimore të kryera me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, nuk ka një analizë të fakteve që ka rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit dhe as një analizë të tyre në funksion të përcaktimit të faktit penal. Vendimi i prokurorit për të mos filluar procedimin, me arsyetimin se nuk ka ndërtime, meqenëse nuk janë konstatuar të tilla nga inspektoratet, nuk është i dokumentuar nga subjekti. Gjykatat, përmes shfuqizimit të pjesshëm të vendimit të prokurorit dhe urdhërimit për vazhdimin e hetimeve për dy nga veprat penale, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Shkatërrimi i pronës”, ndër të tjera kanë konstatuar se organi i Prokurorisë duhet të kishte kryer këqyrje të pronës, ku pretendohet se janë kryer ndërtime dhe eventualisht, sipas nevojës, të kryejë një akt ekspertimi, nëse nga këqyrja rezultojnë ndërtime të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me tokën dhe përbëjnë ndërtim. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion, i cili provon veprimet hetimore të kryera prej tij për këtë çështje penale. Komisioni konkludon se, nga ana e subjektit, nuk janë ndërmarrë veprime hetimore verifikuese dhe nuk është hetuar për rrethanat e çështjes, me qëllim verifikimin e kushteve për ekzistencën e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi.*

29.3. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë denoncim, kundërshton së pari qëndrimin e mësipërm të Komisioni duke sjellë sërish në vëmendje faktin se kjo çështje është ende në fazën e hetimit paraprak<sup>69</sup> e, për pasojë, gjen zbatim kufizimi i nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pretendim i konsideruar i shtjelluar në pjesën hyrëse të vendimit, si dhe jep shpjegimet si vijon.

---

<sup>69</sup> Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në të cilën subjekti e ka transferuar për shkak të mungesës së kompetencës territoriale.

29.4. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 04.08.2021 të depozituar nga z. A. M., është marrë prej tij si produkt i bindjes së brendshme të krijuar nga analiza e të gjitha provave të administruara si dhe ne zbatim të vendimit unifikues nr. 2/2013 të Gjykatës së Lartë.

Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2/2013 kërkon që në vlerësimin e një materiali kallëzues, prokurori ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e rrethanave të parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, dhe nëse konstatohet ekzistenca e tyre, ai vendos mosfillimin e procedimit penal. Subjekti shprehet se ky vendim unifikues përcakton se në rastin kur vendimi për mosfillim të procedimit penal mund të merret mbi bazën e akteve të administruara, nuk është e domosdoshme kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore.

29.5. Gjithashtu, subjekti kërkon të konsiderohet se denoncuesi A. M., për vendimin e subjektit për mosfillim të procedimit penal, ka paraqitur ankesë në ILD, i cili me anë të vendimit nr. {\*\*\*} prot., datë 24.07.2023, ka vendosur “arkivimin e ankesës”, vendim që, sipas subjektit, provon se prej tij për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 04.08.2021, janë kryer veprime në zbatimin me korrektësi të ligjit procedural dhe material.

29.6. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në fashikullin e Komisionit, si dhe të pretendimeve të subjektit, konstaton se në vendimin e mosfillimit, ashtu si edhe Komisioni ka evidentuar, nuk rezulton të jetë kryer një analizë mbi rrethanat e faktit që janë konstatuar prej subjektit në vlerësim të akteve që kanë shoqëruar kallëzimin. Arsyetimit të subjektit në këtë vendim, i konceptuar kryesisht në planin teorik, i mungon analiza harmonike e dispozitave ligjore me rrethanat specifike të rastit, apo kryerja e disa veprimeve që do t'i sqaronin ato në funksion të një vendimmarrje sa më të drejtë, që duket se ka shmangur edhe përgjegjësinë e prokurorit për të kryer një proces verifikues mbi materialin kallëzues, në raport me kuadrin ligjor në fuqi. Edhe pretendimi i subjektit në ankim, se ai është mbështetur në orientimet e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për mënyrën se si duhet trajtuar faza verifikuese e kallëzimeve penale, nuk i jep sërish zgjidhje situatës konkrete, referuar rrethanave të faktit. Ai vendim, siç trupi gjykues ka analizuar edhe më lart, përcakton kriteret e orientime në planin teorik, se si duhet konceptuar e zbatuar parashikimi i nenit 291 të K.Pr.Penale, por ai më vete nuk shërben për të arsyetuar vendimmarrjen për mosfillimin e ndjekjes penale, për shkak të ekzistencës së një prej rasteve të parashikuara prej kësaj dispozite.

29.7. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti mbrohet ndaj konkluzioneve të Komisionit, duke përdorur bindjen e tij të brendshme për marrjen e vendimit, si një element për të përjashtuar kontrollin e vendimit të mosfillimit në kuptim të kufijve të kontrolluesit, sipas nenit 73, pika 4 e ligjit nr.96/2016, por ai nuk jep asnjë shpjegim për qëndrimet që ka mbajtur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin e datës 9.11.2021, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër më datë 01.11.2021, e cila ka ushtruar kontrollin gjyqësor mbi *bindjen e brendshme* të tij, duke konkluduar se subjekti duhet të vazhdojë të kryejë veprimtari hetimore dhe veprime të caktuara, për dy nga veprat penale të kallëzuara prej denoncuesit, “*Ndërtimi i paligjshëm*” dhe “*Shkatërrimi i pronës*”, duke arritur në përfundimin se *bindja e brendshme* e subjektit nuk ishte e mbështetur në prova e në ligj. Sipas vlerësimit të gjykatës, subjekti duhet të kishte kryer një këqyrje në pronën ku pretendohet se ishin kryer ndërtime dhe

vetëm pasi të mund të kishte konstatuar se nuk ka të tilla, mund të vijonte me vendimmarrjen për mosfillim të procedimit penal, duke potencuar se këtë konkluzion, prokurori nuk mund ta arrijë duke u bazuar vetëm në inspektimin e inspektoratit të ndërtimit. Lidhur me këtë disponim të gjykatës, subjekti ka shpjeguar vetëm se në zbatim të urdhërimeve të këtyre vendimeve, ai ka regjistruar më datë 02.03.2023, procedimin penal nr. {\*\*\*/2023, për të cilin më pas ka shpallur moskompetencën tokësore dhe e ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, por pa ngritur pretendime për vendimmarrjen e gjykatës që ka ardhur në kundërshtim me atë të disponuar prej tij. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, edhe në rast se vendimmarrja do të ishte vërtet produkt i bindjes së brendshme, ndonëse nuk rezulton e tillë, sa kohë që mungon analiza e të dhënave për situatën faktike, sërish ky pretendim nuk justifikon mangësitë profesionale të konstatuara për subjektin, për sa kohë edhe kontrolli gjyqësor që kontrollon edhe këtë element, e ka gjetur atë të padrejtë.

29.8. Lidhur me pretendimin e subjektit se duhet mbajtur në konsideratë se për vendimin e për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të paraqitur prej denoncuesit A. M., është paraqitur ankesë në ILD, e cila është arkivuar, trupi gjykues, në vëmendje të qëndrimit të elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, risjell konkluzionin se vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale është një atribut i organeve të rivlerësimit i pandërthtur me kontrollin që bëjnë organet e juridiksionit të zakonshëm, dhe kryhet mbi një bazë ligjore të ndryshme nga ajo që mbështet veprimtarinë e këtyre organeve.

29.9. Referuar sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se për materialin kallëzues të denoncuesit M. M., subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion, i cili provon veprimet hetimore të kryera prej tij për këtë çështje penale, dhe se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore verifikuese dhe nuk është hetuar për rrethanat e çështjes, është i drejtë dhe i argumentuar dhe, si i tillë, do të vlerësohet në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

30. *Lidhur me denoncimin e z. A. H., që i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*/2017, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

30.1. Nga vendimi i Komisionit lidhur me denoncimin e z. A. H., rezulton se ai është ankuar ndaj subjektit të rivlerësimit për shkak se ai, me cilësinë e prokurorit të çështjes, ka zvarritur prej 6 (gjashtë) vitesh hetimet e procedimit penal nr. {\*\*\*/2017, të iniciuar prej denoncuesit për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”. Faktet objekt hetimi sipas kallëzimit, lidhen me ndërtimin e një ujësjellësi, për shkak të të cilit sipërmarrësi O. B., ish-drejtori i Ndërmarrjes së Ujësjellësit Sarandë, z. D. B., ish-kryetari i Komunës, z. Dh., S., K., dhe ish-kryetari i fshatit Navaricë, z. K. M. si dhe inxhinierët e firmës, duke kryer veprime të paligjshme, i kanë dëmtuar denoncuesit pronën private prej 5.000 m<sup>2</sup>, së bashku me truallin e shtëpisë. Kallëzuesi ankohet se kompania e drejtuar nga shtetasi O. B. ka fituar tenderin për ndërtimin e ujësjellësit dhe nuk e ka zbatuar projektin e Bankës Botërore.

30.2. Komisioni, pasi ka shqyrtuar pretendimet e denoncuesit dhe shpjegimet e subjektit, mbështetur edhe në aktet e administruara, ka konkluduar se: *evidenton zvarritje të hetimeve nga subjekti për një periudhë gati 1 vit e 3 muaj, nga momenti i marrjes së dosjes në dorëzim*

*në qershor të vitit 2019 deri në datën 8.10.2020, kur subjekti ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes. Gjithashtu, nga kontrolli gjyqësor, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka evidentuar faktin se prokurori nuk ka kryer një analizë dhe vlerësim logjik dhe koherent të provave të reja, por ka paraqitur në gjykatë pa më të voglin ndryshim, kërkesën e përsëritur për pushimin e hetimeve me të njëjtën bazë ligjore. Gjithashtu, kjo gjykatë ka vënë në dukje edhe faktin se në kundërshtim me dispozitat ligjore, prokurori nuk ka kryer veprime hetimore shteruese në lidhje me gjetjen e projektit të miratuar për ndërtimin e linjave të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe nuk është vlerësuar në mënyrën e duhur akti i ekspertit agronom, çka tregon moskryerje të detyrës nga ana e subjektit, duke afektuar në këtë mënyrë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatoreve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

**30.3.** Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë denoncim, kundërshton së pari qëndrimin e mësipërm të Komisionit, duke sjellë sërish në vëmendje faktin se kjo çështje në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit gjendej ende në fazën e shqyrtimit pranë gjyqtarit të seancës paraprake e, për pasojë, gjen zbatim kufizimi i nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pretendim i konsideruar i shtjelluar në pjesën hyrëse të vendimit, si dhe jep shpjegimet si vijojnë.

**30.3.1.** Konkluzioni i Komisionit se *evidenton zvarritje të hetimeve* nuk është i drejtë pasi pretendon se kryerjen e hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, pas marrjes në dorëzim të çështjes më datë 04.11.2019, ia ka deleguar oficerit të policisë gjyqësore, i cili i ka kryer ato në përputhje me dinamikën e çështjes.

**30.3.2.** Lidhur me konstatimin e Komisionit *se ka vonesa në paraqitjen edhe të kërkesës për pushimin e çështjes*, subjekti pretendon se në kushtet kur ai kishte krijuar bindjen se duhet t'i drejtohej gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, ai i ka dhënë precedencë hetimit të çështjeve të tjera më të ngutshme dhe më impenjative; dhe se Komisioni nuk ka konsideruar se kushtet kur nuk është shënuar emri i ndonjë shtetasi konkret që i atribuohet vepra penale, në kuptim të nenit 327/2 të K.Pr.Penale, nuk mund të flitet për një detyrim të prokurorit për të përfunduar hetimet brenda afatit të parashikuar nga neni 324 i këtij Kodi.

**30.3.3.** Gjykata e Apelit Gjirokastrë, në vendimin e datës 04.06.2021, ka gabuar duke i dhënë relevancë të shtuar mosadministrimit për shkak të moskërkimit të projektit, pranë subjektit që ka realizuar punimet e prokuruar nga Banka Botërore, pasi provat e administruara, sipas subjektit, provojnë se projekti është zhvilluar vetëm në rrugën publike që përshkruan fshatin dhe nuk ka dëmtuar pronën private të kallëzuesit.

Vepra penale “Shkatërrimi i pronës”, e parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, në kuptim të anës objektive, kërkon të provohet se nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme ka ndodhur veprimi fizik i dëmtimit/shkatërrimit të pronës, mungesa e së cilës pamundëson aplikimin e kësaj dispozite. Toka e denoncuesit nuk rezulton të jetë prekur nga ndërtimi i ujësjellësit, por, nëse ajo është dëmtuar, ky fakt mund të përbëj shkak që i dëmtuari të kërkojë dëmshpërblim në rrugë civile, kërkim për të cilin organi i akuzës nuk ka tagër.

**30.3.4.** Subjekti kërkon nga Kolegji të mbahet në konsideratë se denoncuesi A. H. ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Posaçme (SPAK) kundër subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, kallëzim të cilin kjo prokurori, më datë 24.11.2021, e ka përcjellë për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila, pasi ka bërë vlerësimin e kallëzimit të këtij shtetasi më datë 09.12.2021, ka vendosur për “Mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*/2021”, me arsyetimin se rrethanat e faktit nuk formojnë elemente të figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

**30.4.** Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet në fashikull, konstatohet si vijon.

Në vendimin gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2019, që ka marrë formë të prerë, lidhur me kërkesën e organit procedues për të pushuar procedimin penal nr. {\*\*\*/2017, të regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, i parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, është vendosur: *Rrëzimi i kërkesës. Kthimi i akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, i parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, duke kryer veprimet hetimore të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.*

Gjykata, në këtë vendim, ka vlerësuar se veprimet hetimore nuk janë të plota, pasi nevojitet të evidentohet: *së pari*, nëse është vepruar ose jo në përputhje me projektin e miratuar të ujësjellësit, nëse jo, çfarë devijimesh janë bërë, mbi çfarë baze e nevojë, si dhe pasojat që mund të kenë ardhur. *Së dyti*, të kërkohej prova për të provuar gjendjen e pronës së kallëzuesit para fillimit të ndërtimit të ujësjellësit dhe pas ndërtimit të tij, nëse ka ndryshime të vlerësohet shkakun dhe dëmi i shkaktuar. *Së treti*, nëse konstatohen veprime të kundërligjshme, si kryerja e punimeve jo në përputhje me projektin e miratuar, shkatërrimi ose dëmtimi i pronës, duhet të kryhet vlerësimi i elementit subjektiv, fajit në lidhje me këto veprime. Është e nevojshme të kryhet një ekspertim tekniko-inxhinierik vlerësues, me ekspertë të fushave të ndryshme për të përcaktuar dëmet dhe shkallën e pasojave të ardhura.

**30.5.** Komisioni ka arsyetuar se subjekti ka marrë për hetim procedimin penal nr. {\*\*\*/2017, pas dhënies së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2019. Subjekti pretendon se momenti kur prej tij është marrë në shqyrtim ky procedim penal, është data 04.11.2019, pasi në këtë datë rezulton se ai ka kryer veprimin procedural “Për delegimin e veprimeve hetimore Oficerit të Policisë Gjyqësore P.H.”, duke dashur të kundërshtojë konkluzionin e Komisionit se: *subjekti ka zvarritur hetimet për 1 vit e 3 muaj nga qershori 2019 e deri në datën 08.10.2020*, kur prej tij është kërkuar në gjykatë pushimi i këtij procedimi penal, pasi nëse pranohet se subjektit i është kaluar për ndjekje procedimi penal nr. {\*\*\*/2017 më 04.11.2019, ai rezulton me vetëm 9 muaj vonesë në hetimin e çështjes. Në këto kushte, për sa kohë subjekti, në zbatim të detyrimit që vjen nga barra e provës, nuk ka mundur të provojë ekzaktësisht se kur është marrë në shqyrtim prej tij procedimi penal nr. {\*\*\*/2019, konstatimi i Komisionit se subjektit kjo çështje i është kaluar në qershor 2019, mbetet i pandryshuar. Në vlerësimin e trupit gjykues, fakti që subjekti për këtë procedim penal ka kryer veprimin e parë procedural më datë 04.11.2019, nuk provon domosdoshmëri se atij i ka kaluar për ndjekje kjo çështje pikërisht në këtë datë.

**30.6.** Për sa i përket pretendimit se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ka marrë formë të prerë në datën 17.10.2019, prandaj subjekti nuk mund të vepronte para kësaj date, trupi gjykues konstaton se sipas shënimit që evidentohet në vendimin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2021, vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankuar nga palët. Në kushtet kur denoncuesi kishte marrë një vendim në favor të tij, pasi gjykata kishte rrëzuar kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit duke u dhënë të drejtë pretendimeve të kallëzuesit për hetime të mëtejshme, logjikisht ai nuk kishte arsye të bënte ankim ndaj tij, pasi vendimi ishte në favorin e tij. Për pasojë, e vetmja palë që mund ta ankimonte këtë vendim, ishte prokurori, subjekti i rivlerësimit në këtë rast, që do të thotë se ai nuk kishte pse të priste marrjen formë të prerë të vendimit formalisht, kur vullneti i tij ishte ai që përcaktonte momentin se kur ky fakt juridik do të ndodhte. Në këtë këndvështrim, pretendimi se vendimi kishte marrë formë të prerë në një datë të mëvonshme, nuk mund të shërbejë si argument për subjektin për të justifikuar mungesën e veprimtarisë hetimore për gjithë këtë periudhë, pasi ai kishte qartësinë për pasojën ligjore që kishte krijuar vendimi e që lidhej me kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuara në vendimin gjyqësor.

**30.7.** Në vijim, rezulton se subjekti, në zbatim të urdhërimeve të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {\*\*\*} të datës 07.06.2019, ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por pavarësisht se është përpjekur të gjejë projektin e zbatimit të ujësjellësit tek organet shtetërore përfituese, si Ujësjellës Kanalizime Sarandë, apo Banka Botërore që e ka financuar atë (të cilat janë përgjigjur se për arsye të ndryshme, nuk e disponojnë projektin e detajuar të zbatuar), në mënyrë të pashpjegueshme këtë informacion nuk e ka kërkuar nga kompania e ndërtimit, e cila, në kallëzimin e z. A. H., është identifikuar si shkaktarja kryesore e dëmtimit të pasurisë së tij. Logjikisht, kompania e ndërtimit jo vetëm që duhet të dispononte projektin fillestar për zbatimin e të cilit ajo ka lidhur kontratën e ndërtimit, por është edhe subjekti/entiteti i cili, në mënyrën më të qartë dhe me përgjegjësi, do të mund t'i shpjegonte organit të akuzës ndryshimet e kryera gjatë zbatimit të projektit dhe nevojat që kanë sjellë këto ndryshime. Në këto kushte, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se kjo situatë tregon se subjekti nuk ka kryer hetime të plota as për detyrat e lëna nga gjykata.

**30.8.** Gjithashtu, nga të dhënat e administruara nga Komisioni, konstatohet se subjekti edhe pse më datë 20.01.2020, ka marrë përgjigjet e aktit të ekspertit agronom H. B., i cili ka arritur në konkluzionin se në parcelën e z. A. H. janë dëmtuar shumë pemë, për të cilat identifikon vlerën e dëmit prej 86.000 lekësh, të cilin e vlerëson të shkaktuar nga prezenca e shtuar e lagështirës së terrenit, ai dëmin e shkaktuar nuk e ka konsideruar si jo të lehtë, në kuptim të elementeve të veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, ndonëse sipas praktikës gjyqësore<sup>70</sup> është pranuar se për qëllim të kualifikimit, vlera e dëmit mbi 50.000 lekë do të konsiderohej jo e lehtë si element i anës objektive të veprës, por ka vijuar më datë 08.10.2020, me paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.01.2021. Ky vendim, pasi është ankimuar nga kallëzuesi në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, kjo e fundit, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2021, ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, me argumentin se nga organi i akuzës nuk janë plotësuar detyrat e lëna me

---

<sup>70</sup> Vendime të gjykatës penale.

vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {\*\*\*}, më datë 07.06.2019. Në ankim, subjekti nuk jep asnjë shpjegim për konstatimet e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2021, se nga subjekti jo vetëm nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, por nuk janë drejtuar as pyetjet e duhura tek eksperti topograf, për të përcaktuar kuotat e shtëpisë dhe të pronave të kallëzuesit në raport me ujësjellësin. Ky vendim, i cili është konsideruar në ankim prej subjektit si i padrejtë dhe i marrë nën tryshinë e kallëzuesit, paraqet një panoramë të plotë të mangësive profesionale të subjektit madje të përsëritura edhe pas ndërhyrjes së kontrollit gjyqësor, lidhur me ndërmarrjen logjikshëm të hetimit dhe zbatimin e detyrimeve që vijnë nga vendimet gjyqësore, të cilat kontrollojnë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e veprimtarisë hetimore të zhvilluar nga prokuroria.

**30.9.** Pretendimet e subjektit se kësaj çështjeje, megjithëse kishte kaluar një kohë e gjatë nën hetim, 6 (gjashtë) vjet, ai nuk i ka dhënë prioritet, për shkak se kishte vendosur prioritete për çështje të tjera, në kushtet kur mënyra e zgjidhjes së saj ishte e orientuar drejt pushimit të procedimit, gjenden të pajustificuara prej trupit gjykues, në referim të konkluzionit të Komisionit se ai ka zvarritur hetimin e çështjes. Periudha përgjatë të cilës kallëzuesi ka qëndruar në një pozitë të paqartë ligjore, lidhur me kallëzimin e tij, 6 (gjashtë) vite, është një kohë tepër e gjatë dhe e pajustificuar në raport edhe me specifikat e çështjes dhe natyrën e hetimit që ajo kërkon, në konsideratë edhe të orientimeve e detyrave të lëna nga kontrolli gjyqësor. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se pikërisht përfundimi i kësaj çështjeje që kishte shkaktuar vonesa të paarsyeshme për qytetarin, duhej të ishte konsideruar një prioritet për subjektin, dhe jo e kundërta, duke e gjetur për pasojë të pabazuar këtë pretendim të tij.

**30.10.** Bazuar në sa analizuar më sipër lidhur me denoncimin e z. A. H., trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit se për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2017, prej subjektit të rivlerësimit *nuk janë ndërmarrë veprime hetimore verifikuese dhe nuk është hetuar për rrethanat e çështjes, me qëllim verifikimin e kushteve për ekzistencën e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi*, është i drejtë, i argumentuar dhe i bazuar ligjërisht.

**31.** *Lidhur me denoncimin e znj. D. B., që u adresohet materialeve kallëzuese nr. {\*\*\*}/2017 dhe nr. {\*\*\*}/2022, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

**31.1.** Nga vendimi i Komisionit rezulton se denoncuesja D. B. është ankuar për subjektin e rivlerësimit, pasi ai ka marrë dy vendime për mosfillimin e ndjekjes penale për dy materiale kallëzuese të depozituara prej saj në prokurori. Ajo pretendon se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për verifikimin e tyre, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin material dhe procedural. Materiali i pare kallëzues me nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2017, i referohet ndërtimit të një barake druri nga një shtetas, i cili pretendonte se e kishte marrë me qira sipërfaqen e tokës ku është ndërtuar kjo barake, e cila sipas pretendimit është në pronësi të kallëzueses. Ndërsa materiali tjetër kallëzues me nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2022, referon kryerjen e veprave penale të “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Falsifikimi kompjuterik”, prej punonjësve të ASHK-së, duke pasqyruar nëpërmjet kryerjes së këtyre veprave në mënyrë të gabuar të dhënat kadastrale të pronës së kallëzueses.

**31.2.** Pasi ka shqyrtuar denoncimet dhe shpjegimet e subjektit, mbështetur në aktet e administruara, Komisioni ka arritur në konkluzionin se, *konstaton mungesën e angazhimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të çështjes, si dhe kryerjes së veprimeve verifikuese mbi bazën e kallëzimit të paraqitur prej këtij denoncuesi, veprime të cilat nuk evidentohet të jenë kryer nga aktet e dosjeve penale.*

**31.3.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e mësipërme të Komisionit lidhur me këtë denoncim, duke pretenduar sa vijon.

**31.3.1.** Vendimet e mosfillimit të procedimeve penale për materialet kallëzuese nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2017 dhe nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2022, kanë qenë produkt i bindjes së tij të brendshme të krijuar nga analiza e të gjitha provave të administruara, duke pasur si referim orientimin e dhënë nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2/2013 e cila ka arsyetuar se mosfillimi i procedimit penal merret/nxirret nga aktet e administruara, për prokurorin nuk është e detyrueshme kryerja e veprimeve hetimore.

**31.3.2.** Kallëzuesja D. B., edhe pse ka marrë njoftim për këto vendime nuk ka paraqitur ankim në gjykatë, fakti i cili sipas subjektit tregon se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë angazhimi për kryerjen e veprimeve verifikuese për këto dy materiale kallëzuese nuk është i drejtë.

**31.4.** Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit si dhe të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton sa vijon.

**31.4.1** Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 17.05.2017, rezulton se kallëzuesja D. B. ka referuar në prokurori se është pronare e një sipërfaqe toke prej 700 m<sup>2</sup> ne fshatin Borsh, brenda murit rrethues të ish – Shtëpisë së Pushimit te Fëmijëve, në të cilën ka konstatuar se ishte vendosur një barakë e madhe druri nga banori G. H., i cili ka pasur edhe pretendime pronësie për truallin ku ka vendosur kioskën, duke ngritur pretendime për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, “Shkatërrim prone”. Në vendimin e datës 13.06.2017, “Për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}/2017”, subjekti i rivlerësimit argumenton se në kushtet kur kallëzuesja D. B. dhe z. G. H. që ka vendosur kioskën, janë në një proces gjyqësor për pronësinë e tokës, nuk provohet dashja e z. H. për të shkatërruar pronën e kallëzueses, pasi ai pretendon se po zhvillon pronën e tij. Në këtë vendim, gjithashtu, subjekti argumenton se në këtë rast nuk mundet të fillojë as ndjekjen penale për ndërtim të paligjshëm të parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i parë i Kodit Penal, e cila si masë dënimi parashikon burgimin deri në 1 vit, edhe për shkak të aplikimit të ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 255 të vitit 2016, në të cilin parashikohet se pushohen ndjekjet penale për kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 25.12.2016, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet, ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë [...]”.

**31.4.2.** Në vlerësim të shpjegimeve të mësipërme të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket vendimit për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}/2017, duke konsideruar se në momentin kur subjekti ka marrë këtë vendim, konflikti për pronësinë e

truallit ndërmjet kallëzueses dhe z. G. H. ishte objekt i një procesi gjyqësor, si dhe të faktit që në atë moment ligji i miratuar për amnistinë pengonte nisjen e procedimit penal për ndërtim pa leje, trupi gjykues arriti në përfundimin se vendimi për mosfillim të procedimit penal të marrë në këtë rast prej subjektit, është i argumentuar dhe i bazuar ligjërish, në kuptim të përcaktimeve të nenit 290/1, germat “ç” e “dh”, si dhe të nenit 291/1 të Kodit Procedurës Penale. Konflikti gjyqësor mbi pronën e pretenduar se është shkatërruar, me të drejtë është vlerësuar prej subjektit se të çon drejt konkluzionit se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, për sa kohë që atij i mungon ana subjektive si element i domosdoshëm i veprës, në kuptim të gërmës “ç” të nenit 290/1 të Kodit të Procedurës Penale, për sa palët pretendojnë se kanë të drejta pronësie mbi të njëjtën pronë dhe gjykata civile kompetente nuk është shprehur ende. Ndërsa, duket i bazuar edhe konstatimi se fakti i pretenduar, edhe në këndvështrim të kryerjes së veprës penale të ndërtimit pa leje, do të përfshihej në zbatimin e ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, rrethanë që gjithashtu nuk lejon ushtrimin e ndjekjes penale në kuptim të gërmës “dh” të nenit 290/1 të Kodit të Procedurës Penale.

**31.4.3.** Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2022, trupi gjykues, në referim të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton se kallëzuesja D. B. ka paraqitur kallëzim lidhur me faktin se denoncuesja ka aplikuar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtoria Vendore Sarandë nëpërmjet aplikimit nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2019, për regjistrimin e vendimit gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 27.05.1998, që e njeh atë pronare në dy parcela prej 9.000 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “*varike e mesme*” dhe parcela prej 2.000 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “*plasë e gardhit*” në fshatin Borsh. Kallëzuesja pretendon se ASHK Sarandë, me akt regjistrimi, ka ndryshuar vendndodhjen e pronës, duke regjistruar në emrin e saj një pronë të dikujt tjetër, veprim të cilin e identifikon si shpërdorim detyre nga punonjësit e këtij institucioni.

**31.4.4.** Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë material kallëzues, në vendimin për mosfillim të procedimit penal të datës 17.03.2022, analizon se kemi të bëjmë me një situatë që klasifikohet si *gabim në pasqyrimin e të dhënave në hartën kadastrale*, të shkaktuar nga punonjësit e ASHK Sarandë. Subjekti në vendim ka evidentuar se ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, neni 16, “Korrigjimi i gabimeve në të dhënat kadastrale”, parashikon korrigjimin e një gabimi të tillë, i cili në vlerësimin e bërë nga subjekti, nuk ka elementet e parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal të veprës penale “Shpërdorim detyre”. Sipas analizës së bërë prej subjektit, hedhja gabim e të dhënave, sipas pretendimit të kallëzueses, është pasojë e një gabimi njerëzor *në pasqyrimin e të dhënave në hartën kadastrale* dhe se nuk konstatohen elementet e dashjes, si element i domosdoshëm i ekzistencës së anës subjektive të figurës së veprës penale “Shpërdorim i detyrës”.

**31.4.5.** Në referim të shpjegimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit, si dhe të faktit që në materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2022, kallëzuesja D. B. evidenton vetëm gabimin në hartën kadastrale të pronës dhe nuk identifikon punonjës që, me veprimet e tyre, e kanë bërë me dashje këtë veprim për qëllime përfitimi, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e subjektit që e ka konsideruar këtë veprim në kuadër të një gabimi që nuk passjell përgjegjësi penale, dhe që për më tepër është parashikuar edhe nga neni 16 i ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, si një ngjarje që mund të ndodhë gjatë procesit të përpunimit e hedhjes së të dhënave në sistemin e

regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe që mund të korrigohet sipas përcaktimeve të këtij neni.

**31.4.6.** Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues çmon se argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, me të cilat kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me denoncimin e znj. D. B., janë të drejta dhe qëndrimi i Komisionit lidhur me to nuk gjendet i bazuar dhe i argumentuar ligjërisht.

**32.** *Lidhur me shqyrtimin e denoncimit të z. J. D., i cili i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

**32.1.** Nga vendimi i Komisionit lidhur me denoncimin e shtetasit J. D., rezulton se ai është ankuar ndaj subjektit të rivlerësimit për veprime të kundërligjshme që kanë ardhur në ndihmë të zaptuesve të tokave. Denoncuesi ka kryer një kallëzim penal në datën 25.05.2019 ndaj shtetasit B. G. (K. G.), për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 199, 199/a dhe 200 të Kodit Penal, me pretendimin se ky shtetas i ka pushtuar pronën e tij në Sarandë. Prokurori Ilir Hoxha ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është prishur nga gjykata në datën 29.10.2019. Denoncuesi pretendon se pas kthimit të dosjes nga gjykata, prokurori Ilir Hoxha prej 2 vitesh nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke i cenuar denoncuesit të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm.

**32.2.** Komisioni, pasi ka analizuar pretendimet e denoncuesit dhe ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, mbështetur në aktet e administruara gjatë hetimit, ka konkluduar se *konstaton mangësi të hetimit nga ana e subjektit, konfirmuar kjo edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe ajo e Apelit, e cila ka evidentuar se nga ana e prokurorit nuk është vendosur drejt në bazë të ligjit dhe nuk është kryer një hetim paraprak minimal, por është mjaftuar vetëm me procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes të bërë nga policia gjyqësore, nuk ka hetuar fare për veprat penale të parashikuara nga nenet 199/a/2, 200 dhe 237 të Kodit Penal, duke dalë në konkluzion apriori. Në prapësimet e tij, subjekti nuk depozitoi dokumentacion provues lidhur me veprimet hetimore të kryera në zbatim të urdhërimeve të Gjykatës së Apelit të datës 16.06.2020, duke mos provuar të kundërtën e barrës së provës. Shpjegimi i subjektit se ka deleguar veprimet hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore në datën 23.09.2020 dhe më pas është transferuar në prokurori tjetër, duke e dorëzuar dosjen në fazën e hetimit paraprak, konfirmon mungesën e hetimit të kësaj çështjeje penale për një periudhë rreth 3-vjeçare, nga muaji shtator 2020 kur janë deleguar veprimet tek OPGJ-ja deri në shtator 2023, kur subjekti është transferuar me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin e kësaj çështjeje penale.*

**32.3.** Trupi gjykues konstaton se në ankim subjekti i rivlerësimit, përveç pretendimit se çështja e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020 gjendet në fazën e hetimit paraprak në Prokurorinë Sarandë<sup>71</sup> dhe, për pasojë, subjekti pretendon se në kuptim të përcaktimeve të nenit E të Aneksit

---

<sup>71</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*}, datë 09.01.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, kjo çështje është ende në fazën e hetimit paraprak, ndërsa nga aktet rezulton se ajo ka

të Kushtetutës, nuk duhej të merrej në shqyrtim nga Komisioni, pretendim i konsideruar i shtjelluar si më lart arsyetuar, pretendon dhe shpjegon gjithashtu se:

**32.3.1.** Pasi ka marrë në shqyrtim materialin kallëzues nr. {\*\*\*} datë 28.05.2019, të përcjellë nga Komisariati i Policisë Sarandë, tek i cili *përfaqësuesja ligjore e z. J. D. informon policinë për gërmime nga ana e shtetasit B. G. pranë objektit të tij, duke pretenduar se do të realizohen objekte të paligjshme që ishin shumë pranë detit, material kallëzues në të cilin vetë përfaqësuesja ligjore ka deklaruar se është kërcënuar nga B. G., prej subjektit është vlerësuar se në rastin konkret ngrihen pretendime mbi ekzistencën e veprave penale: (i) “Shpërdorim i tokës”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal; (ii) “Ndërtim i paligjshëm”, kryer në tokë të tjetrit, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal; (iii) “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal; (iv) “Kanosja për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.*

**32.3.2.** Subjekti i rivlerësimit evidenton se, pasi ka kryer të gjitha veprimet e mundshme verifikuese, ka konkluduar se këto vepra nuk ekzistojnë, pasi nuk kemi të bëjmë me *shpërdorim të tokës*, meqenëse vendi ku pretendohet se do të ndërtohet nuk është tokë bujqësore; *nuk kemi të bëjmë me ndërtim të paligjshëm*, pasi nuk ka rezultuar se po kryhej ndërtim, por K. G. vetëm po pastronte pranë pronës së tij që ishte në proces legalizimi; dhe është ndërtuar që para vitit 2009 dhe, për pasojë, vepron instituti i parashkrimit të ndjekjes penale. Subjekti pretendon se ka konstatuar se nuk gjendej para veprës penale “Pushtimi i tokës” të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, pasi nuk konstatohej që ndërtimi të ishte në parcela të tokave bujqësore. Ndërsa lidhur me kundërvajtjen penale “Kanosje për shkak të detyrës”, që identifikohet si kanosja që i është bërë av. A. H., e cila është përfaqësuese ligjore e J. D., nga B. G., i kallëzuar, subjekti argumenton se nuk provohet që *kanosja të ketë qenë serioze dhe të ketë synuar vrasjen apo plagosjen e rëndë të kallëzuesit*. Për pasojë, ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet as neni 239 i Kodit Penal. Në këto kushte, subjekti, më datë 10.06.2019, ka vendosur “*mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 28.05.2019*”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Av. A. H., si dhe shtetasi J. D., ankim i cili është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, e cila, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.10.2019, ka vendosur: *Prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal dhe kthimin e çështjes Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke urdhëruar prokurorinë të regjistrojë këtë procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 200, 199/a/2, 199 dhe 238 të Kodit Penal, dhe të kryejë veprimet hetimore të shtjelluara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Ky vendim, nëpërmjet vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2020, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër.*

**32.3.3.** Bazuar në sa më sipër, subjekti më datë 30.07.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2020, për veprat penale: “*Shpërdorimi i tokës*”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal; “*Ndërtimi i paligjshëm*”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal; “*Pushtimi i tokës*”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal; “*Kanosja për shkak të detyrës*”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Subjekti shpjegon se oficeri i policisë gjyqësore, të cilit ai i ka deleguar një sërë detyrash për kryerjen e veprimtarisë hetimore, edhe pse ka kryer një sërë veprimesh

---

*qenë në ndjekje prej subjektit deri në shtator të vitit 2023, kur ai është transferuar prej asaj zyre në Prokurorinë Durrës.*

hetimore, nuk ka mundur të përfundojë hetimet përpara se të transferohej në një prokurori tjetër dhe, në këto rrethana, kjo çështje është ende në fazë hetimi paraprak. Subjekti kërkon të konsiderohet fakti se nga vitit 2020 kur është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, trupa e prokurorëve ka qenë e reduktuar dhe me mbingarkesë, e cila ka sjellë zgjatjen e hetimeve.

**32.4.** Trupi gjykues, në referim të sa evidentuar më sipër si dhe të vlerësimit të bërë në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2020<sup>72</sup>, konstaton mungesën e kryerjes së veprimtarisë hetimore prej subjektit të rivlerësimit në fazën verifikuese të kallëzimit, veprimtari që është gjetur e mangët dhe e paplotë edhe nga kontrolli gjyqësor. Vetë subjekti nuk jep asnjë argument në ankim, pse ky konkluzion i Komisionit është i gabuar, por vetëm rreshton veprimet hetimore të deleguara për oficerin e policisë gjyqësore, në zbatim të urdhërimeve të gjykatës, duke konfirmuar, në vlerësimin e trupit gjykues, konkluzionin e Komisionit lidhur me mangësitë që i përkasin kësaj faze.

**32.5.** Për sa i takon konkluzionit tjetër të Komisionit se subjekti e ka zvarritur hetimin pasi nuk ka kryer veprime hetimore dhe nuk ka përfunduar hetimet paraprake për një periudhë trevjeçare, pas marrjes së vendimit të gjykatës që urdhëronte regjistrimin e procedimit dhe kryerjen e tyre, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit jep të njëjtat argumente të përsëritura si në rastet e mëparshme. *Së pari*, ia atribuon këtë përgjegjësi oficerit të çështjes, i cili duket se nuk ka kryer veprimet e deleguara për një periudhë trevjeçare, deri në transferimin e tij në një prokurori tjetër, madje adresohet problematika tek i njëjti oficer, A. Sh., si në rastin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020 të trajtuar më lart, që ka të bëjë me kallëzimin e shtetasit M. A., duke evidentuar jo vetëm mangësi në kontrollin dhe drejtimin e hetimit, por edhe në ushtrimin e kompetencave si prokuror lidhur me shkeljet disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore. *Së dyti*, pretendimi i subjektit lidhur me ngarkesën e zyrës ku ai ushtronte veprimtarinë, nuk justifikon zgjatjen e hetimeve paraprake për një periudhë kaq të gjatë, 2019 deri 2023, hetime që kanë vijuar më pas deri në vitin 2024, për rrethana që nuk duket se paraqesin një nivel të tillë kompleksiteti, pasi kallëzuesit kanë evidentuar konfliktin, personat e përfshirë, natyrën e shkeljes së pretenduar, faktet që kanë ndodhur, kanë identifikuar edhe natyrën e veprimtarisë së paligjshme dhe ngjarja ka qenë e dokumentuar edhe me procesverbal të këqyrjes së vendit të ngjarjes.

**32.6.** Në të tilla kushte, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin e kësaj çështjeje penale, është i drejtë dhe i bazuar në prova,

---

<sup>72</sup> Në këtë vendim është arsyetuar se:

“- prokurori nuk ka vendosur drejt, në bazë të ligjit, nuk ka bërë hetim paraprak minimal, porse është mjaftuar vetëm te procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes [...] nuk ka hetuar fare në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/2, 200 dhe 237 të Kodit Penal [...] ka dalë në konkluzione apriori pa marrë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes;

- nuk është dhënë një konkluzion nga ekspertë të fushës së ndërtimit nëse ky ndërtim përmbush kriteret ligjore të një ndërtimi [...] nëse duhet ose jo leje ndërtimi për këtë lloj ndërtimi, të shihet nëse këto punime që bëhen kanë leje ndërtimi [...] nëse është pushtuar ose jo toka publike e shtetit apo e individit [...] nëse shkatërrohet kjo pronë nga ky ndërtim;

- së fundmi, të hetojë në lidhje me faktin e kallëzimit të shtetas A. H. nëse ka kanosje apo jo nga shtetasi K. G.;

- vetëm pasi të kryejë këto veprime hetimore, prokurori do të dalë në një mendim të qartë nëse ka kushte për fillimin e procedimit penal ose jo për këto vepra penale apo të tjera sikurse do të dalin gjatë hetimit të çështjes”.

duke u përfshirë nën indikatorët e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të cilat janë të vlerësueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

33. *Lidhur me shqyrtimin e denoncimit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, që i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*/2019, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

33.1. Nga vendimi i Komisionit lidhur me denoncimin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezulton se kjo shoqëri është ankuar ndaj subjektit të rivlerësimit për shkak se ai nuk ka njoftuar për rreth tre vite ecurinë e çështjes penale të hetuar prej tij, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të kësaj shoqërie për informacion, mbështetur në kallëzimin që kjo shoqëri kishte depozituar ndaj shtetasit B. K., i cili pretendohet se kishte kryer veprën penale të vetëgjyqësisë, nëpërmjet mbajtjes/posedimit të një apartamenti që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ia kishte shitur njëkohësisht edhe kallëzuesit, edhe këtij shtetasi.

33.2. Komisioni pasi ka shqyrtuar pretendimet e denoncuesit dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, mbështetur edhe në aktet e administruara gjatë hetimit, ka konkluduar se: *në analizë të prapësimeve të subjektit, pavarësisht shpjegimeve të tij, evidenton se vendimet e disponuara prej tij për zgjatje të afatit janë të paarsyetuara dhe nuk justifikohen me kryerje të hetimeve shtesë, për të përligjur këto vendimmarrje. Lidhur me mosnjoftimin e kallëzuesit “{\*\*\*}” ShPK për vendimin e pushimit të çështjes, subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, me pretendimin se kjo është detyrë e sekretarisë. [...] Kjo mangësi procedurale në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit i ka mohuar kallëzuesit, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK aksesin në organet e drejtësisë, për të realizuar mbrojtjen e interesave të ligjshëm në hapat e mëtejshëm proceduralë, duke i pamundësuar për të ushtruar të drejtën e ankimit dhe duke evituar në këtë mënyrë kontrollin e ligjshmërisë së akteve të prokurorisë. Gjithashtu, në prapësime, subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës sa i përket njoftimit të kallëzuesit për ecurinë dhe përfundimin e hetimit. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se për këtë procedim penal subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njoftimi i vendimmarrjes së prokurorit si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore duket se është cenuar.*

33.3. Trupi gjykues konstaton se për këtë denoncim nga ana e subjektit, në përgjigjet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, fakti penal është përshkruar si vijon.

33.3.1. Shtetasi B. K., më datë 20.06.2019, ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kundër shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për veprën penale “Mashtrim” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodi Penal pasi, nëpërmjet aktit noterial “Kontratë premtim shitje”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.02.2012, kjo shoqëri, me përfaqësues ligjor D. M., ka premtuar t’i shesë shtetasit B. K., apartamentin me sipërfaqe 92,5 m<sup>2</sup>, të identifikuar me nr. {\*\*\*}, i gjendur në katin e parë mbi dyqane, që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka përfutur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, si shpërblim për punën e kryer ndaj kësaj të fundit. Subjekti shpjegon se, në vijim, shtetasi B. K. ka marrë në dorëzim apartamentin në fjalë, duke u akomoduar në të. Në aktin noterial “Kontratë premtim shitje” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.02.2012, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasi B. K. kanë parashikuar dhe nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë edhe se apartamenti do të dorëzohet i

përfunduar plotësisht, *me çelësa në dorë*, i gatshëm për banim deri në datën 26.08.2012. Gjithashtu, te ky akt shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasi B. K. kanë parashikuar dhe nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë edhe se çmimi total i shitjes së apartamentit është 55.200 euro, dhe se e gjithë shuma e mësipërme është shlyer jashtë zyre për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. D. M. deklaroi se e ka marrë këtë shumë jashtë zyre.

33.3.2. Subjekti përshkruan se më datë 20.06.2019, në banesën e shtetasit B. K. është paraqitur shtetasi S. J., në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, i cili i ka kërkuar shtetasit B. K. lirim të apartamentit në fjalë pasi në bazë të dokumentit “certifikatë pronësie”, me numër serie “{\*\*\*}”, lëshuar më datë 28.01.2015 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë, apartamenti në fjalë është në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Në këto kushte, rezulton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, pasi kishte lidhur me shtetasin B. K. aktin noterial “Kontratë premtim shitje”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.02.2012, nëpërmjet një akti tjetër noterial “Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme apartament”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.09.2013, ia ka shitur të njëjtin apartament<sup>73</sup> shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

33.3.3. Subjekti ka shpjeguar në Komision se procedimi penal nr. {\*\*\*}, i vitit 2019, është regjistruar më datë 21.06.2019, fillimisht për veprën penale “Mashttrim”, me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, e cila u është atribuar personit juridik shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasit D. M., emrat e të cilëve janë regjistruar për herë të parë në regjistrin e njoftimit të veprave penale me autorë të njohur më datë 13.04.2021. Periudha kohore 21.06.2019 – 13.04.2021, ka shërbyer për administrimin e të gjitha provave, kryerjen e ekspertimit teknik, mbi bazën e të cilave është konkluduar që vepra penale t’u atribuohet personit juridik shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasit D. M. Në vijim, subjekti evidenton se janë kryer veprime procedurale që konsistojnë në kërkimin për caktimin ndaj shtetasit D. M. të masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, masë kjo e miratuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë nuk miratoi këtë kërkim të prokurorit, duke pretenduar se moskërkimi i kësaj mase sigurie ka sjellë mosmarrjen e deklarimeve nga shtetasi D. M., të cilit i atribuohet vepra penale për të cilën bën fjalë ky procedim penal e, për pasojë, *për shkak të pavarura nga vullneti i prokurorit*, hetimet për këtë procedim penal nuk kanë mundur të përfundohen brenda afatit.

33.3.4. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se, në përfundim të hetimeve, nëpërmjet kërkesës së datës 09.05.2022, i është drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, duke kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2019, në ngarkim të të pandehurve shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasit D. M., për veprën penale “Mashttrim”, kur ka sjellë pasoja të rënda, kryer në dëm të shtetasit B. K., parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj çështje, gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur ndarjen e çështjeve duke vendosur pezullimin e gjyqimit ndaj të pandehurit D. M. për shkak të mosgjetyes së tij, dhe dërgimin për gjykim të çështjes ndaj personit juridik shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

---

<sup>73</sup> Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, mbi bazën e kësaj kontrate, është pajisur me certifikatë pronësie me nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2015.

33.4. Trupi gjykues, lidhur me sa më sipër, konstaton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK pretendon se, lidhur me kallëzimin e bërë nga kjo kompani më datë 20.09.2019 kundër shtetasit B. K., *për zaptim dhe dhunim banese*, për shkak se ai ka hyrë me forcë në banesën që kjo shoqëri kishte blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, subjekti nuk ka kryer hetime të plota dhe nuk ka konsideruar faktin se z. B. K., edhe pse kishte lidhur kontratë porosie për blerjen e apartamentit, nuk dispononte certifikatë pronësie, siç e dispononte shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, që prej datës 28.01.2015. Po kjo shoqëri pretendon se nuk është njoftuar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me shqyrtimin e kallëzimit të bërë prej saj kundër z. B. K., edhe pse me kërkesat e datës 20.01.2020, ka kërkuar informacion lidhur me këtë kallëzim.

33.5. Lidhur me këto pretendime të denoncuesit, subjekti shpjegon se aktet procedurale të nxjerra prej tij të emërtuara "Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019", që u përkasin datave 13.07.2021, 13.10.2021, 13.01.2022 dhe 13.04.2022, janë të arsyetuara dhe pas çdo zgjatjeje afati, prej tij janë kryer veprime konkrete procedurale, të nevojshme për realizimin e hetimeve të plota, të gjithanshme dhe objektive, duke shmangur edhe ndonjë problematikë të mundshme procedurale për sa i përket njoftimit të të pandehurit.

33.6. Gjithashtu, rezulton se për denoncimet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të regjistruara si material kallëzues me nr. {\*\*\*}, datë 06.09.2019, mbi bazën e të cilit po më datë 06.09.2019, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, i vitit 2019, për kundërvajtjen penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, procedim i cili është bashkuar me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, të regjistruar më datë 21.06.2019, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit B. K.<sup>74</sup>, subjekti në ankim shpjegon se:

Në kushtet kur rezultoi e provuar se, posedimi i apartamentit në fjalë nga shtetasi B. K. është kryer bazuar në aktin noterial “Kontratë premtim shitje”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.02.2012, lidhur midis këtij shtetasi dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, posedimi i apartamentit prej shtetasit B. K. është jo vetëm i ligjshëm, por vlerësohet se nëpërmjet kësaj kontrate, provohet mosekzistenca e anës objektive të figurës së kundërvajtjes penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Subjekti shpjegon se nisur nga kjo situatë faktike dhe rrethanat e përshkruara më sipër, më datë 27.12.2019, ka marrë vendimin për pushimin e hetimeve për këtë kundërvajtje penale, akt në të cilin po ashtu ka vendosur: (i) *Të njohë me këtë vendim të interesuarit.* (ii) *Për ekzekutimin e urdhërimit të përcaktuar në pikën nr. 2 të këtij vendimi, ngarkohet zyra e sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.* Nisur nga përmbajtja e këtij vendimi për pushimin e hetimeve, por edhe në zbatim të përcaktimeve të udhëzimit të përgjithshëm detyruës nr. 2, datë 06.02.2017, të drejtuesit të prokurorisë, në të cilin përcaktohet se sekretaria kryen edhe procedurat e njoftimit të vendimit të pushimit dhe të mosfillimit të procedimit penal sipas destinacionit të përcaktuar në shkresën përcjellëse të vendimit të firmosur nga drejtuesi i prokurorisë, subjekti pretendon se kjo strukturë është edhe përgjegjëse për kryerjen e njoftimit të vendimit të pushimit dhe të mosfillimit të procedimit penal. Në ankim, subjekti shpjegon se, nga trupi gjykues, duhet konsideruar se për këtë procedim, me aktin e datës 20.08.2019, “Vendim për delegimin e veprimeve hetimore”, i janë deleguar Oficerit të Policisë Gjyqësore N. H., detyrat për hetimin

---

<sup>74</sup> *Vendimi për bashkimin e procedimeve penale është marrë më datë 21.10.2019 nga prokurori S. H.*

e plotë dhe të gjithanshëm të procedimit penal nr. {\*\*\*/2019, dhe parashtrohet se, në mënyrë verbale, i ka ngarkuar oficerit të policisë gjyqësore edhe detyrimin e njoftimit të vendimit të datës 27.12.2019, për mosfillim të procedimit penal lidhur me denoncimin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

33.7. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të mësipërme të denoncuesit, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe të subjektit të rivlerësimit, evidenton *së pari*, se subjekti i rivlerësimit nga momenti kur është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 20.06.2019, ka kryer një sërë veprimesh hetimore lidhur me kallëzimin e z. B. K., të cilat duket se kanë zgjatur nga qershori 2019 deri më datë 09.05.2022, kur subjekti ka paraqitur te gjyqtari i seancës paraprake kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {\*\*\*/2019. Po ashtu, ndonëse duket se nevoja për kryerjen e shumë veprimeve hetimore ka diktuar nevojën për zgjatjen e afatit të hetimeve, në vendimet e marra nga subjekti për këtë zgjatje, nuk ka asnjë informacion mbi arsyt konkrete për të cilat është vendosur zgjatja dhe veprimet hetimore që do të duhen të kryhen në periudhën e zgjatur, duke i dhënë të drejtë qëndrimit të Komisionit se subjekti ka zgjatur hetimet në mënyrë të paarsyetuar.

33.8. Në ankim, ashtu si edhe në Komision, subjekti jep një sërë argumentesh në funksion të qëndrimit se nuk ka qenë detyrë e tij specifike njoftimi te palët, dhe në këtë rast te kallëzuesi “{\*\*\*}” ShPK, i vendimit për pushimin e hetimeve për kundërvajtjen penale të datës 27.12.2019, “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Subjekti risjell në vëmendje pretendime të renditura edhe më herët për çështje të analizuara në këtë vendim se, referuar parashikimeve të rregulloreve të nxjerra nga drejtuesit e prokurorisë, me përgjegjësinë për realizimin e njoftimeve, ngarkohet sekretaria e organit procedues dhe jo prokurori i çështjes. Po ashtu, ai pretendon se kjo detyrë i ishte ngarkuar prej tij në mënyrë *verbale* edhe oficerit të policisë gjyqësore, i cili nuk e ka përmbushur atë.

33.9. Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e subjektit për mospasjen e përgjegjësisë për mosnjoftimin e vendimit për pushimin e procedimit penal te kallëzuesi, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, duke risjellë në vëmendje të njëjtat argumente rreth përgjegjësisë së strukturave ndihmëse në prokurori, si më lart arsyetuar, konstaton se përtej parashikimeve të ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë për detyrat e strukturave ndihmëse, prokurori ka për detyrë të përcaktojë qartë në vendim se cilët janë individët të cilëve duhet t’u komunikohet vendimi, në mënyrë që më pas strukturat ndihmëse të zbatojnë atë saktësisht. Në referim të përmbajtjes së vendimit për pushimin e hetimeve të datës 27.12.2019, që vetë subjekti ka referuar në shpjegimet e dhëna në Komision<sup>75</sup> dhe në ankim, konstatohet se në dispozitivin e këtij vendimi subjekti *nuk ka dhënë/referuar as emrin e palës kallëzuese që duhet njoftuar dhe as ka indikuar të dhënat ku duhej kryer ky njoftim*. Kjo mënyrë hartimi e vendimit nga ana e subjektit duket se nuk shkon në linjë me përmbajtjen e udhëzimit të përgjithshëm detyrues nr. 2, datë 06.02.2017 të Drejtuesit të Prokurorisë, që vetë subjekti referon sipas të cilit njoftimi bëhet *sipas destinacionit të përcaktuar në shkresën përcjellëse të vendimit të firmosur nga drejtuesi i prokurorisë*, për sa kohë prej subjektit, në urdhrin e datës 27.12.2019,

---

<sup>75</sup> Aktet e këtij procedimi penal gjenden të administruara në fashikujt 39-41 të përcjella nga Komisioni.

nuk është dhëna as emri dhe as adresa e palës që duhet njoftuar, mangësi e cila duket se i pamundëson sekretarisë të realizojë njoftimin e palëve të interesuara.

33.10. Nga sa më sipër, po ashtu rezulton se subjekti nuk ka ushtruar as kontroll nëse janë kryer ose jo njoftimet për vendimin e *pushimit të hetimeve* lidhur me kallëzimin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si në kohën kur është marrë ky vendim, por as në kohën kur shoqëria ka kërkuar informacion për zgjidhjen e çështjes. Për më tepër, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim as për mungesën e kthimit të përgjigjes shoqërisë që kishte statusin procedural të kallëzuesit dhe të drejtë për t’u informuar për ecurinë e hetimit të çështjes. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se argumenti i përdorur prej subjektit se ai kishte porositur verbalisht oficerin e policisë gjyqësore që të kryente njoftimet e vendimit në analizë, duket krejtësisht joprofesional dhe mbetet në nivel deklarativ.

33.11. Për rrjedhojë, bazuar në sa konstatuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se mosnjoftimi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për vendimin e pushimit të hetimeve të datës 27.12.2019, që i ka mohuar kallëzuesit të drejtën e aksesit në organet e drejtësisë dhe i ka pamundësuar të drejtën e ankimit, reflekton mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas indikatorëve të nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 e, për pasojë, të vlerësueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se është një konkluzion i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

34. *Lidhur me shqyrtimin e denoncimit të z. K. R., i cili i adresohet procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, si dhe me kundërshtitë e subjektit të rivlerësimit për analizën e bërë nga Komisioni për të, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

34.1. Nga vendimi i Komisionit lidhur me denoncimin e z. K. R., rezulton se ai është ankuar ndaj subjektit të rivlerësimit me pretendimin se prokurori nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, nuk ka zbatuar urdhërimet e gjykatës, ka shkelur ligjin, pasi ka komunikuar drejtpërdrejt me të si kallëzues për të pushuar çështjen, ka kryer në fshehtësi veprime korruptive për të pushuar dhe zvarritur çështjen, si dhe ka konsumuar veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni” dhe “Mashtrimi”. Këto pretendime lidhen me trajtimin e dy materialeve kallëzuese të depozituara prej denoncuesit.

(i) Materiali kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2019, ndaj shtetasve A. H., L. E., ish-drejtuesit dhe punonjësve të ZVRPP-së Sarandë, dhe noterit publik A. L., për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikim” e “Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara”, për të cilin subjekti në datën 10.10.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në datën 24.06.2020, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit dhe vazhdimin e hetimeve sipas urdhërimeve të gjykatës.

(ii) Materiali kallëzues nr. {\*\*\*}, viti 2022, ndaj ish-drejtuesve dhe punonjësve të Drejtorisë së ALUIZNI-t dhe ASHK-së Sarandë, drejtueses së ASHK-së znj. A. D. dhe shtetasit A. H., për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsion aktiv e pasiv”, si dhe “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, për të cilin subjekti në datën 24.6.2022 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

**34.2.** Komisioni, pasi ka shqyrtuar pretendimet e denoncuesit dhe shpjegimet e subjektit, mbështetur në aktet e administruara gjatë hetimit, ka konkluduar se *subjekti, përmes prapësimeve, ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme veprimet hetimore të kryera prej tij, në zbatim të urdhërimeve të gjykatës me vendimin e datës 24.6.2020, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues. Komisioni evidenton faktin se gjykata e rrethit gjyqësor, përmes vendimit datë 24.06.2020, ka konstatuar se nga ana e prokurorit nuk është kryer asnjë veprim hetimor sipas ligjit procedural penal, nuk ka marrë në pyetje kallëzuesin, nuk ka marrë asnjë informacion për ecurinë e çështjes gjyqësore civile dhe, për rrjedhojë, edhe vendimi i tij është i cenueshëm në këtë rast, në kundërshtim të plotë me parashikimin e nenit 291, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me çështjen penale nr. {\*\*\*}, datë 13.06.2022, Komisioni konstaton se subjekti nuk arriti të provojë veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij materiali kallëzues, përveçse kryerjes së një analize të elementeve të figurës së veprave penale. Komisioni vëren se subjekti as në prapësime dhe as në vendimin e tij të mosfillimit nuk ka cituar asnjë veprim konkret hetimor të kryer me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, ku mungon një analizë e fakteve që kanë rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit. Komisioni konkludon se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore verifikuese dhe nuk është hetuar për rrethanat e çështjes, me qëllim verifikimin e kushteve për ekzistencën e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi.*

**34.3.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e mësipërme të Komisionit për denoncimin e z. K. R., duke pretenduar fillimisht se për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2020, kemi të bëjmë me një çështje e cila është ende në proces hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për rrjedhojë në zbatim të parashikimeve të nenit E, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës nuk duhet të ishte objekt analize prej Komisionit, për të cilën trupi gjykues sjell në vëmendje arsyetimin shterues të bërë në pjesën hyrëse të këtij vendimi duke e konsideruar atë të pabazuar<sup>76</sup>. Përveç këtij pretendimi, lidhur me konkluzionet e Komisionit për këtë çështje, pretendon sa vijon.

**34.3.1.** Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2019, të kallëzuesit K. R. në të cilin ngrihen pretendime ndaj shtetasit A. H. për falsifikim dokumenti, subjekti pretendon se prej tij është marrë vendimin për “Mosfillimin e procedimit penal”, më datë 10.10.2019, dhe evidenton se në këtë moment, vendimi i gjykimit civil i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2018, me të cilin shpallen të falsifikuara dokumentet e privatizimit në bazë të të cilave shtetasi A. H. ka fituar pronësinë e apartamentit të kallëzuesit, *nuk kishte marrë formë të prerë.*

Subjekti shpjegon se, pasi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur pranimi i ankimit të kallëzuesit kundër këtij vendimi për mosfillimin e procedimit penal, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}/2020. Hetimin e këtij procedimi, me aktin përkatës të datës 21.10.2020, ai ia ka deleguar për kompetencë OPGJ-së A. Sh., prej të cilit hetimi nuk u përfundua deri në momentin e

---

<sup>76</sup> Çështja është në hetim paraprak nga një prokuror tjetër duke qene se subjekti është transferuar nga kjo prokurori që në vitin 2023 dhe objekt analize janë veprimet e subjektit në marrjen e vendimit për mosfillim të procedimit penal dhe jo ecuria e mëtejshme e hetimit të çështjes.

transferimit në një prokurori tjetër. Subjekti evidenton se as prej vetë atij, hetimi i procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020 nuk është bërë i mundur të përfundohet përpara se të transferohet në Prokurorinë Durrës.

34.3.2. Lidhur me materialin tjetër kallëzues nr. {\*\*\*} datë 13.06.2022, nëpërmjet të cilit kallëzuesi K. R. ka paraqitur denoncim ndaj punonjësve të ASHK dhe ALUIZNI-t Sarandë, se në mënyrë të përsëritur, me dashje dhe në shkelje të ligjit ata nuk finalizojnë legalizimin e objektit të kallëzuesit duke e mbajtur atë pezull për 8 vite, subjekti shpjegon se:

pasi ka marrë në shqyrtim këtë material kallëzues, duke vlerësuar se përmban parashtrime të përgjithshme dhe se fakti për të cilin është ushtruar kallëzim nuk përmban elementë të asnjë vepre penale, më datë 24.06.2022 ka vendosur “*Mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të regjistruar me nr. {\*\*\*}, date 13.06.2022*”. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit dhe ai rezulton të ketë ushtruar ankim. Vendimi i mësipërm është marrë duke u bazuar në bindjen e brendshme, sepse ka konstatuar se aktet e administruara me kallëzimin mbështesin konkluzionin për mosfillim të procedimit penal lidhur me të, pa qenë e nevojshme të kryen hetime të tjera, qëndrime të cilat sipas subjektit janë të orientuara nga përmbajtja e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2/2013.

34.4. Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, konstaton se për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2019, i cili ka kërkuar procedimin penal për falsifikim të punonjësve të ASHK-se A. H., L. E. ish-drejtuesit dhe punonjësve të ZVRPP-së Sarandë, dhe procedim penale të noterit publik A. L. për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi” e “Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara”, subjekti i rivlerësimi më datë 10.10.2019, ka vendosur për “Mosfillim të procedimit penal” edhe pse bashkëlidhur kallëzimit ishte paraqitur si provë, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, i cili shpall si të falsifikuara dokumentet që ndodhen në zyrën e ZRVPP-se Sarandë, për të cilat kallëzohen punonjësit e ASHK-së Sarandë, të sipërcituar. Subjekti duke arsyetuar se ky vendim gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë, ka konkluduar se ekzistojnë rrethana që pengojnë ushtrimin e ndjekjes penale.

Nga sa më sipër, trupi gjykues evidenton se në këtë rast vendimmarrja e subjektit e datës 10.10.2019, “Për mosfillim të procedimit penal”, është marrë brenda 15 ditëve nga paraqitja e këtij kallëzimi (i depozituar me datë 27.09.2019), situatë e cila, *së pari*, duket e “pazakontë” për performancën e subjektit, i cili në ankim, në mënyrë të përsëritur ka pretenduar se vonesat në hetimet e çështjeve të akumuluar kanë ardhur për shkak të ngarkesës në punë dhe të mungesës së trupës së prokurorëve; *së dyti*, rezulton se ndonëse vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2018, pranon kërkesën e kallëzuesit për shpalljen e dokumenteve të falsifikuara, në mënyrë të pashpjegueshme ky disponim ka mbetur jashtë vlerësimit të subjektit, i cili edhe pse ka pasur dijeni për këtë vendim gjyqësor, ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues që lidhet pikërisht me falsifikimin e këtyre dokumenteve nga A. H. dhe punonjësit e ASHK-së Sarandë; *së treti*, rezulton se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim verifikues për të marrë informacion zyrtar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, lidhur me ecurinë e çështjes civile që lidhet me shqyrtimin në apel të vendimit gjyqësor. Nëse do të kishte kryer këtë verifikim, subjekti do të kishte

konstatuar se më datë 10.10.2019, kur prej tij është marrë vendimi “Për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues {\*\*\*}, datë 27.09.2019”, Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me anë të vendimit nr. {\*\*\*} datë 19.08.2019, kishte vendosur për lënien në fuqi të vendimit të mësipërm, që i shpall të falsifikuara dokumentet për të cilat kallëzuesi akuzonte shtetasin A. H. dhe punonjësit e ASHK-së Sarandë.

34.5. Gjithashtu, trupi gjykuesi konstaton se subjekti, edhe në konsideratë të vendimit të gjykatës nr. {\*\*\*} të datës 24.06.2020, që ka vendosur për shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues {\*\*\*}, datë 27.09.2019, dhe ka urdhëruar regjistrimin e çështjes penale me nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2020, sërish nuk ka mundur të përmbushë veprimet hetimore të përcaktuara si të nevojshme për t’u kryer në këtë vendim të gjykatës<sup>77</sup>, deri në momentin e transferimit të tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në tetor 2023. Në këto kushte, *shpjegimet e subjektit se mospërmbushja e veprimeve hetimore të kërkuara nga gjykata ka ardhur për shkak se si vetë ai, si dhe OPGJ-ja<sup>78</sup> të cilit i ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore, janë transferuar në prokurori të tjera*, trupi gjykues i konsideron si pretendime të pabazuara e jo të besueshme, për më tepër të pajustificueshme nga pikëpamja e përgjegjësisë së subjektit si titullar i hetimit dhe kontrollues i veprimtarisë së oficerit të policisë gjyqësore, pasi çmon se periodha kohore nga regjistrimi i procedimit penal në qershor 2020, e deri në transferimin e subjektit në Prokurorinë Durrës në tetor 2023, ka qenë një periudhe kohore më se e mjaftueshme për t’i realizuar detyrat e lëna nga gjykata. Trupi gjykues sjell në vëmendje edhe në vlerësimin e kësaj çështjeje, analizën e bërë më sipër për marrëdhëniet mes prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore në rrafshin procedural dhe atë disiplinor, përtej rolit të munguar të subjektit në hetim si prokuror i çështjes.

34.6. Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 13.06.2022, për të cilin subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, trupi gjykues konstaton se në ankim subjekti nuk ka ngritur asnjë pretendim konkret adresuar konkluzionit të Komisionit, se ai nuk ka kryer asnjë veprim verifikues lidhur me pretendimet e kallëzuesit në këtë material, por ka bërë vetëm një analizë teorike të dispozitave ligjore mbi orientimet e vendimit nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. I vetmi pretendim i ngritur në ankim për të kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë material kallëzues, konsiston në përdorimin e bindjes së brendshme të subjektit për të konkluduar se ekzistojnë kushte që pengojnë ushtrimin e ndjekjes penale në këtë rast, si edhe faktin se kallëzuesi megjithëse është njoftuar nuk ka bërë

---

<sup>77</sup> Sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2020, është vendosur: “prishjen e vendimit [...] “mosfillimin e procedimit penal” [...], duke u urdhëruar organi i akuzës të regjistrojë procedimin penal [...] dhe [...] kryerjen e veprimeve hetimore: pyetjen e kallëzuesit K. R.; administrimin e akteve të ekspertimit tekniko-grafik të realizuar nga Instituti i Policisë Shkencore mbi falsitetin e dokumenteve përkatës në procesin gjyqësor civil; pyetjen e të gjithë personave të kallëzuar [...]; verifikimin dhe marrjen e dokumentacionit përkatës objekt kallëzimi, pranë institucioneve shtetërore si ZVRPP Sarandë (sot ASHK), zyra noteriale arkivave të gjykatës, Institutit të Policisë Shkencore në lidhje me akt ekspertimet tekniko-grafike të realizuara për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; shqyrtimin dhe verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, për sa i përket përdorimit të dokumenteve, sipas tij, të falsifikuara nga ana e të kallëzuarve A. H. dhe L. E.; këto dhe veprime të tjera hetimore që do të çmohen të nevojshme nga organi i akuzës”.

<sup>78</sup> Sërish Oficeri i Policisë Gjyqësore A. Sh.

ankim ndaj këtij vendimi. Këto pretendime empirike nuk vlerësohen të mjaftueshme prej trupit gjykues për të përmbysur konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë çështje.

34.7. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e Komisionit lidhur me mangësitë profesionale të subjektit në trajtimin e dy materialeve kallëzuese të trajtuara më lart, janë të drejta dhe të bazuara e, për pasojë, ato gjenden nën indikatorët e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe të vlerësueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

34.8. Në përfundim, në përmbledhje të sa shqyrtuar më sipër, trupi gjykues, pasi mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionet e Komisionit për sa i përket analizës së çështjeve që kishin ardhur në vëmendjen e Komisionit nga: **(i)** burimet arkivore; **(ii)** institucionet verifikuese; dhe **(iii)** denoncimet e publikut, i gjeti ato përgjithësisht të drejta dhe të bazuara në ligj dhe në faktet që kanë rezultuar nga analiza e akteve të administruara gjatë hetimit.

34.9. Trupi gjykues, *së pari*, gjeti të drejta konkluzionet e Komisionit lidhur me çështjet e shqyrtuara dhe që konsistonin në disa problematika që evidentoheshin nga veprimtaria procedurale e prokurorit. Disa prej tyre u konstatuan dhe u vlerësuan si një metodë pune e tij, e cila gjente pasqyrim në disa prej procedimeve penale të marra në analizë e që kishin sjellë në pikën fundore, zvarritje të hetimeve dhe cenim të interesave të palëve të cilat i ishin drejtuar organit të akuzës për kallëzimin e veprimtarive kriminale që kishin cenuar edhe interesat e tyre të drejtpërdrejtë. Konstatohet se subjekti, në vendimet e tij për mosfillimin e procedimeve, shmang nga analiza rrethanat e faktit të paraqitura në raste konkrete, duke synuar përgjithësisht një analizë teorike mbi kuadrin ligjor që identifikohet se zgjidh çështjen. Këto mangësi janë konstatuar prej gjykatave që kanë kontrolluar veprimtarinë e subjektit, si arsyeja që kanë urdhëruar regjistrimin e procedimeve penale dhe kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore që synojnë verifikimin e rrethanave të faktit për të pasur më tej mundësinë për vlerësimin e plotë jo vetëm të kuadrin ligjor, por edhe të zbatimit të tij në situatën faktike. Këto procese të zhvilluara në kohë, kanë shkaktuar zgjatje të hetimeve dhe dëmtim të interesave të palëve të përfshira në mënyrë të paarsyeshme.

34.10. *Së dyti*, trupi gjykues konstatoi se subjekti, në disa raste, nuk ka kryer veprimtari të mjaftueshme hetimore, edhe kur ajo është urdhëruar nga gjykata, duke konservuar të njëjtin qëndrim në raport me hetimin dhe bazueshmërinë e tij, pavarësisht detyrave dhe orientimeve të dhëna në vendimet gjyqësore. Rezulton, së paku në dy raste, se subjekti ka neglizhuar ndjekjen e veprimtarisë hetimore të deleguar/urdhëruar se do të kryhej prej oficerëve të policisë gjyqësore në zbatim të urdhërimeve të gjykatës, pavarësisht pretendimit se ngarkesa në punë ishte një prej arsyeve të kësaj situate.

34.11. *Së treti*, trupi gjykues konstatoi zvarritje të hetimeve, duke kryer veprime hetimore me distancë kohore të pajustificuar, të cilat në disa raste duket se kanë afektuar edhe vetë zgjidhjen e çështjeve, për shkak se kryerja e kësaj veprimtarie në një kohë të mëvonshme është bërë e pamundur apo e paefektshme dhe ka ndikuar kështu në vetë mënyrën e përfundimit të procedimit. Për të gjitha arsyet e mësipërme, trupi gjykues konstatoi mangësi profesionale të subjektit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, sipas indikatorëve të aftësive profesionale të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

34.12. *Së katërtri*, trupi gjykues konstaton mangësi lidhur me indikatorin e aftësive organizative, në kuptim të nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, e që i adresohen sigurimit të noftimeve të vendimeve të tij për subjekte procedurale në procedim.

34.13. Trupi gjykues konfirmon të njëjtin qëndrim me Komisionin, se problematikat e evidentuara mbeten në një nivel të tillë që nuk mund të kualifikohen se e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, por që me të drejtë janë vlerësuar në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve. Ky vlerësim mbetet i njëjtë edhe pasi trupi gjykues mbajti një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni për sa u përket çështjeve që lidheshin me denoncimet e shtetasve F. H., A. B. e D. B. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi të drejtë dhe të argumentuar konkluzionin e Komisionit se mangësitë e konstatuara në analizën e bërë për problematikat e evidentuara nga shqyrtimi i denoncimeve të administruara, të çështjes me burim arkivor dhe çështjes që vjen nga institucionet informuese, t'i mbajë në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të të tri kritereve për subjektin e rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

35. *Në vijim, trupi gjykues u ndal në analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit sipas të cilave kundërshton konkluzionin e Komisionit për sjelljen e magjistratit jashtë funksionit, duke evidentuar problematika që ndikojnë negativisht në figurën e subjektit si magjistrat, të cilat cenojnë standardet e sjelljes dhe etikën në punë që vijnë për shkak të shoqërimit të subjektit të rivlerësimit me shtetas të proceduar me vepra të ndryshme penale e të përfshirë në aktivitetet të kundërligjshme, pasi, sipas tij, nuk është konsideruar se:*

(i) veprat penale për të cilat janë dënuar apo kanë qenë nën hetim personat me të cilët është shoqëruar subjekti, nuk janë të tilla që duhet ta ngarkojnë me përgjegjësi subjektin;

(ii) nuk është provuar dijenia/padijenia e subjektit mbi problematikat/procedimet penale të personave me të cilët ai shoqërohej;

(iii) Komisioni nuk ka bërë një analizë të plotë lidhur me kategoritë “shtetas i proceduar për vepër penale”, “shtetas në shkelje të ligjit” dhe “shtetas i dënuar”, ndërsa secila prej këtyre kategorive e ka afektuar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit.

35.1. Nga vendimi i Komisionit lidhur me këtë shkak ankimi, rezulton se është marrë në analizë sjellja jashtëgjyqësore e subjektit në raport me shoqërimin e tij me individë, të cilët kanë qenë persona të proceduar apo dënuar penalisht, apo persona të cilëve u është atribuar vepra penale. Komisioni ka marrë informacion mbi këta individë, duke verifikuar të dhënat e disa shtetasve të cilët rezultojnë nga sistemi TIMS se kanë udhëtuar me subjektin jashtë kufirit shtetëror. Nisur nga kjo e dhënë, Komisioni, duke përdorur kryesisht të dhënat e këtij sistemi, ka ngritur çështje për historitë penale të këtyre shtetasve, të cilët, sipas përgjigjeve të vetë subjektit, janë lidhje shoqërore të tij, madje disa prej tyre, për një periudhë kohe shumë të gjatë.

35.2. Komisioni ka vlerësuar të dhënat e rezultuara nga hetimi edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit duke arritur në konkluzione se: *sjellja e subjektit, mungesa e kujdesit të treguar prej tij, dhe shoqërimi me persona të proceduar për vepra të ndryshme penale, është shqetësuese dhe nuk duhet të mbetet pa u trajtuar. Ligji nr. 84/2016 nuk ka të parashikuar dispozita ligjore në lidhje me shkelje të tilla të kryera nga subjekti, pasi me ligj janë kompetencë*

e një institucioni tjetër. Komisioni referuar ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në shkronjën “ç” të nenit 103, me titull “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”, parashikohet se: “Sipas parashikimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 101 të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit, si vijon: ç) shoqërimi me persona që janë në ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gjaku ose me ligj dhe pasja e marrëdhënieve të biznesit të papërshtatshme me këta persona”; jurispruencës së KPA-së; Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (Karta e Romës 2014); Udhëzimeve të Budapestit për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë; si dhe parimeve të gjithëpranuara të Bangalores (2007); në analizim të të gjitha rrethanave të konstatuara në rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimeve të parashtruara nga subjekti, Komisioni çmon se në rastin konkret këto rrethana tregojnë për një qëndrim neglizhent dhe jo të kujdesshëm të subjektit të rivlerësimit për ambientin dhe personat që e rrethojnë. Referuar fakteve të hetimit se këta shtetas janë shkelës të ligjit, fakt i cili në sytë e publikut ngre pikëpyetje mbi integritetin dhe besimin e subjektit të rivlerësimit, apo nevojës dhe interesave të përbashkët që bashkojnë subjektin e rivlerësimit me këta individë. Për vetë statusin dhe funksionin që përfaqëson magjistrati, shmangia e kontakteve me persona me probleme me ligjin është një domosdoshmëri dhe nevojë, që shoqëria e gjerë duhet ta perceptojë dhe besojë si të tillë, qëllim kryesor i së cilës është pasja e besimit të sistemi i drejtësisë, në tërësinë e tij. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm të kundërtën e barrës së provës lidhur me shoqërimin e tij, me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme, dhe si e tillë, mbeten të provuara situata që ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

**35.3.** Nga hetimi administrativ i kryer prej Komisionit, konstatohet se, nga të dhënat e siguruara nga sistemi TIMS, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar disa herë jashtë territorit shqiptar me shtetas të ndryshëm, si shtetasit A. B., B. B., A. H., B. T. dhe E. D. Pikërisht për këta shtetas kanë rezultuar të dhëna nga vetë sistemi TIMS, që dëshmojnë se ata janë proceduar penalisht ose për ta është atribuar kryerja e veprave penale. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si jo të drejtë dhe të bazuar ligjërisht analizën e bërë nga Komisioni lidhur me personat e mësipërm, duke dhënë për secilin prej tyre shpjegimet/prendimet si vijojnë.

**35.4.** Lidhur me shtetasin A. B., Komisioni ka konstatuar se: në ngarkim të shtetasve B. B. dhe A. B., në datën 11.07.2018 është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal, për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 02.08.2018, ka vendosur pushimin e çështjes, pasi i dëmtuari nga vepra penale kishte hequr dorë nga ankimi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo analizë nuk është e drejtë, duke parashtruar se: **(i)** duhet konsideruar se me shtetasin A. B. ka pasur marrëdhënie shoqërore që nga vitit 1990 kur ishin studentë, marrëdhënie e cila asnjëherë nuk është shoqëruar me marrëdhënie ekonomiko-financiare; **(ii)** për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2018 i regjistruar nga Prokuroria

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim, ka ardhur në dijeni në mënyrë rastësore disa ditë pas ndodhjes së ngjarjes, pasi ai në atë kohë ushtronte funksionin si prokuror në Sarandë; **(iii)** duhet konsideruar se ky procedim penal ka të bëjë me një reagim të shtetasit B. B. për dhunimin e fëmijës së tij të mitur, të cilit i ka ardhur në ndihmë edhe A. B., rrethanë e cila provon mungesën e dashjes në veprimet e tyre; **(iv)** duhet mbajtur në konsideratë se më datë 02.08.2018, nga prokurori i çështjes është marrë vendim për pushimin e çështjes; **(v)** edhe pse procedimi penal nr. {\*\*\*}/2018 është pushuar në një kohë të shkurtër, e gjithë kjo ngjarje ka sjellë distancim të tij nga shtetasi A. B.; **(vi)** referuar të dhënave të Regjistrisë të Gjendjes Gjyqësore, shtetasi A. B. nuk ka qenë asnjëherë i dënuar; **(vii)** distancimi i tij nga shtetasi A. B. që para 5 vitesh, dëshmon faktin se ka treguar kujdesin e duhur për të ruajtur të pastër në sytë e publikut figurën e magistratit, duke treguar sjellje që dëshmojnë të kundërtën e qëndrimeve të Komisionit.

**35.4.1.** Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit lidhur me marrëdhënien e tij me shtetasin A. B., konstaton *së pari*, se për personat për të cilët ka të dhëna të besueshme (siç janë ato të sistemit TIMS), se subjekti ka marrëdhënie njohjeje apo shoqërore, Komisioni ka verifikuar këto raporte dhe të dhënat rreth tyre, në aplikim të standardeve të kontrollit të organeve të rivlerësimit në funksion të vlerësimit tërësor, të kërkuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe neni 61, pika 5 e të njëjtit ligj, për të parë/kontrolluar nëse subjekti me sjelljet e tij gëzon apo jo besimin e publikut. Në rastin konkret, edhe për trupin gjykues, ashtu si edhe për Komisionin, mbetet i pandryshuar fakti se A. B. dhe B. B. kanë qenë persona ndaj të cilëve është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}/2018 për veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje” e kryer në bashkëpunim, sipas parashikimit të neneve 89 dhe 25 të Kodit Penal, i cili është pushuar për shkak të heqjes dorë nga ankimi i të dëmtuarit nga vepra penale, meqenëse kjo vepër ndiqej me ankim sipas parashikimit të nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, rezulton se këta shtetas kanë qenë persona të proceduar penalisht të cilët nuk janë thirrur në përgjegjësi penale në mënyrë përfundimtare, për shkak të mungesës së vullnetit të të dëmtuarit, si një kusht për të vijuar procedimin. Për shkak të faktit se procedimi është pushuar për këtë motiv, argumentet që sjell subjekti për rrethanat e kryerjes së veprës, nuk mund të shërbejnë për të relativizuar sjelljen tyre, pasi ato nuk i janë nënshtruar një vlerësimi të organeve proceduese, por mbeten deklarative e të pretenduara nga vetë shtetasit përgjegjës.

**35.4.2.** *Së dyti*, për trupin gjykues, marrëdhënia e subjektit me këta shtetas duket të ketë qenë e ngushtë dhe me kontakte intensive, për sa kohë nga sistemi TIMS provohet se subjekti ka udhëtuar disa herë me ta jashtë vendit. Pretendimi i tij se *pas regjistrimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2018, në ngarkim të shtetasit A. B., është distancuar prej tij*, duket jobindës, në kushtet kur në ankim, vetë subjekti pohon se ka kryer me të vetëm dy udhëtime jashtë vendit, përkatësisht më datë 13.09.2018 dhe 09.12.2018, udhëtime të cilat kanë lënë gjurmë në sistemin TIMS, për pasojë janë të pamohueshme sipas standardit të provueshmërisë që kanë të dhënat e këtij sistemi, por edhe pohimit të vetë subjektit. Ndërsa përpjekja e subjektit për të bindur trupin gjykues se marrëdhënia e tij me këtë shtetas është zbehur, dhe këto udhëtime janë të vetmet kontakte të tij me të pas ngjarjes së marrë në analizë, janë jobindëse; *së pari*, sepse sistemi TIMS nuk provon çdo kontakt mes shtetasve, por jep informacion rreth marrëdhënive

që ata mund të kenë në mënyrë të logjikshme, dhe *së dyti*, edhe nëse do ishin vetëm këto kontakte, siç subjekti pretendon, duket se ato kanë ndodhur në kohën kur kishte nisur procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kjo situatë kujdesi për moskalimin së bashku të kufirit shtetëror, mund të ketë provokuar një lloj kujdesi të shtuar për mosekspozimin e këtyre raporteve, rrethana që gjithsesi nuk provojnë distancimin e pretenduar prej subjektit.

**35.4.3.** Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit se distancimi i tij nga shtetasi A. B. që para 5 vitesh, dëshmon se *ka treguar kujdes për të ruajtur të pastër në sytë e publikut figurën e magjistratit*, duket se është një pretendim i paargumentuar. Për pasojë, trupi gjykues çmon se analiza e bërë nga Komisioni për marrëdhënien e subjektit me shtetasin A. B., është e drejtë.

**35.5.** Lidhur me shtetasin B. B., Komisioni ka konstatuar se: *Shtetasi B. B. në datën 03.09.2012 është proceduar në gjendje të lirë për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Gjithashtu, në ngarkim të shtetasve B. B. dhe A. B., në datën 11.07.2018, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal, për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 02.08.2018, ka vendosur pushimin e çështjes pasi i dëmtuari nga vepra penale kishte hequr dorë nga ankimi.* Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë qëndrim duke pretenduar se: **(i)** lidhur me procedimin penal {\*\*\*}/2018, përveç argumenteve të njëjta që ngrihen në raport me shtetasin A. B., subjekti sjell në vëmendje se me shtetasin B. B. pas ngjarjes se procedimit penal {\*\*\*}/2018, nuk ka kryer asnjë udhëtim jashtë vendit, *pasi udhëtimi i fundit i kryer me këtë shtetas është më datë 14.01.2015*, fakt i cili, sipas tij, provon këtë distancim; **(ii)** lidhur me procedimin në gjendje të lirë për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, pretendon se ky konstatim nuk qëndron, pasi ai është marrë nga Komisioni nga të dhënat e rubrikave informative të sistemit TIMS, ndërsa në përgjigjen e dhënë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2024, rezulton se *nga verifikimet manuale të regjistrave të institucionit, nuk kemi mundur të gjejmë procedim penal në ngarkim të shtetasit B. B.*, informacion që në vlerësimin e subjektit, krijon dyshime lidhur me vërtetësinë e të dhënave që gjenden në rubrikat e sistemit TIMS për shtetasin B. B.; **(iii)** me kërkesën e datës 21.02.2024, subjekti ka kërkuar informacion edhe nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, lidhur me sa pasqyrohet në TIMS më datë 03.09.2012 për shtetasin B. B. dhe ka marrë përgjigje për të vetëm pas depozitimit të ankimit<sup>79</sup>; **(iv)** subjekti nuk ka pasur akses në vitin 2012 në sistemin TIMS, pasi ka qenë në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, por edhe pasi është bërë prokuror nuk ka pasur asnjë “username” për të aksesuar këtë sistem, duke potencuar

---

<sup>79</sup> Me dokumentet e përcjella në Kolegj me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit ka sjellë kthimin e përgjigjes së Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.03.2024, me anë të së cilës i jepet përgjigje subjektit lidhur me kërkesën e tij të datës 21.02.2024, duke i bërë me dije se: Drejtoria e Policisë Qarkut Korçë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.09.2012, ka dërguar materiale hetimore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, në ngarkim të shtetasit B. B., për veprën penale të “Trafikimit të mjeteve motorike” të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

mungesën e dijenisë rreth kësaj të dhëne; (v) referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Gjyqësore, shtetasi B. B. nuk ka qenë asnjëherë i dënuar.

35.5.1. Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e mësipërme të subjektit për sa i përket marrëdhënies së tij me shtetasin B. B. dhe përpjekjeve të tij për distancim, pa dashur të përsëritë arsyetimin e mësipërm për shtetasin A. B., evidenton se edhe në këtë rast vlen arsyetimi se distancimi i pretenduar mbetet deklarativ dhe i paprovuar.

35.5.2. Duke vijuar analizën, trupi gjykues, për sa u përket kërkimeve të tjera të subjektit evidenton *së pari*, se prej tij është kërkuar informacion për procedimet penale në ngarkim të shtetasit B. B. nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, vetëm më datë 16.02.2024 (*pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi*), dhe nuk është kërkuar sigurimi i këtij informacioni gjatë hetimit administrativ, pavarësisht se nga raporti i rezultateve të hetimit administrativ rezulton se subjekti ka pasur dijeni për konstatimet e Komisionit lidhur me këtë shtetas. *Së dyti*, vetë informacioni që subjekti jep në ankim se edhe pse ka kërkuar informacion nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë lidhur me këtë shtetas, nuk ka marrë asnjë përgjigje prej saj, që nuk shkon në favor të pretendimit të subjektit se informacionet e përfshira në TIMS<sup>80</sup> për këtë shtetas mund të mos jenë të vërteta, pasi mungesa e përgjigjes nuk do të thotë se ky shtetas nuk ka rekorde në regjistrat e Policisë së Shtetit, e cila është struktura që më së shumti ofron/furnizon të dhënat e evidentuara në platformën TIMS, aq më shumë kur me përgjigjen e marrë pas depozitimit të ankimit, konfirmohen për këtë shtetas të dhënat që janë hedhur në sistemin TIMS.

35.5.3. Në referim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, me ankimin, subjekti nuk ka mundur të rrëzojë konstatimet e vendimit të Komisionit lidhur me problematikat e evidentuara për shtetasin B. B., ndaj të cilit së paku provohet se është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}/2018.

35.6. Lidhur me shtetasin A. H. (M.), Komisioni ka analizuar dhe konstatuar se *ky shtetas në datën 06.07.2012, është proceduar për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe në datën 16.01.2014 është proceduar në gjendje të lirë për aktivitetin e lotarive të palejuara, baste sportive. Gjithashtu, në datën 30.07.2019, ka rezultuar një material kallëzues i regjistruar më 30.07.2019 ndaj këtij shtetasi për veprën penale “Tregtim i mallrave të dyshuara si kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, ku në përfundim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit lidhur me të si vijon.*

---

<sup>80</sup> Ligji nr. 9861, datë 24.01.2008, i cili më pas është ndryshuar dhe shfuqizuar pjesërisht, në nenin 4 pika 10, jep përkufizim të sistemit TIMS si vijon:

“10. “Sistemi i Informacionit të Kontrollit të Kufirit, SIKK” (pjesë e sistemit TIMS) është sistemi, ku administrohen të gjitha të dhënat në pikën e kalimit kufitar”.

Po ky ligj, në nenin 5, “Autoriteti që kontrollon e mbikëqyr kufirin”, përcakton:

“1. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit janë kompetencë e Ministrisë së Brendshme”.

(i) Konkluzioni i Komisionit se shtetasi A. H. në datën 06.07.2012 është proceduar për veprën penale "Organizimi i lotarive të palejuara", parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, bazohet në të dhënat e evidentuara në sistemin TIMS<sup>81</sup>.

(ii) Në përgjigje të kërkesës së tij të datës 13.02.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2024, i bën me dije se: *Mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 09.07.2012, për shtetasin A. H., në datën 11.07.2012, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale "Organizimi i lotarive të palejuara", parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, "pa autor" dhe se me vendimin e datës 08.10.2012, për këtë procedim penal është vendosur "pushim i çështjes së procedimit penal nr. {\*\*\*}/2012"<sup>82</sup>. Këto të dhëna, sipas subjektit, tregojnë se fakti për të cilin bën fjalë informacioni i sistemit TIMS nuk përmban elemente të një veprimi të kundërligjshëm.*

(iii) Shkresa e mësipërme e Prokurorisë Korçë informon gjithashtu se "ky procedim penal është referuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore O.M. dhe është hetuar nga Prokurore E.K. dhe Oficeri i Policisë Gjyqësore F.Q.", të cilat janë të dhëna që provojnë mospërfshirjen e subjektit në hetimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2012.

(iv) Rezultojnë të dhënat që, sipas tij, vënë në dyshim informacionin e sistemit TIMS, siç janë ato lidhur me procedimin në gjendje të lirë të shtetasit A. H., dhe se shkresa e sipërcituar i ka bërë me dije se vetëm më datë 28.01.2014, prokurori i çështjes B.M. ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} "pa autor" për veprën penale të organizimit të lotarive të palejuara, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, për të cilën më datë 23.10.2014, ky prokuror ka vendosur pushimin e procedimit penal; (v) lidhur me materialin kallëzues të datës 30.07.2019, ndaj shtetasit A. H. për veprën penale "Tregtim të mallrave të dyshuara si kontrabandë", parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, pretendon se duhet mbajtur në konsideratë se në përfundim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, dhe evidenton se në këtë periudhë subjekti ushtronte funksionin si prokuror në Sarandë.

35.6.1. Trupi gjykues fillimisht evidenton faktin se, pavarësisht fatit të procedimeve penale të regjistruara sipas të dhënave që gjenden në sistemin TIMS, lidhur me këtë shtetas, duket se konfirmohen ato të dhëna që i shërbejnë fazës fillestare të marrjes së informacionit/njohurisë se ka ndodhur një aktivitet i dyshuar kriminal, i cili më pas duket se nuk është arritur të provohet

---

<sup>81</sup> Sipas subjektit, në TIMS, për këtë shtetas, te rubrika "të dyshuar", është lënë shënimi i regjistruar me kod "{\*\*\*}", regjistruar më datë 06.07.2012, ora 11:40, filloi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin A.H. [...] sepse gjatë kontrollit të ushtruar në lokalit të tij në Pogradec, i janë gjetur 8 (tetë) aparate elektronike, lojëra fati "Poker", pa dokumentacionin përkatës. Vepra penale "Organizimi i lotarive të palejuara", parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

<sup>82</sup> Vetë subjekti në ankim shpreh se në këtë vendim, arsyetohet se: "veprimet e ndërmarra nga ana e shtetasit A. H. duke poseduar tetë aparate [...] të cilat nuk kanë qenë të vëna në punë për lojëra fati, nuk mund të kualifikohen si veprime të kundërligjshme në kuptim të veprës penale "Organizimi i lotarive të palejuara", të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal [...] fakti për të cilin është regjistruar procedimi penal nuk parashikohet nga ligji si veprë penale".

nga hetimet e zhvilluara. Në këtë kuptim, Komisioni ka ngritur linjën e tij të analizës mbi këtë të dhënë dhe jo mbi ndonjë konkluzion kategorik se shtetasi është doemos i përfshirë në këtë aktivitet, por ka peshuar ndikimin që mund ketë edhe ky lloj informacioni në sytë e publikut për sjelljen jashtëgjyqësore të subjektit.

**35.6.2.** Në vijim, në analizë të sa më sipër, lidhur me problematikat e evidentuara në vendimin e Komisionit për sa i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}/2012, procedimit penal {\*\*\*}/2014, si dhe materialit kallëzues të datës 30.07.2019, që i adresohen shtetasit A. H., me të cilin subjekti ka pasur lëvizje të shpeshta jashtë shtetit, si dhe ka një marrëdhënie huadhënieje të deklaruar në deklaratën *vetting*, trupi gjykues konstaton se Komisioni, marrëdhënien e subjektit me shtetasin A. H. e ka vlerësuar kryesisht në këndvështrim të faktit se duket ky shtetas, në një mënyrë apo tjetër rezulton se gjendet i lidhur me aktivitete të organizimit të lotarive të palejuara, në mënyrë të përsëritur, dhe se subjekti provohet nga lëvizjet e sistemit TIMS se ka jo vetëm marrëdhënie e kontakte të vazhdueshme shoqërore me të, por ka pasur edhe marrëdhënie huamarrijeje në vlerën 7.000 euro në vitin 2015, e cila është deklaruar nga vetë subjekti në deklaratën *vetting*<sup>83</sup>. Në këtë kontekst, duke konsideruar natyrën e marrëdhënies së afërt jo vetëm shoqërore, por edhe financiare, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni i ka analizuar ato në kuptim të matjes dhe vlerësimit të sjelljes jashtëgjyqësore të subjektit, sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe konstaton se pretendimet e subjektit me të cilat kundërshton analizën e Komisionit për këtë shtetas, janë të paargumentuara dhe, si të tilla, të paafta për të ndryshuar konkluzionet lidhur me të.

**35.7** Lidhur me shtetasin E. D., Komisioni ka konstatuar se ky shtetas është deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë, datë 02.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, duke u dënuar përfundimisht me gjobë në shumën 400.000 lekë. Gjithashtu, ky shtetas rezulton i dënuar edhe për një tjetër veprë penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ku me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor, duke u dënuar përfundimisht me gjobë. Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e mësipërm të Komisionit, duke pretenduar se: **(i)** ka anashkaluar nivelin dhe kohështrirjen e marrëdhënieve të subjektit me këtë shtetas, si dhe statusin aktual të shtetasit E. D. i cili rezulton të jetë i rehabilituar; **(ii)** nuk ka pasur dijeni asnjëherë për vendimet e dënimeve penale të dhëna ndaj shtetasit E. D.: **(iii)** Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2023, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentin "Vërtetim i gjendjes gjyqësore", në bazë të të cilit rezulton se: “Në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e ka deklaruar fajtor E. D. për veprën penale "Organizimi i lotarive të palejuara" dhe në bazë të nenit 197 të Kodit Penal dënohet me 60.000 lekë gjobë. Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal dënohet me 60.000 lekë gjobë. Rehabilitohet në bazë të nenit 69 të Kodit

---

<sup>83</sup> Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Dhënë hua në kohë të ndryshme shtetasit A. S. H. shumën 7.000 euro, dokumentuar me aktin “Deklaratë noteriale” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.06.2015, shumë e prejardhur nga kursime familjare. Nga kjo shumë, shtetasi A. H., dokumentuar nëpërmjet veprimit bankar “derdhje cash”, datë 13.05.2016, kryer pranë BKT-së, dega Pogradec, ka likuiduar shumën 2.000 euro duke e derdhur atë në llogarinë me nr. {\*\*\*}, në euro, në emrin tim”.

*Penal*"; **(iv)** lidhur me kërkesën e subjektit të datës 05.02.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2024, i bën me dije subjektit se procedimi penal nr. {\*\*\*}/2012, për verën penale "Organizimi i lotarive të palejuara", të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. D., është hetuar nga prokurore E.B. dhe Oficeri i Policisë Gjyqësore O.M., e dhënë e cila, sipas subjektit, si dhe referuar edhe përgjigjes me shkresën vijuese nr. {\*\*\*}, datë 11.03.2024, të kësaj prokurorie tregon mospërfshirjen e tij në hetimin e këtij procedimi, dhe se duhet konsideruar se ai është rehabilituar; **(v)** lidhur me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që e deklaroi fajtor E. D. për veprën penale "Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, duke e dënuar me 1 muaj burgim, subjekti shpjegon se në këtë periudhë, pra në vitin 2018, ai ushtronte funksionin si prokuror në Sarandë dhe nuk ka pasur dijeni asnjëherë për këtë vendim penal; **(vi)** të vlerësohet edhe niveli i marrëdhënies që ai ka pasur me shtetasin E. D. duke konsideruar se, sipas TIMS-it, subjekti me këtë shtetas, si dhe persona të tjerë, ka realizuar vetëm 3 udhëtime drejt Maqedonisë së Veriut përkatësisht në datat 26.05.2014, 08.07.2014 dhe 13.09.2018; **(vii)** automjeti "Daimler Chrysler", me targë {\*\*\*}, në pronësi të shtetasit E. D. të cilin ai e ka marrë në huapërdorje të përkohshme me anë të aktit noterial "Kontrate huapërdorje" nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.07.2017, është një huamarrje që u ndërpre më datë 01.08.2017 pasi ky mjet iu rikthye pronarit të tij.

**35.7.1** Trupi gjykues, lidhur me pretendimin e subjektit se *duhet konsideruar se E. D. edhe pse është dënuar, ai tashmë rezulton i rehabilituar, si dhe faktin që marrëdhënia e subjektit me këtë shtetas është reduktuar*, e konsideron një kërkim të mbetur në nivel deklarativ, për sa kohë konstatohet se subjekti rezulton se me këtë shtetas ka udhëtuar jo vetëm përgjatë vitit 2014, por edhe në vitin 2018, kur kishte nisur procesi i rivlerësimit kalimtar. Po ashtu, në vlerësimin e trupit gjykues, ekzistenca në vitin 2017 e një marrëdhënieje huapërdorjeje prej subjektit të automjetit të z. D., së bashku me udhëtimet<sup>84</sup> e kryera nga subjekti me të, tregojnë se marrëdhënia shoqërore e subjektit me këtë shtetas është konstante dhe e rëndësishme, pavarësisht përfshirjes së tij në veprimtari të kundërligjshme në mënyrë të përsëritur, veçanërisht në atë që lidhet me organizimin e lojërave të fatit, të cilat përgjithësisht funksionojnë si një aktivitet që kryhet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, duke pasur si pasojë një nivel më të lartë rrezikshmërie e ndikim domethënës në sjelljen jashtëgjyqësore të një magjistrati.

**35.7.2** Trupi gjykues, për sa më sipër, evidenton se si situatë faktike mbetet i pandryshuar fakti se: **(i)** E. D., me të cilin subjekti jo vetëm provohet se ka pasur kontakte të vazhdueshme, por ka qenë edhe në marrëdhënie huapërdorje të automjetit të tij, element i cili tregon një stad të avancuar të raporteve shoqërore, ka qenë i dënuar në vitin 2012 për veprën penale "Organizimi i lotarive të palejuara", për të cilën është dënuar me gjobë në masën 40.000 lekë; **(ii)** ky shtetas,

---

<sup>84</sup> Si në këtë rast, ashtu edhe në ato të analizuara më sipër, duket se mospasja e të dhënave nga sistemi TIMS për kalime kufiri të subjektit me shtetasit e mësipërm duket se i atribuohet faktit që në këtë periudhë, organet e rivlerësimit në vendimet e dhëna kanë evidentuar elementet e kontrollit mbi të cilët zhvillohej ky proces i rivlerësimit kalimtar ku një ndër të cilët ishte edhe verifikimi i figurës së personave me të cilët provohet se subjektet kishin kontakte, e për rrjedhojë subjekti ka shmangur kalimin e kufirit me ta.

edhe në vitin 2018, është dënua për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt” për të cilën është dënua me 1 muaj burgim.

**35.8** Në këtë kuptim, ndonëse çështjet penale për të cilat është proceduar shtetasi E. D. dhe shtetasit e tjetër të analizuar më sipër, nuk bëjnë pjesë në kategorinë e çështjeve të parashikuara në përcaktimet e nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë ato nuk e vendosin subjektin në kushtet e pasjes së kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, situatë e cila në mënyrë direkte do të kishte sjellë aplikimin e nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlejnë për t’u konsideruar në një vlerësim të përgjithshëm nëse ato ndikojnë në perceptimin publik për figurën e magjistratit. Për pasojë, situatat e evidentuara më sipër, që tregojnë për kontakte të shpeshta dhe të vazhdueshme të subjektit me shtetasit A. B., B. B., A. H., B. T., E. D., të cilët më së shumti duket se kanë qenë disa herë të dyshuar, por edhe të dënua për kryerjen e veprave penale, pikërisht në territorin ku subjekti ka lindur dhe ka ushtruar funksionin si Oficer i Policisë Gjyqësore, kohë gjatë së cilës nuk e ka shmangur kontaktin dhe shoqërimin me ta, tregojnë për trupin gjykues se subjekti duket se ka qenë i rrethuar në marrëdhëniet e tij shoqërore, nga individë që kanë pasur probleme në raport me ligjin, në mënyrë të përsëritur e me tipologji të ngjashme, element që e vendos subjektin nënjë perceptim publik negativ për figurën e tij si magjistrat.

**35.9** Pretendimet e subjektit për distancimin e tij nga këta shtetas, nuk u provuan në proces, por mbetën vetëm në nivel deklarativ. Njësoj mbeti i pavërtetuar edhe pretendimi i subjektit se ai përgjithësisht nuk kishte pasur dijeni për këto aktivitete të kundërligjshme të këtyre shtetasve, pasi konteksti ku janë zhvilluar marrëdhëniet shoqërore, në qytetin e Pogradecit, një qytet me një numër të ulët të popullsisë, periudhat e gjata gjatë të cilave kanë ekzistuar këto raporte shoqërore sipas asaj që vetë subjekti deklaroi, funksionet e subjektit si oficer i policisë gjyqësore, dhe më pas prokuror, dhe përsëritja e problematikave, e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit se ai nuk ka qenë në dijeni të asaj që ka ndodhur. Faktet që subjekti potencon në raport me këto ngjarje, se ai nuk ka hetuar këto çështje apo se ai nuk ka pasur akses në sistemin TIMS, që të mund të njoftohej lidhur me këto rekorde, mbeten pa relevancë për trupin gjykues, pasi dijenia e tij për këto ngjarje nuk mund të vinte nga kontaktet dhe dijenia që subjekti mund të merrte zyrtarisht për to, por nga natyra e raporteve të afërta shoqërore që ai kishte me këta shtetas. Për sa i përket faktit se ai nuk ka hetuar procedimet penale në ngarkim të tyre, trupi gjykues konstaton se asnjëherë Komisioni nuk e ka ngritur këtë çështje, për pasojë pretendimet e subjektit në këtë drejtim janë pa relevancë.

**35.10** Lidhur me pretendimet e subjektit se aplikimi i nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 lidhur me etikën e tij, gjendet i pabazuar, trupi gjykues i vlerëson të drejta. Referimi te neni 75 i ligjit nr. 96/2016, në raport me indikatorët e etikës dhe integritetit i referohet sjelljes gjyqësore të magjistratit dhe mënyrës si ai zhvillon veprimtarinë e tij funksionale. Në të njëjtën linjë arsyetimi, trupi gjykues e gjen jo krejt relevant edhe parashikimin e nenit 103 të ligjit nr. 96/2016 që përcakton frekuentimin me persona me precedentë penalë, si një shkelje disiplinore për magjistratët, pasi në këtë rast do të zbatoheshin kriteret dhe procedurat e juridiksionit të zakonshëm për procedimin disiplinor dhe marzhet e sanksioneve të parashikuara nga ky ligj, në rast se ato do të provoheshin. Pavarësisht këtij qëndrimi, trupi gjykues, si ka potencuar edhe më lart në këtë vendim, e sheh analizën që i bëhet sjelljes jashtëgjyqësore të magjistratit në

funkcion të parimeve të jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe në kontekstin e zbatimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një element që ndonëse nuk merr peshë autonome për marrjen e masës disiplinore, vlerësohet në çështjen konkrete krahas problematikave të tjera të konstatuara për subjektin e rivlerësimit, në lidhje me kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe të aftësive profesionale.

**35.11** Në përfundim, trupi gjykues, lidhur me këtë shkak ankimi, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit me të cilat ai kundërshton si jo të bazuar ligjërisht analizën e bërë nga Komisioni lidhur me sjelljen e tij jashtë funksionit, duke evidentuar se në disa raste është shoqëruar, ka udhëtuar apo është përfshirë në marrëdhënie të tjera me persona të proceduar për vepra të ndryshme penale, apo shkelës të ligjit, për të parë nëse subjekti gëzon integritet dhe besimin e publikut, trupi gjykues, ndonëse ashtu si edhe Komisioni vlerëson se shoqërimi jorastësor i subjektit me personat e analizuar në vendim, me të cilët ai vetë deklaron se ka pasur marrëdhënie shoqërore të hershme apo edhe marrëdhënie të tjera (huadhënie apo shitblerje) nuk e vendos atë në kushtet e kërkuara nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, po ashtu vlerëson se këto marrëdhënie të vazhdueshme të subjektit me këta shtetas, veçanërisht ata për të cilët ka informacion që janë përfshirë në një veprimtari të qëndrueshme me natyrë kriminale siç është ajo e parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, nuk mund të mbeten pa ndikim në vlerësimin e perceptimit publik lidhur me sjelljen jashtëgjyqësore të magjistratit. Kjo situatë, me të drejtë, është vlerësuar nga Komisioni në analizën e përgjithshme të tri kriterëve për subjektin e rivlerësimit, duke u konsideruar në harmoni dhe e integruar edhe me problematikat e konstatuara në dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të pasurisë dhe të aftësive profesionale.

**36** *Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat konsideron si jo të bazuar ligjërisht dhe jo në harmoni me jurisprudencën e Kolegjit, konkluzionin e Komisionit se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.*

**36.1** Komisioni, në kuptim të vlerësimit tërësor, ka konkluduar se: [...] në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, mbështetur në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se pavarësisht se nuk u vlerësua që problematikat e konstatuara për secilin komponent përbëjnë më vete shkak për shkarkim nga detyra, por duke u analizuar në tërësinë e tyre, në vlerësim përfundimtar, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, nisur nga faktet se: **(i)** subjekti rezulton me mungesë burimesh financiare në shumën rreth 3,2 milionë lekë, të cilat meqenëse janë para detyrës, nuk konsiderohen si shkak i vetëm për shkarkim; **(ii)** subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën vetting; **(iii)** lidhur me kriterin e aftësive profesionale, të paktën në nëntë dosje janë konstatuar probleme procedurale; **(iv)** si dhe të paktën në një rast është konstatuar shoqërimi i subjektit me persona me precedentë penalë, fakt për të cilin ka pasur dijeni, duke cenuar sjelljen jashtëgjyqësore të magjistratit. Këto rrethana, të marra së bashku, në vlerësim të të tria kriterëve, subjekti me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke sjellë për pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**36.2** Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ka cenuar besimin e publikut, është një konkluzion jo i drejtë, nuk është i argumentuar dhe as i bazuar ligjërisht, dhe se vjen edhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, pasi: **(i)** Komisioni në mënyrë kontradiktore nga njëra anë, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka konkluduar se subjekti nuk gjendet në kushtet për të aplikuar nenin 61, pika 1 apo 3 e ligjit nr. 84/2016, nga ana tjetër në vlerësimin tërësor problematikat e konstatuara lidhur me pasurinë, në mënyrë të padrejtë, i konsideron si cenim të besimit të publikut; **(ii)** për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti evidenton se ndonëse Komisioni shkeljet e konstatuara në 9 (nëntë) procedime penale nuk i konsideron të mjaftueshme për të plotësuar parashikimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nga ana tjetër të njëjtat shkelje i konsideron si elemente që shkojnë në funksion të vlerësimit për cenimin e besimit të publikut; **(iii)** është i padrejtë qëndrimi i Komisionit, i cili nga njëra anë konstaton se ka krijuar bindjen që subjekti nuk ka cenuar parashikimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, apo të pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nga ana tjetër, në vlerësim tërësor konkludon se është cenuar besimi i publikut.

**36.3** Trupi gjykues mori në analizë pretendimet e mësipërme të subjektit, sipas të cilave të njëjtat çështje e problematika të analizuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, që nuk kanë shkaktuar mosarritjen e një niveli të besueshëm lidhur me to, nuk mund të konsiderohen si problematika që cenojnë besimin e publikut. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues evidenton se në rastin konkret, bazuar në konkluzionet e arritura në arsyetimin e këtij vendimi, ndonëse siç është analizuar më sipër, është konstatuar se subjekti nuk ka arritur të provojë se ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aplikim të parimit “*no reformation in peius*”, trupi gjykues nuk mund të dalë në konkluzion të ndryshëm nga Komisioni lidhur me këtë kriter. Por, nga ana tjetër, trupi gjykues çmon se të gjitha problematikat e evidentuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë, përbëjnë elemente që duhen konsideruar në kuptim të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, të parashikuara nga neni 4 pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim të kësaj analize, pjesë e këtij vlerësimi sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përveç problematikave të hasura në kriterin e vlerësimit të pasurisë, bëhen edhe mangësitë e konstatuara në shqyrtimin nga subjekti të një sërë çështjesh penale, për të cilat kryesisht janë depozituar denoncime nga publiku, si dhe të dhënat që provojnë dhe tregojnë për shoqërimin e vazhdueshëm të subjektit me persona me precedentë penalë. Kjo mënyrë e analizës vjen plotësisht në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit dhe përfaqëson tipikisht atë që synon të rregullojë zbatimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Nga ky vlerësim kanë rezultuar problematika të cilat janë analizuar gjerësisht më lart, të cilat ndonëse nuk kanë qenë të mjaftueshme për të konkluduar në mënyrë autonome për secilin kriter, kanë qenë të mjaftueshme për t’u arritur në konkluzionin se duhet të thirret për zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Të gjitha problematikat e analizuar e të vlerësuara së bashku, krijojnë sipas vlerësimit të trupit gjykues, një bazë të qëndrueshme argumentesh, për të konkluduar se subjekti e ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, për shkak të sjelljeve të tij gjyqësore e jashtëgjyqësore, të cilat janë të pariparueshme me anë të programit të Shkollës së Magjistraturës, për vetë tipologjinë që ato përfaqësojnë.

- 37 Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në shqyrtimin e procedimeve penale të marra në analizë, si dhe të dhënat që evidentojnë në disa raste shoqërimin e subjektit me persona të dënuar apo të raportuar si të përfshirë në veprimtari të paligjshme, me të drejtë janë vlerësuar nga Komisioni si indikatorë të mjaftueshëm për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin e përgjithshëm, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke sjellë për pasojë aplikimin e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- 38 Për pasojë, në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, trupi gjykues, në zbatim të neneve D dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se vendimi nr. 734, datë 22.01.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i drejtë dhe i mbështetur në prova e në ligj.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 734, datë 22.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Ilir Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 15.07.2025.

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*